STUDIM MASTERPLANI PËR ZONAT ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

BAKS RRJOLL

DOKUMENTI PARAPRAK I
VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
PËR HARTIMIN E PLANIT TË DETAJUAR TË ZONËS SË RËNDËSISË KOMBËTARE BAKS-RRJOLL

Tiranë, Shtator 2020

Përgatitur nga: Dr. Abdulla Diku (Ekspert mjedisor i licensuar)

MSc. Kristi Bashmili (Ekspert mjedisor)

Shkurtimet

AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
AKPT	Agjensia kombëtare e planifikimit të territorit
AKZM	Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BE	Bashkimi Evropian
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
IAP	Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (BE)
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KMMD	Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar (i OND-së)
MiM	Memorandumi i Mirëkuptimit
MIZB	Menaxhimi i Integruar i Zonave Bregdetare
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
RSH	Republika e Shqipërisë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZDVN	Zonë Detare Veçanërisht e Ndjeshme

Përmbajtja

Kuadri i hartimit të VSM-së për PDZRK-në Baks-Rrjoll 7
Nisma për PDZRK Baks-Rrjoll 8
Parimet dhe synimi i VSM 9
Kuadri ligjor i VSM-së 10
Fazat nëpër të cilat kalon procesi i VSM 10
Njoftimi i ministrisë nga autoriteti propozues; 12
Konsultimi me grupet e interesit për çështjet e trajtuara në raportin e VSM-së; 12
Hartimi i raportit paraprak të VSM-së dhe konsultimi me grupet e interesit 13
Hartimi i raportit përfundimtar të vlerësimit strategjik mjedisor 14
Qëllimi dhe objektivat kryesore të PDZRK-së dhe përputhja me plane/programe të tjera 14
Vizioni dhe Drejtimet e Zhvillimit 15
Ruajtja e Mjedisit (Zhvillimi i Qëndrueshëm) 18
Objektivat e zhvillimit të zonës 20
Aksesi 21
Mobiliteti 22
Mjedisi 24
Shërbimet infrastrukturore 25
Tipologjitë Turistike 25
Programet dhe projektet e zhvillimit 26
Parimet e PDZRK-së dhe ndërthurja me Strategjitë / planet e tjera 29
Alternativa të konsideruara gjatë hartimit të PDZRK-së 31
Metodika e hartimit të vlerësimit strategjik mjedisor 34
Objektivat strategjikë mjedisorë 36
Përshkrimi i Përbërësve të Mjedisit 38
Pozita gjeografike 38
Klima 39
Topografia 39
Gjeologjia 40
Cilësia e tokave 42
Përdorimi i tokës 42
Hidrografia 44
Ujërat sipërfaqsorë 44
Cilësia e ujrave sipërfaqësor 45

Ujërat nëntokësorë (Akuiferët) 46
Cilësia e ujrave nëntokësorë 47
Cilësia e ajri 47
Ndryshimet Klimatike 48
Zhurmat në mjedis 49
Natyra 49
Habitatet kryesore 49
Flora dhe fauna 50
Lloje dhe habitate bimore të rëndësishme 50
Fauna 51
Zonat e mbrojtura 52
Zona e Projektit dhe Zona e Pejzazhit te Mbrojtur 53
Parimet e Menaxhimit të zonave të mbrojtura 55
Peizazhi 56
Infrastruktura mjedisore 58
Menaxhimi i mbetjeve 58
Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujrave të përdorur 61
Furnizimi me ujë 61
Kanalizimet dhe ujërat e bardha 62
Potenciali i ZRK Baks-Rrjoll për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (BRE) 62
Popullsia dhe kushtet social-ekonomike 63
Raporti me Hotspotet e Mundshme të Evidentuara 63
Problematikat Mjedisore 64
Ndotja 64
Dëmtimi i dunave ranore 65
Brakonazhi ose Gjuetia e paligjshme 66
Përfundime dhe sygjerime për zhvillimin e mëtejshëm të zonës 67
Kërkesat mjedisore për efiçencë energjie 69
Kërkesat mjedisore për prodhim energjie diellore 71
Kërkesat mjedisore për efiçencë të perdorimit te ujërave 72
Mbrojtja e Peizazhit 73
Hapësirat e gjelbra dhe llojet e gjelbërimit 76
Mbrojtja e Mjedisit 77
Toka 77

Uji 77
Ajri 78
Natyra dhe biodiversiteti 79
Përcaktimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe peisazhit 79
Vlerësimi i ndikimit në mjedis 81
Ndërveprimet e mundshme të PDZRK me mjedisin 81
Kufizimet ligjore në çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësisë kombëtare 82
Ndikimet e mundshme negative 85
Ndikimet në mjedis të PDZRK 87
Metodika e Vlerësimit të ndikimit në mjedis të PDZRK 87
Përshkrimi i kritereve të vlerësimit në mjedis të PDZRK 87
Vlerësimi i ndikimeve në mjedis të projekteve të PDZRK 88
Përputhshmeria e PDZRK me objektivat mjedisorë 91
Metodika e përputhshmërisë së projekteve të PDZRK me Objektivat Mjediore 91
Përputhshmëria e PDZRK me OM-të 91
Vlerësimi i pasojave të zbatimit të PDZRK në realizimin e objektivave mjedisorë 93
Masat zbutëse 98
Plani i monitorimit 101
Shtojca 01: Procesi i konsultimit të planit baks-rrjoll 103

Kuadri i hartimit të VSM-së për PDZRK-në Baks-Rrjoll

Turizmi, sot, është një nga industritë më të mëdha në botë që gjeneron të ardhura dhe lidhet ngushtë me sektorët e tjerë të zhvillimit. Punësimi në sektorin e turizmit ofron një potencial të konsiderueshëm për zbutjen e varfërisë, sidomos për gjininë femërore. Përveç kësaj, industria e turizmit ndikon menjëherë edhë në sektorët e tjerë, të tilla si industria e prodhimit, bujqësia dhe sektori i shërbimeve. Këto lidhje kanë krijuar efekte shumëzuese të cilat stimulojnë ekonominë lokale dhe gjithashtu ofrojnë burime të ndryshme të të ardhurave për popullsinë vendase dhe jo vetëm. Përveç nxitjes ekonomike, turizmi mund të kontribuojë edhe në ruajtjen e biodiversitetit, duke qenë se me rritjen e numrit të vizitorëve, shumë parqe kombëtare dhe zona të mbrojtura do mund të krijonin edhe përfitime financiare që do të ktheheshin në investime në shërbim të tyre.

Përmirësimi i industrisë së turizmit përfshin edhe cilësinë e produkteve dhe të shërbimeve (akomodimin, restorante, guidat turistike, operatorët turistik, etj), me qëllim rritjen e kërkesës kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, promovimin e konkurrueshmërinë brenda kësaj industrie, dhe prodhimin e informacioneve të besueshme e të vlefshme mbi standardet e cilësisë.

Zona Bregdetare, me gjithë potencialet e saj për turizëm, ka nevojë për orientime konkrete zhvillimi,të cilat duhet të jenë të qarta dhe të bazuara në politikat kombëtare të zhvillimit të sektorit, të jenë të në harmoni me vizionin global të evolimit të turizmit, të kenë në fokus mbrojtjen e natyrës e peisazhit, të cilët janë edhe lënda e parë për sektorin. Këto oreintime duhet të lidhen si me funksionet e shumëllojshme që perfshin sektori dhe shpërndarjen e tyre në territor, ashtu edhe me tiparet e zhvillimit të territorit dhe gjuhën e komunikimit arkitektonik të zhvillimeve në funksion të turizmit. Si përherë, shtrirja e aktivitetit turistik mbetet një sfidë, e cila mund të trajtohet gjithashtu nëpërmjet një planifikimi të mirë të territorit dhe orientimeve konkrete të zhvillimit, duke marre në konsiderat të gjithë aspektet e mbrojtjes së mjedisit.

Hartimi i dokumenteve të *Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin e Detajuara të Zonës së Rëndësisë Kombëtarë (PDZRK) Baks-Rrjollë*, rrjedh si detyrim nga *ligji nr. 91/2013*, datë *28.02.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor".* Referuar *nenit 2 pika 1/a* të këtij ligji theksohet se, *procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor i nënshtrohen të gjitha planet dhe programet për bujqësinë, pyjet, peshkimin, energjinë, industrinë, industrinë minerare, transportin, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionin,* ***turizmin****, planet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit urban e rural,* përfshi dhe mbrojtjen e peizazhit, të përdorimit të tokës, të cilat vendosin kuadrin për miratimin, në të ardhmen, të projekteve të listuara në shtojcat 1 e 2 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"[1].

[1] Ligji nr. 91/2013, datë 28.02.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor"

Nisma për PDZRK Baks-Rrjoll

Zona në studim është ndodhet në brendësi të zonës së mbrojtur Peizazh i mbrojtur Lumi i bunës Velipojë, në këtë zonë ndodhet fshati Baks-Rrjoll duke e kthyer disi me karakter banimi, por ka shumë sipërfaqe të paprekura me potencial të lartë turistik, për shkak të vlerave të tyre. Pjesa më e madhe e kesaj zone është e mbrojtur për peizazhin e veçantë dhe tiparet e lagunave e ligatinave. Kjo zonëështë ruajtur e pazhvilluara deri tani, për shkak të mungesës së infrastrukturës, por edhe për shkak të statusit të mbrojtur mjedisor.

Ka pasur përpjekje për të ideuar zhvillimin e këtyre zonave si zonë pushimi kryesisht me shtëpi të dyta dhe më pak me hotele, por programet dhe projektet e propozuara, deri tani, kanë qenë të papërshtatshme.

Qeveria e Shqipërisë është në kërkim të ideve të zhvillimit për këto llojë zonash, të cilat të jenë të përshtatshme me natyën dhe karakteristikat e tyre*; për koncepte projektimi që do t'i bënte këto zona të aksesueshme dhe të vlerësuara; për koncepte zhvillimi që janë në gjendje të ruajnë bukurinë e peizazhit dhe tiparet territoriale të tyre, ndërsa në të njëjtën kohë të hapë hapësira për aktivitetet njerëzore që mund të sigurojnë të ardhura dhe ekonomi; për koncepte projektimi që do të ishin të ndjeshme ndaj peisazhit dhe modeste*.

Ky ushtrim shërben gjithashtu si një studim fizibiliteti, për të vlerësuar nëse ideja për të zhvilluar dhe njëkohësisht për të ruajtur zona të tilla, funksionon me të vërtetë.

Qeveria shqiptare është në dijeni të faktit se tema e zhvillimeve në bregdet është shumë e ndjeshme dhe nuk mund të merret pozitivisht nga të gjithë. Kjo është arsyeja pse një ushtrim i tillë i zhvillimit nëpërmjet projektimit bëhet shumë i rëndësishëm për të vlerësuar me të vërtetë mundësitë për zhvillimin e këtyre zonave të veçanta të vijës bregdetare.

Nisma për hartimin e PDZRK Baks-Rjoll ndërmerret nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, *i cili hartohen në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar (PPK) "Shqipëria 2030", Planin e Integruar Ndërsektorial të Bregdetit dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023.*

Meqënëse PDZRK-ja Baks-Rrjoll është një plan lokal (zonë relativisht 100-200ha), ai ka nevojë ti nënështrohet një Vlerësimi Strategjik Mjedisor sikurse përcaktohet në *Nenit 1"Fusha e zbatimit të ligjit" të Ligjit Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"* ku thuhet se procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor i nënshtrohet:

- *"**hartimi i të gjitha planeve dhe programeve për*** bujqësinë, pyjet, peshkimin, energjinë, industrinë, industrinë minerare, transportin, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionin, ***turizmin***, planet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit urban e rural, përfshi dhe mbrojtjen e peizazhit, të përdorimit të tokës, të cilat vendosin kuadrin për miratimin, në të ardhmen, të projekteve të listuara në shtojcat 1 e 2 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Mbështetur në këtë kuadër ligjor, po hartohet edhe ky Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për PDZRK-në Baks-Rrjoll.

Parimet dhe synimi i VSM

Vlerësimi Strategik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik për vlerësimin e pasojave në mjedis nga politika e propozuara, nismat per plane dhe programe, ne menyre qe pasojat te jenë tëresisht te përfshira dhe te adresuara sic duhet ne fazat me te hershme të vendim-marrjes dhe qe i jep te njejten rendesi ne raport me ceshtjet ekonomike dhe sociale.

Kësisoj VSM-ja është një vendimarrje strategjike që integron konsideratat mjedisore dhe ato të qëndrueshmërisë. Si vendimarrje strategjike, ajo ka mundësinë ta bëjë botën më të gjelbër dhe më të qëndrueshme. Por, nëse nuk kryhet sic duhet, VSM-ja mund te kthehet edhe thjesht dhe vetëm në një procedure që përligj interesa të gabuara.

Në mënyrë që zhvillimi të jetë i qëndrueshëm, VSM-ja zbaton parimet e mëposhtëme:

a. ***VSM duhet të përmirësojë Veprimin Strategjik.*** Për ta kryer këtë, VSM duhet të nisë para procesit të vendim-marrjes, duhet të integrohet në vendim-marrje, të fokusohet në përcaktimin e alternativave të mundshme dhe në modifikimin e veprimit strategjik. Vendim-marrësi duhet të përfshihet aktivisht në proces për tu siguruar që gjetjet e VSM të jenë marrë parasysh.

b. VSM duhet të promovojë pjesëmarrjen publike në vendimmarje.

c. VSM duhet të jetë e fokusuar në vështirësitë kyçe të mjedisit dhe të qëndrueshmërisë.

d. VSM duhet të ndihmojë në identifikimin dhe vlerësimin e opsioneve më të mira, të përmbushë nevojat dhe të minimizojë dëmet.

e. VSM aplikon parimin e parakujdesit. Në këtë kuptim, nëse vlera e zhvillimit dhe impakti janë të pasigurtë, atëherë duhet mbrojtje e asaj vlere mjedisore që kemi në gjendje.

a. VSM duhet të vlerësojë efektet negative, pozitive dhe kompensimin e mundshëm. Zbutja e ndikimeve në mjedis kryhet nëpërmjet ndryshimit të veprimeve strategjike për të shmangur impaktin negativ ose të vendosë kufizime në zhvillimin e projekteve të tjera.

b. ***VSM nuk duhet të lejojë që veprimet strategjike të kalojnë kufijtë përtej të cilave ndodhin dëme të pariparueshme.*** Kjo kerkon fillimisht identifikimin e këtyre kufijve, krahasim të situatës së mundshme pa ndërmarrjen e veprimit strategjik me atë të veprimit strategjik dhe kërkon gjithashtu gjykim nëse efektet janë të qënësishme dhe tejkalojnë kufijtë e vendosur mjedisor.

Kuadri ligjor i VSM-së

Kuadri ligjor shqiptar për VSM-në është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit dhe siguron tashmë përputhshmëri të plotë më (i) ***Direktivën 2001/42/EC të Komisionit Evropian*** mbi Vlerësimin e Efekteve në Mjedis prej Planeve apo Programeve të Caktuara dhe me (ii) ***Protokollin e VSM-së të Konventës ESPOO (UNECE)***.

- ***Ligji nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" siguron tashmë plotësisht mbulimin e duhur të procesit të VSM-së***. Ligji ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe të drejtat e përgjegjësitë e tyre, si dhe procedurat, sipas të cilave kryhet Vlerësimi Strategjik Mjedisor.

Direktiva e Komisionit Evropian 2001/42/EC për vlerësimin e ndikimit të disa planeve dhe programeve mbi mjedisin (Direktiva VSM).

Protokolli VSM, i miratuar në Kiev (Ukrainë) në vitin 2003, në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve të Konventës Espoo gjatë konferencës ministrore të "Mjedisit për Evropën" dhe nënshkruar nga 36 shtete dhe Komuniteti Evropian.

Një çështje e rëndësishme e procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor është ai i pjesëmarrjes publike dhe këshillimit të duhur të saj. Për këtë qëllim grupi i punës zbatoi kërkesat që rrjedhin prej Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 219, datë 11.3.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"

Fazat nëpër të cilat kalon procesi i VSM

Fazat e procesit të vlerësimit strategjik mjedisor sqarohen në Nenin 7 ku përcaktohet se procesi i vlerësimit strategjik mjedisor kalon detyrimisht në këto faza të njëpasnjëshme:

Faza 1
SHQYRTIMI I KËRKEËS / NISMA
35 Ditë
Autoriteti propozues njofton paraprakisht Ministrinë për fillimin e hartimit të planit, duke kërkuar nevojen ose jo te VSM-së
Ministria, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, i përgjigjet, me shkrim, autoritetit propozues.
Brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit, Ministria e publikon njoftimin në faqen e saj zyrtare.
Faza 2
INFORMIMI I PALËVE TË INTERESUARA DHE PUBLIKUN
107 Ditë
DËGJESA 1
Autoriteti propozues përpara fillimit të hartimit të raportit të VSM, konsultohet me palët e interesuara në lidhje me çështjet për t'u trajtuar në VSM. (ISHP, NJQV-të, Institutet e mbrojtjes së tokës, shoqata, OJF etj.)
Brenda 20 ditëve, nga dita e marrjes së kërkesës, palët e interesuara i përgjigjen autoritetit propozues. Nëse ata nuk i përgjigjen brenda këtij afati do të thotë se nuk kanë kërkesa të veçanta.
DËGJESA 2
Autoriteti propozues, pas hartimit të raportit paraprak të VSM-së, e publikon atë për të paktën 30 (tridhjetë) ditë në faqen zyrtare elektronike. Duke i sqaruar mënyrën për t'u njohur me raportin, si dhe datën kur do të organizohet dëgjesa publike
Dëgjesa publike organizohet nga autoriteti propozues, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të grupeve të interesit.
Grupet e konsultuara shprehin sugjerimet e tyre gjatë dëgjesës dhe mund të dërgojnë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e mbajtjes së dëgjesës
DËGJESA 3
Ministria, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për deklaratën mjedisore, në rast se e sheh të nevojshme të organizojë vetë një dëgjesë me publikun. Në dëgjesë ftohet edhe autoriteti propozues dhe subjekti kontraktues.
Ministria brenda 7 ditëve njofton grupet e interesit dhe publikun për degjesën dhe datën. Nëqoftëse ka kombente dhe sygjerime gjatë dëgjesës, ministria ja dergon autoritetit propozues brenda 10 ditëve
Faza 3
MIRATIMI I VSM-së
KËRKESA PËR DEKLARATË MJEDISORE
DEKLARATA MJEDISORE
KOHËZGJATJA E TOTALE 142 DITË

Njoftimi i ministrisë nga autoriteti propozues;

Gjatë kësaj faze, autoriteti planifikues njofton Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për nismën e hartimit të PDZRK-së Baks-Rrjoll duke i vënë asaj në dispozicion informacionin paraprak si dhe shtron kërkesën për nisjen e procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Në vijim të këtij njoftimi, Ministria, në përputhje më Ligjin 91/2013 shprehet mbi mënyrën e zhvillimit dhe përputhjen me legjislacionin që duhet të ketë ky dokument.

Në njoftimin e ministrisë, autoriteti propozues dërgoi njëkohësisht dhe informacionin e mëposhtëm:

1. qëllimin e propozimit, shoqëruar me të dhëna të tjera të nevojshme, si: relacion shpjegues, hartat e të dhëna të tjera ndihmëse që disponon lidhur me propozimin;
2. arsyetimin për nevojën e hartimit të Planit;
3. cilësimin e autoritetit miratues të Planit;
4. procedurën që do të zbatohej për hartimin e Planit.

Konsultimi me grupet e interesit për çështjet e trajtuara në raportin e VSM-së;

Grupet e interesit me të cilat autoriteti propozues duhet të këshillohet paraprakisht për paraqitjen e sugjerimeve për çështjet që ato duan të trajtohen në raportin e VSM-së janë:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM),
- Agjensia Kombëtare e Mjedisit (AKM),
- Agjensia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM),
- Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT),
- Agjensia Kombëtare e Bregdetit (AKB),
- Agjensia Kombëtare e Turizmit (AKT),
- Agjensia Kombëtare e Territorit (AZHT),
- Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN),
- INSTAT,
- Agjensia Rajonale e Zonave të mbrojtura
- Bashkitë që preken nga zhvillimi I PDZRK-së
- OJF-të e ndryshme me profil mjedisor dhe zhvillimin e turizmit.
- institucionet e mbrojtjes së shëndetit publik;
- institucionet e mbrojtjes së tokës bujqësore;
- institucionet e tjera që identifikohen me përgjegjësi në propozim (ministritë etj.).

Autoriteti propozues ka dhe po organizon për këtë qëllim dy takime këshëllimore p.

Takimi i parë këshëllimor u mbajt mbajtt më 03/09/2020, ora 11:00 nga MTM në cilësinë e autoritetit propozues të PDZRK-së Baks-Rrjoll. Në njoftimet për takim u shënua:

- qëllimi i propozimit, relacioni shpjegues dhe të dhëna të tjera ndihmëse që disponon autoriteti lidhur me propozimin;
- arsyetimi për nevojën e PDZRK-së
- autoriteti miratues i Planit;
- procedura që do të zbatohej për hartimin e planit dhe afatet kohore të parashikuara *dhe*
- axhenda e takimit.

Në këtë takim të parë u prezantua:

- nisma për për hartimin e PDZRK-së
- gjendja e sektorit dhe nevoja për zhvillimin e turizmit në vend,
- çështjet themelore të diskutuara në Planin kombetar të planifikimit të Territorit dhe atë të bregdetit
- nevoja për VSM të PDZRK-së
- ndikimet kryesore të pritshme në mjedis nga zbatimi i PDZRK-së,
- objektivat mjedisorë paraprakë të VSM-së për PDZRK-në*dhe*
- çështjet parësore që priteshin të trajtoheshin në Vlerësimin Strategjik Mjedisor për PDZRK-në.

Minutat e takimit për këshillimin publik, si dhe komentet/sugjerimet e ardhura nga institucionet e ndryshme, MTM, MM, etj., janë paraqitur në Aneksin 1 të VSM-së.

Hartimi i raportit paraprak të VSM-së dhe konsultimi me grupet e interesit

Raporti paraprak i VSM-së përmbledh të gjitha gjetjet gjatë diskutimeve me palët e interesit si dhe ato të nxjerra në pah nga vetë ekspertët. Në raportin paraprak do të paraqitet i gjithë informacioni si dhe të dhënat të rëndësishme mbi ndikimet në mjedis të Planit.

Hartimi i raportit përfundimtar të vlerësimit strategjik mjedisor

Pas hartimit të raportit paraprak, ekspertët do të vijojnëme hartimin e raportit përfundimtar i cili është në përputhje me strukturën e kërkuar nga vetë ligji 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor".

Ndërkaq struktura apo cështjet që duhet të mbulojë një raport VSM-je përcaktohen në pikën 3 të Nenit 10. Hartimi dhe konsultimi i raportit paraprak të VSM-së me publikun dhe grupet e interesit parashikohet në Kreun III. Raporti i VSM-së, konsultimi dhe deklarata e ministrit.

Në përputhje më këto nene ligjore, hartimi i VSM-së kalon në pesë faza përfshirë (Fig. 1):

1. Shqyrtimin e nevojës për VSM,
2. Përshkrimin e gjendjes së Mjedisit
3. Hartimin e raportit paraprak të VSM-së
4. Hapat ligjorë të ndjekur për miratim *dhe*
5. Zbatimin dhe monitorimin e VSM-së

Qëllimi dhe objektivat kryesore të PDZRK-së dhe përputhja me plane/programe të tjera

Kjo pjesë do të paraqesë qëllimin dhe do të zbërthejë përmbushjen e tij në disa objektiva të domosdoshëm. Por qëllimi i këtij plani si dhe objektivat e tij duhet të marrin parasysh dhe të

integrojnë përputhshmërinë me disa plane apo programe themelore sikurse Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, Plani Kombëtar e Vendor, Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit etj.

Vizioni dhe Drejtimet e Zhvillimit

Si një zonë me vlera të shumta mjedisore peisazhistike dhe me një potencial për zhvillimin e turizmit bregdetar, rural dhe natyror zona e Baks Rrjollit pozicionohet në rajon si një ndër zonat më atraktive për zhvillimin e ardhshëm turistik. Potenciali i zonës lidhet ngushtë dhe me pozicionin e saj gjeografik. Afërsia e saj me Malin e Zi, polin ekonomik Shkodër-Lezhë, me portin e Shëngjinit dhe me plazhin e Velipojës i japin kësaj zone prioritet për zhvillimin e ardhshëm turistik në këtë rajon. Portat hyrse në këtë zonë do të jenë: Aeroporti Nënë Tereza, Porti i Shëngjinit dhe dogana e Muriqanit.

Vizioni i zhvillimit mbështëtet në vlerat natyrore rajonale dhe në vlerat autoktone të zonës ku mund të përmendim krijimin e një poli turistiko-natyror, duke u nisur nga lumi Buna, Liqeni i Shkodrës, Laguna e Vilunit, Mali i Rencit dhe Monumentit të Ranës së Hedhun. Gjithashtu përpos shumllojshmërisë së atraksioneve natyrore dhe turistike në nivel rajonal zona e Baks Rrjollit do të ofrojë një alternativë zhvillimi turistik konkuruese në vend.

Zona do të zhvillohet duke u mbështëtur në potencialet natyrore dhe njerëzore që ofrohen duke përmendur: Laguna e Vilunit, Plazhi, Mali i Rencit, Habitatet natyrore duke përfshirë Dunat ranore dhe Ligatinat, Monumenti i Ranës së Hedhun si dhe zona ekzistuese e ndërtuar e fshatit të Baks Rrjollit.

Zona është e ndarë ne 6 polaritete ku secili polaritet ka funksione të ndryshme hapsinore duke ndërvepruar midis tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shërbimeve që do të ofrohen.

Polariteti 1. 2. dhe 3 ose polariteti i quajtur si Strukturim i Situatës Ekzistuese. Ky pol shtrihet në afersi të lagunës dhe përgjatë rrugës ekzistuese që lidhë Baks Rrjollin me Shkodrën dhe Velipojën. Në të synohet ristrukturimi dhe rivitalizimi me anë të rregullave të posaçme arkitektonike, shtimi i funksioneve turistike dhe funksioneve publike si dhe krijimin e hapsirave rekreative. Mënyra e ndërhyrjes do të jetë mbushja urbane.

Polariteti 4 i quajtur si poli i lagunës. Një ndër polet e ndjeshme mjedisore të zonës në të cilin synohet ndërtimi i strukturave pikësore dhe që janë miqësore me mjedisin. Në këtë zonë ndërhrja kryesore do të jetë rkonstruktimi dhe krijimi. Ndërhyrjet e reja që do të ndërthuren më situatën e zonës natyrore por dhe me atë të ndërtuarën do të jenë: Ndërtimi i një moli të vogël, ndërtimi i

shëtitores e cila do të lidhet me Velipojën, rikonstruktimi i urave në lagunë si dhe shtimi i shërbimeve turistike.
Polariteti 5 është poli i cili do të ofrojë shërbime akomoduese me tipologji resorte. Kjo është një tipologji e re e cila do të adaptohet në këtë zonë duke krijuar një koncept të ri ndryshe nga reliteti i vilave dhe strukturave individuale.

Do jetë një zonë turistike kompakte e cila do të vetëofrojë shërbime, aktivitete dhe facilitete turistike. Edhe kjo zonë do të mundohet të mos cënojë habitatet natyrore duke ndërthurur korridoret natyrore me strukturat turistike. Nëpërmjet këtyre korridoreve ky polaritet por dhe polaritete të tjera do të komunikojnë me Parkun Natyror që shtrihet deri te Monumenti i Ranës së Hedhun.

Polariteti 6 ose i quajtur si poli natyror do të jetë parku natyror i cili do të funksionojë më anën të shtigjeve natyrore dhe sinjalistikës turistike. Ky polaritet do të ofroj zonën e qetë dhe tërësisht natyrore për turistët të cilët preferojnë të jenë sa më afër natyrës.

Ndërveprimi i polariteteve dhe komunikimi i tyre me korridore rrugore, shëtitore, shtigje do të krijojnë asamblinn turistik të ndërveprimit të një game të gjerë me aktivitete dhe akomodim turistik.

Ky destinacion i ri turistik do jetë në komunikim të vazhdueshëm me Plazhin e Velipojës nëpërmjet urave të drurit ashtu edhe me Monumentin e Ranës së Hedhun nëpërmjet shtigjeve natyrore.

Figura X. Harta e vizionit strategjik (Version paraprak)

Figura x. harta e Vizionit të PDZRK-s Baks-Rrjoll (version paraprak)

Ruajtja e Mjedisit (Zhvillimi i Qëndrueshëm)

Zona në fjalë përbëhet nga një sërë elementësh të rëndësishëm nga pikpamja mjedisore. Në këtë territor takohen disa ligatina të vogla e të cekëta, duna ranore të madhësive dhe moshave të ndryshme dhe zona të mbuluara me shkurre, kallamishte dhe zhuka, mbetje të pyjeve pranë ujit me Frashër (Fraxinus excelsior) duke e bërë një ekosistem të rëndësishëm për botën shtazore dhe bimore.

Vetë fshati Baks-Rrjoll shtrihet në Nënzonën Qëndrore të Zonës së Pejzazhit të Mbrojtur Lumi Buna-Velipojë. Sipas Pikës 3a. “Ndarja në nënzona i territorit të zonës së mbrojtur kombëtare” të të Ligjit 91/2017, "Për Zonat e mbrojtura" “a) Në nënzonën qendrore (që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe siguron një zonë natyrore të pashqetësuar) përdoret shkalla e parë e mbrojtjes (strikte).”. Në funksion të Nenit 48 “Nënzona qendrore” duket se shumica e veprimtarive njerëzore në këtë nënzonë janë të ndaluara. Sipas pikës 2c të Nenit 48 “2. Në nivelin A janë të ndaluara: c) ndërtime të çdo lloji;”,

Ndërkaq realiteti është i krejt i ndryshëm nga përcaktimet ligjore. Fshati ka sigurisht ndërtime dhe është zgjeruar edhe më në jug të tij, deri në kufirin me grupimin e Frashërit (Fraxinus excelsior) dhe ligatinat e përkohshme bregdetare. Një realitet i tillë e përkon më tepër me përcaktimet e Nënzonës së Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm ku zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes dhe ku janë të ndaluara:

- ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- depozitimi i kimikateve;
- lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;
- mbledhja intensive e bimëve, mineraleve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve;
- vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;
- ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave e shtigjeve të caktuara.

Për të ruajtur sa më shumë vlerat territoriale dhe natyrore të zonës disa parime do të ndiqen në zhvillimin e ardhëm të territorit për të patur një ndikim sa më të ulët ne aspektin peizazhistik ashtu dhe në humbjen e degradimin e habitatit:

- Zona me ndërtime e fshatit Baks-Rrjoll të kalojë në Nënzonën e Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm deri në kufirin e përcakuar nga bashkimi i drejtpërdrejtë i pikave në terren sipasrenditjes me poshtë:
  Lat. 41.850762°, Long. 19.489536°
  Lat. 41.856947°, Long. 19.493614°

Ky kufi bazohet dhe në zonimin e PPV-së së Bashkisë Shkodër.

- Pjesa në jug të kësaj linje deri në kufirin jugor të Zonës së Pejzazhit të Mbrojtur Lumi Buna–Velipojë, do të vazhdojë të ruhet si zonë natyrore brenda Nënzonës Qendore për shkak të vlerave të jashtëzakonshme të peizazhit, larmisë së habitateve dhe numrit të lartë

të specieve bimore eshtazore me vlerë për mbrojtjen e natyrës. Sipas Nenit 48 të ligjit 91/2017, "Për Zonat e mbrojtura" në këtë nënzonë nuk duhet të unshtrohet presion me ndërtime apo ndërhyrje të tjera infrastrukturore.

Me ruajtje kuptojmë paprekshmërinë e ligatinave të përkohshme në fashën litorale, paprekshmërinë e vegjetacionit të lartë me Frashër (*Fraxinus excelsior*), si dhe paprëkshmërinë e dunave ranore pranë shpatit të Malit të Rencit.

Me përforcim kuptojmë inkurajimin korridoreve ligatinorë me *Typha latifolia*, *Scirpus sp*, dhe *Phragmites communis* si dhe shtimin e bimësisë së lartë autktone e sidomos të Frashërit (*Fraxinus excelsior*)

- Gjatë planifikimit do të merret në konsideratë ndjeshmëria e lartë që ka ekosistemi i lagunës së Vilunit ndaj shqetësimeve të mundshme. Në këtë kontekst do krijohet një brez buferik me bimë vendase, duke krijuar dizajne të këndshme, jo më pak se 200 m përgjatë gjithë perimetrit të lagunës. Kufiri i lagunës përcaktohet në nivelin maksimal të saj në periudhën e dimrit.

- Gjatë planifikimit do të merren në konsideratë ruajtja dhe përforcimi i korridoreve ekologjik lidhës midis Lagunës së Vilunit, ligatinave të vogla në pjesën jugore të zonës dhe habitateve pyjorë në shpatet e Malit të Rencit. Kjo lidhje do të shërbejë për mosndërprerjen e rrugëve të shtegtimit të gjallesave tokësore si dhe për të siguruar shpërhapjen e së specieve faunistike. Korridori do t'u shërbejë kryesisht shpendëve të vegjël dhe specieve faunistike tokësore. Korridoret ekologjik, përdoren gjerësisht në funksion të atraksioneve turistike si zona ku mund të zhvillohen aktivitete alternative si hiking, trekking, birdëatching, biking etj.

Objektivat e zhvillimit të zonës

Hartimi i kësaj PDZRK-je lidhet me promovimin e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, përthithjen e investimeve të huaja si dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës të komunitetit pranë zones duke ruajtur vlerat natyrore te zonës dhe përforcuar veçoritë natyrore me karakteristike të këtij ekosistemi bregdetar dhe malor.

Për të krijuar një lokalitet konkurrues në rajon në çdo drejtim duhen arritur disa objektiva.

Objektivat kryesore mbi të cilat do të orientohet zhvillimi turistik i zonës në studim do të jenë:

- Mobiliteti dhe lëvizshmëria: Aksesi dhe parkimi, transporti publik dhe ai alternativ

- Shërbimet Infrastrukturore: Siguria publike dhe furnizimi me enegji elektrike & ujë, largimi i ujrave të ndotur, implementimi i rrjetit të telekomunikacionit
- Ruajtja dhe konservimi i Mjedisit: Përshtatja e zhvillimit turistik me karakteristikat natyrore të zonës, ruajtja e vlerave natyrore dhe përforcimi i tipareve natyrore më funksionale nga pikëpamja ekologjike.
- Zhvillimi i Turizmit: Zhvillimi urban i zonës do të realizohet me struktura të ndryshme hoteljere dhe resortesh në funksion të aktivitetit turistik, të ndërthurura me një sërë hapësirash rekreative publike dhe shërbimesh për të përmbushur në çdo kohë kërkesat e turizmit konkretisht:
  - Strukturimi i Zonës urbane ekzistuese
  - Zhvillimi i Agroturizmit
  - Akomodimi Turistik (Hoteleri)
  - Shërbime turistike (Bare, Restorante, Beach Bar)
  - Shërbime turistike plazhi

Figura x. Drejtimet kryesore të zhvillimit

Aksesi

Si ndër projektet e parashikuar së fundmi është dhe projekti i ndërtimit të rrugës Shëngjin-Velipojë i cili kalon në zonën e Rrjollit. Kjo rrugë rrjedhimisht do të kalojë në fokus primar për aksesin në këtë zonë duke qënë hyrja kryesore turistike. Aksi ekzistues hyrës do të kalojë i një rëndësie të dytë duke u përdorur më shumë nga vendasit dhe furnizimit me shërbime për zonën. Nëpërmjet ndërtimit të rrugës Shëngjin-Velipojë dhe përmirsimit të aksit ekzistues hyrës krijohet një trekëndësh bashkëveprimi turistik dhe ekonomik.

- Bashkëveprim i turistik Shëngjin-Baks Rrjoll-Velipojë
- Bashkëveprim ekonomik Baks Rrjoll-Shkodër

Përveç korridoreve kryesore të lëvisshmërisë në zonë do të rikonstruktohet rrjeti rrugor i zonës si dhe do të ndërtohet një shëtitore buzë lagunës e cila lidhet me Velipojën me anë të një ure druri dhe shtrihet zonën e Baks-Rrjollit me një gjatësi prej 4km.

Figura x. Harta e aksesit në zonë (version paraprak)

Mobiliteti

Baks Rrjolli me përmirësimin e aksesit pritet që të jetë subjekt i një kërkese në rritje si për pushues ditorë ashtu dhe për turistë. Kjo kërkesë në rritje duhet të akomodohet në struktura turistike por në të njëjtën kohë duhet të mbështetet në një mobilitet të mirë strukturuar. Rruga e re do të shërbejë si një aks me fluks të madh automjetesh të cilat vijnë nga fshatrat dhe nga qytetet përreth. Në zonë parashikohet një stacion autobuzi dhe taksish cili propozohet të jetë në

afërsi të qëndrës eksistuese të fshatit. Gjithashtu në zonë është i nevojshëm të ndërtohet një parkim i cili do të jetë me kapcitet për të përballuar fluksin maksimal të pushuesve në këtë zonë. Në shëtitoren e propozuar në afërsi të lagunës do të jetë gjithashtu dhe një korsi e dedikuar per biçikleta e cila do të lidhet me shtigjet natyrore. Një tjetër element që e plotëson këtë zonë është dhe propozimi i një moli të vogël për varka me rrema.

Figura x. Harta e mobilitetit në zonë (version paraprak)

Mjedisi

Në lidhje me mjedisin zona e Baks Rrjollit do të synojë ruajtjen e habitateve të saj natyrore. Kjo do të arrihet duke ndaluar zhvillimin në zonat e ndjeshme mjedisore dhe duke e orientuar atë në zona të cilat sot janë të ndërtuara dhe që nuk kanë vlera të veçanta natyrore.

Gjithashtu PDZRK-ja e Baks Rrjollit propozon shtimin e sipërfqeve të gjelbërta në akset kryesore dhe në hapsirat e propozuara rekreative.

Një tjetër aspek që propozohet është shtimi i bimësisë autoktone

Figura x. Harta e ndërhyrjeve mjedisore në zonë (version paraprak)

Shërbimet infrastrukturore

Krahas ndërtimit të rrjetit rrugor në zonë do të ndërtohen rishtazi dhe rrjetet e shërbimet e tjera infrastrukturore. Do të realizohet rrjeti KUZ dhe ITUN.

Rrjeti i furnizimit me energji elekrike që do të vendoset nëntokë duke ofruar kapacitetin dhe qëndrueshmërinë e nevojshme

Furnizimi me ujë kryhet duke rigjeneruar dhe plotësuar kapacitetet e depos ekzistuese dhe duke ndërtuar rishtazi të gjithë rrjetin. Në zonë do të kryhen investime të shtrimit të fibrës optike dhe të rrjetit të telekomunikacionit. Investim i rëndësishëm do të jetë dhe ndriçimi publik i të gjithë zonën.

Tipologjitë Turistike

Zhvillimi turistik i zonës, dikton nevojën e rritjes dhe strukturimit të ofertës akomoduese në zonë. Strukturat sot të orientuara në një turizëm familjar do të përfshihen në zhvillimin e ardhshëm duke u bërë pjesë e strukturimit dhe rigjenerimit urban dhe arkitektonik. Gama e ofertës turistike në zonë do të pasurohet me struktura të reja hoteliere të cilat do të ndërthuren në territor me struktura shërbimesh turistike dhe gastronomike duke rritur aktivitetin ekonomik në

këtë zonë. Zona do të ndahet në disa nënzona ku gjithësecila prej tyre do të ketë tipologji të veçantë hapsinore dhe do të ofrojë aktivitete të ndryshme hapsinore. Në këtë mënyrë turisti do të ketë shumllojshmëri zgjedhjesh që nga resortet e deri tek bujtinat. Zona është e kompozuar në mënyrë që zhvillimi i ardhshëm turistik të tërheqë sa më shumë turistë por njëkohësisht të jetë miqësorë me mjedisin dhe habitatet natyrore. Nënzonat më të ndjeshme mjedisore janë nënzona numër një në të cilën do të zhvillohen struktura të lehta dhe nënzona numër dy e cila është konceptuar si një park natyror dhe do të lidhet me zonat akomoduese nëpërmjet shtigjeve.

Figura x. Tipologjitë turistike, (version paraprak)

Programet dhe projektet e zhvillimit

Që vizioni dhe objektivat e zhvillimit të realizohen janë evidentuar projekte sipas tre drejtimeve kryesore:

1. Përmirësimi i aspekteve mjedisore
2. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e zonave dhe
3. Zhvillimi i turizmit

Këto projekte klasifikohen dhe në bazë të impaktit që kanë:

- Projekte pa të cilat zona nuk mund të funksionojë si zonë turistike dhe
- Projekte që lidhen me funksionimin e përditshëm të zonës.

Disa projekte janë madhore dhe lidhen me politikat kombëtare, të tjera janë projektet e vetë zhvillimit të zonës. Projekte të tjera do të shtohen në fazën e detajimit të planit, por këto projekte do të jenë të lidhura vetëm me funksionimin e zonës në brendësi të saj.

Aspektet Mjedisore

- Shtimi i gjelbërimit autokton me bimësi të lartë dhe të ulët
- Shtimi i gjelbërimit autokton me bimësi të lartë përgjatë rrugës Shëngjin-Velipojë (barrierë vizive dhe akustike)
- Sistemi i grumbullimit diferencimit dhe largimit të mbetjeve urbane
- Trajtimi i mbetjeve organike si kompost (baze familjare në fshat)
- Sistemimi i brezit mbrojtës së lagunës së Vilunit.

Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës

- Sistemimi i aksesit (kryqëzimeve) nga rruga Shëngjin-Velipojë
- Shtimi I trotuareve pergjate aksit Shëngjin-Velipojë
- Sistemimi i kalimeve këmbësore nga rruga Shëngjin-Velipojë
- Ndërtimi i akseve të brendshme të zonës me profil minimal
- Ndërtimi shëtitores këmbësore Velipojë- Baks-Rrjoll

- Vendosja e sinjalistikës rrugore
- Vendosja e sinjalistikes turistike
- Organizimi i Vendparkimeve
- Ndërtimi i një stacioni autobuzi linje dhe taksish
- Ndërtimi i rrjetit të korsive çiklistike
- Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm për kapacitetin turistik të propozuar (bazuar në standardet për turist)
- Ndërtimi i rrjeti të largimit të ujrave të ndotur (shiu dhe te zeza) dhe dërgimi në impiantin e Velipojës

Në parashikimin e infrastrukturës së ujit jemi bazuar në standardet e mëposhtme:

Norma Bruto e FU (Hoteleri)	400 l/ban/d
Norma Bruto per terr. sportive	150 l/d/pers

Zjarri	3 ore/10 l/s (dy zjarre të njëkohshëm)
Vellimi rregullues në Rezervuar	36% e vellimit ditor mesatar
Avaria e Ujesjellesit	8 ore

- Sistemimi i tokave bujqësore në zonë që të mos përmbyten
- Ndriçimi publik i akseve rrugore dhe parkimeve
- Ndriçimi publik i shetitores, shesheve këmbësore dhe parqeve
- Furnizimi me energji elektrike për kapacitetin turistik të propozuar (bazuar në standardet për turist)
- Ndërtimi i rrjetit të fibrës optike dhe telekomunikacionit
- Ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksion i atyre ekzistuese

Zhvillimi i turizmit

- Ndërtimi i tregut të produktit vendas
- Ndrëtimi i një zone shërbimesh tregtare
- Ndërtimi i shërbimeve publike: ambulancë, postë, bankë, etj
- Ndërtimi i lulishteve dhe parqeve me mobilim urban
- Ndërtimi i një zone me aktivitete sportive
- Unifikimi i fasadave dhe mureve rrethues ne fshat

Figura x. Harta e programeve dhe projekteve në zonë (version paraprak)

Parimet e PDZRK-së dhe ndërthurja me Strategjitë / planet e tjera

Nisma për hartimin e PDZRK Baks-Rjoll ndërmerret nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, *i cili hartohen në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar (PPK) "Shqipëria 2030", Planin e Integruar Ndërsektorial të Bregdetit dhe DRAFT-Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2018 – 2022.*Ky plan zhvillohet në përputhje me strategjitë, programet dhe planet kombëtare të zhvillimit ekonomik, procesin e integrimit në BE dhe në përputhje me marrveshjet ndërkombëtare, duke marrë në kosideratë zhvillimin e sektorit të turizmit, minimizimin e ndikimeve negative në mjedis me kosto sa më të ulët dhe të përballueshme. PDZRK-ja është përpjekur të zhillohet në bazë të parimeve të minimizimit të ndikimeve në mjedis, konform ligjeve kombëtare të mbrojtjes së komponentëve mjedisorë, Direktivave Europiane, Draft Strategjisë Ndërsektoriale të Mjedisit 2015 - 2020 dhe dokumentat strategjikë dhe politikë të mbrojtjes së biodiversitetit e komponentëve të veçantë të mjedisit, si mbrojtja e cilësisë së ajrit, ujit dhe zhurmave.

Në mënyrë specifike mbi qëllimet, objektivat dhe parimet e disa dokumentave strategjike dhe planifikuese në nivel kombëtar që merr parasyshë dhe përpiqet të integrojë në vetvete PDZRK-ja, listohen në tabelën në vijim.

Nr.	Strategjitë Kombëtare, Ndërsektoriale dhe Sektoriale	Fusha/synimi	Ndërthurja me planin
1	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020 (**VKM nr. 348, datë 11.5.2016**)	Përcakton prioritetet dhe vizionin kombëtar për zhvillimin e vendit.	Fuqizimi i sektorit të turizmit që nxit zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetesës së qytetarit.
2	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor (**VKM nr.709, datë 29.10.2014**)	Përcakton prioritetet dhe objektivat e zhvillimit rural	Zhvillimi i turizmit në zonat rurale dhe agro-turizmit
3	Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit, (**VKM nr. 594, datë 10.9.2014**)	Përcakton objektivat dhe normat e cilësisë së ajrit në mjedis	Politika ose zhvillime specifike, për turizmin duhet të marrin në konsideratë ndikimin e shkarkimeve në cilësinë e ajrit dhe ndryshimeve klimatike nga pikëpamja e konsumit të energjisë dhe përmirësimit të teknologjisë
4	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 - 2020 (**VKM Nr. 635, datë 1.10.2014**)	Synon rritjen e investimeve nëpërmjet përmirësimeve të vazhdueshme në kuadrin ligjor dhe institucional, stabilitetit dhe rritjes ekonomike të qëndrueshme, përmirësimit të mëtejshëm dhe modernizimit të infrastrukturës.	Rritja e nivelit te konkurueshmerise në sektorin e turizmit me mevendet e rajonit
5	Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit 2015 - 2020 (**VKM nr.31 datë 20.01.2016**)	Përcakton prioritetet dhe objektivat e ruajtjes së natyres	Integrimi i parimeve të mbrojtjes së biodiversitetit në zhvillimin e turizmit në vend
6	Draft Strategjia e Përdorimit të Burimeve Ujore	Përcakton objektivat për ruajtjen e burimeve ujore nëpërmjet kritereve të	Kufizimi i efekteve negative në sistemin ujor përfshirë burimet sipërfaqësore,

		përdorimit të qëndrueshëm të tyre	nëntokësore, ujëra të kripur, të embël, ujë i pijshëm.
7	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2018 – 2022 (draft)	Përcakton objektivat dhe drejtimet kryesore të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në vend.	Zhvillimi i turizmit në zonën bregdetare.
8	Dokumenti i Angazhimeve Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (**INDC, Paris 2015**)	Përcakton angazhimet e Shqipërisë në reduktimin e gazeve serë.	Adoptimi i infrastrukturës së turizmit dhe transportit dhe zbatimi i kritereve në ndërtimin e tyre në përgjigje të ndryshimeve klimatike me qëllim reduktimin e sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë.
9	Plani kombëtar i veprimit Për Menaxhimin e zhurmave në mjedis (**VKM nr.123. datë 17.02.2011**)	Përcakton objektivat dhe masat për menaxhimin e zhurmës në mjedis.	Integrimi i qëllimit të minimizimit të zhurmës në zhvillimin e turizmit në zonën bregdetare
10	Plani i Përgjithshëm Kombëtar (VKM Nr. 881, datë 14.12.2016)	Koordinimin dhe bashkërendimin e politikave dhe planeve sektoriale kombëtare për territorin	Zhvillimi i turizmit dhe rritja e konkurueshmerise së sektorit në nivel rajonal.

Alternativa të konsideruara gjatë hartimit të PDZRK-së

Hartimi i PDZRK-së kaloi në një process të gjatë diskutimi midis ekspertëve, institucioneve dhe grupeve lokale të interest. Përgjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti, VSM-se dhe PDZRK-se, u diskutuan 2 alternativa zhvillimi të zonës, duke ballafaquar aspektet mjedisore dhe ato zhvillimore, për të arritur një balancë dhe zhvillim sa më të qëndrueshëm të turizmit dhe mbrojtjen e aspekteve mjedisore të zonës.

Gjatë procesit të hartimit të PDZRK-së janë bërë ndryshime të shumta, hap pas hapi, të cilat janë reflektuar direkt në dokumentin e planit, duke synuar mbrojtje maksimale të burimeve natyrore dhe sigurimin e një zhvillimi sa më të qëndrueshëm të turizmit.

Alternativat e diskutuara dhe të marra në konsideratë nga PDZRK-ja janë si më poshtë:

> ***1. Alternativa 0*** *- Vazhdimi i situatës dhe gjendjes aktuale të zonë, duke pasur zhvillim të orientuar nga nevojat individuale dhe të pa strukturuara me një plan zhvillimor.*

2. Alternativa 1 - Zhvillimi i zonës duke u bazuar në resurset natyrore dhe ato njerëzorë në territorin e PDZRK-së.

Duke marrë parasyr, ndryshimet që ka pësuar plani gjatë diskutimeve të ngushta midis ekspertëve mjedisor dhe ekspertëve të fushave të tjera, mendohet se krahasimi i dy alternativave është i mjaftueshëm dhe siguron zhvillimin e zonës me ndikime sa më minimale të mundshme.

Alternativa 1: Alternativa 0 - Vazhdimi i situatës dhe gjendjes aktuale të zonë, duke pasur zhvillim të orientuar nga nevojat individuale dhe të pa strukturuara me një plan zhvillimor.

Kjo alternativë nënkupton zhvillimin e zonës të vecuar nga konteksti më i gjerë, rajonal apo shkallë bashkie, duke u zhvilluar në bazë të nevojave vetiake, të pa koordinuara mirë dhe pa një vision të mirëfilltë zhvillimi.

Ky model zhvillimi, do të sjellë një përkeqësim të aspekteve mjedisore, kryesisht në rritjen e mbetjeve urbane të pa menaxhuara mirë, ndotjen e ujrave mbi/nën tokësor, dhe rrit rriskun e përkeqësimit të situatës social ekonomike të zonës. Nga ana tjetër, ku lloj zhvillimi mund të ketë përparësi në aspektin e mbrojtjes së biodiversitetit, duke shpresuar që sy lloj zhvillimi është I ngadaltë dhe duke besuar në zbatimin korrekt të ligjit mbi zhvillimin e territorit.

Alternativa 2 - Alternativa 1 - Zhvillimi i zonës duke u bazuar në resurset natyrore dhe ato njerëzorë në territorin e PDZRK-së.

Alternativa e zhvillimit mbështëtet në vlerat natyrore rajonale dhe në vlerat autoktone të zonës ku mund të përmendim krijimin e një poli turistiko-natyror, duke u nisur nga lumi Buna, Liqeni i Shkodrës, Laguna e Vilunit, Mali i Rencit dhe Monumentit të Ranës së Hedhun. Gjithashtu përpos shumllojshmërisë së atraksioneve natyrore dhe turistike në nivel rajonal zona e Baks Rrjollit do të ofrojë një alternativë zhvillimi turistik konkuruese në vend.
Zona është e ndarë ne 6 polaritete ku secili polaritet ka funksione të ndryshme hapsinore duke ndërvepruar midis tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shërbimeve që do të ofrohen.
Polariteti 1. 2. dhe 3 ose polariteti i quajtur si Strukturim i Situatës Ekzistuese. Në të synohet ristrukturimi dhe rivitalizimi me anë të rregullave të posaçme arkitektonike, shtimi i funksioneve turistike dhe funksioneve publike si dhe krijimin e hapsirave rekreative. Mënyra e ndërhyrjes do të jetë mbushja urbane.
Polariteti 4 i quajtur si poli i lagunës. Një ndër polet e ndjeshme mjedisore të zonës në të cilin synohet ndërtimi i strukturave pikësore dhe që janë miqësore me mjedisin. Në këtë zonë ndërhrja kryesore do të jetë rkonstruktimi dhe krijimi.

Polariteti 5 është poli i cili do të ofrojë shërbime akomoduese me tipologji resorte. Kjo është një tipologji e re e cila do të adaptohet në këtë zonë duke krijuar një koncept të ri ndryshe nga reliteti i vilave dhe strukturave individuale.
Polariteti 6 ose i quajtur si poli natyror do të jetë parku natyror i cili do të funksionojë më anën të shtigjeve natyrore dhe sinjalistikës turistike.

Tabela x. Krahasimi dhe avantazhet e secilës alternative

Nr.	***Çështjet mjedisore***	***Alternativa 0***	***Alternativa 1***
	Degradimi i tokës bujqësore	++	++
	Humbje e tokës bujqësore	+++	++
	Rritje e erozionit të tokës	+	++
	Rënia e pjellorisë së tokës	++	++
	Rritja e prerjeve të paligjshme në pyje	++	++
	Rritja e rasteve të brakonazhit	+	+++
	Mbikullotje	++	+++
	Mbi-shfrytëzimi i bimëve medicinale etero-vajore	+++	+++
	Rënia e larmisë biologjike	+++	++
	Mungesa e menaxhimit të mbetjeve urbane	++	+++
	Sistemimi i ujësjellës kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave të përdorur urban	++	+++
	Rritja e ndotjes së ajrit	++	+
Total		***25***	***28***

Nisur nga vlerësimi i dy tabelave, theksojmë që alternativa 1, ka përparësi, në mbrojtjen e disa prej elementëve mjedisor, kryesisht të përmirësimit të situatës nga ndotja. Gjithashtu kjo alternativë siguron zhvillim të qëndrueshëm të aspekteve social – ekonomike të zonës.

Metodika e hartimit të vlerësimit strategjik mjedisor

Përshkrimi i metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VSM-së, Vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së tij, Burimet e informacionit

Metodologjia për VSM-në e PDZRK-së parasheh gjashtë hapa proceduralë ku secili hap përfshin disa detyra. Për secilën detyrë do të ndiqet një qasje e veçantë në mënyrë që të japë rezultatin e dëshiruar.

Figura x. Proceset e hartimit të VSM-së

Në përputhje me skemën e mësipërme, hartimi i këtij raporti kërkoi dhe zbatimin e një metodike të veçantë përfshirë:

- Mbledhjen e informacionit për aspekte të ndryshme mjedisore përfshirë klimën lokale, të dhënat gjoeologjike dhe hidrogjeologjike, sasinë dhe cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, cilësinë e ajrit, ujërave, tokës, gjendjen e biodiversitetit dhe të natyrës për hapësirën në studim, sistemit të menaxhimit të mbetjeve, sistemit te grumbullimit dhe përpunimit të ujërave të zeza.
- Shqyrtimin e dokumenteve strategjik dhe planifikues me rëndësi për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Këtu mund të përmendim disa plane si:
- Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta

- Planet për Menaxhimin e Zonave të Mbrojtura Ekzistuese
- Plani i Përgjithshëm Vendor
- Studimi dhe analiza e dokumenteve të mësipërm dhe gjetjet në terren, kanë ndihmuar për të kuptuar gjendjen e mjedisit si dhe identifikimin e probleme mjedisore që lindin dhe që duhet të trajtohen nga ky plan.
- Megjithë burimet e mësipërme, hartuesit e raportit janë përballur njëkohësisht me vështirësi përsa i përket disa të dhënave për të cilat mungojnë studimet e detajuara për komponentë të ndryshëm mjedisorë. Të dhënat për cilësinë e ajrit, zhurmat, cilësinë e ujërave etj janë të fokusuara vetëm në qendrat urbane kryesore duke lënë jashtë monitorimit qendrat urbane më periferike. Mungesa e të dhënave vërehet edhe për elementë të tjerë sikurse larmia biologjike, nivelet e erozionit të tokës etj.

Objektivat strategjikë mjedisorë

Raporti Mjedisor përcakton fushat dhe objektivat mjedisore të rëndësishme si më poshtë:

- ***Toka dhe burimet minerale***

Objektivi mjedisor 1: Sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së tokës.

Objektivi mjedisor 2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të ricikluara në ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës së turizmit.

Ajri

Objektivi mjedisor 3: Ruajtja e cilësisë së ajrit në qendrat e banuara dhe sigurimi i arritjes së objektivave afatgjata kombëtare për sasitë vjetore të emetimeve të ndotësve atmosferikë.

Faktorët klimatikë

Objektivi mjedisor 4: Përshtatja ndaj efkteve të ndryshimit të klimës globale dhe reduktimi i sasive të emetimeve të gazeve serë.

Uji

Objektivi mjedisor 5: Kufizimi i ndikimeve të presionit të infrastrukturës së turizmit mbi ujërat e sipërfaqes dhe nën-tokës, ujërat e lumenjëve, ujërat bregdetarë, lagunorë dhe burimet e ujit të pijshëm.

Natyra

Objektivi mjedisor 6: Sigurimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit në territor.

Objektivi mjedisor 7: Ruajtja e larmisë biologjike të zonave me status natyror të mbrojtur përkundrejt aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Ndotja nga zhurma

Objektivi mjedisor 8: Parandalimi/Reduktimi i ndotjes së mjedisit nga zhurma dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE

Popullsia dhe asetet materiale

Objektivi mjedisor 9: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve në brendësi/afërsi të zonës së PDZRK

Trashëgimia kulturore

Objektivi mjedisor 10: Ruajtja e fushëveprimit dhe karakteristikave të objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore.

Peizazhi

Objektivi mjedisor 11: Sigurimi i ruajtjes së peizazheve të jashtëzakonshme dhe zonave me peizazhe me karakteristika të veçanta në nivel lokal dhe kombëtar dhe një imazh peizazhi me cilësi.

Përshkrimi i Përbërësve të Mjedisit

Pozita gjeografike

Zona në studim ndodhet në fshatin Baks-Rrjoll e pozicionuar në njësinë administrative të Velipojës në bashkinë e Shkodrës. Velipoja shtrihet në jug të Shkodrës në një distancë prej 25 km nga qyteti. Fshati Baks-Rrjoll kufizohet nga fshatrat Velipojë, Bajramaj dhe Kel Marashi.

Dy polet turistike më të zhvilluara dhe më të afërta me zonën e studimit janë Velipoja 16.2 km rrugë automobilistike dhe Shëngjini 60.8 km rrugë automobilistike.

Ky fshat ndodhet 39.2 km larg nga dogana e Muriqanit, 98.3 km nga aeroporti I Rinasit dhe 124 km nga porti I Durrësit.

Pozita gjeografike dhe afërsia me pikat kufitare i jep prioritet kësaj zone për zhvillimin e turizmit. Nga rrjeti rrugor ekzistues mund të përmendim rrugët hyrse që lidhen më akset kombëtare. Pika më e rëndësishme hyrëse është nga autostrada Tiranë-Shkodër, në vendin e quajtur “Harku i Bërdicës”, rrugë automobilistike që përshkohet me makina, autobusa, motorra,biçikleta, furgona, etj. Rruga përshkon fshatrat Bërdicë, Trush kalon tek Ura e Gjolulit përshkon fshatrat Mali i Kolaj dhe Baks i Ri dhe më pas kthehet majtas përshkon një rrugë të asfaltuar, me gjatësi 8 km për në zonën turistike të fshatit Rrjoll.

Pozita e favorshme gjeografike ku ndërthuren deti, laguna, fusha pjellore, dhe mali i japin kësaj zone një mundësi të madhe për zhvillimin e turizmit detar dhe malor, të peshkimit, të zhvillimit të kulturave të ndryshme bujqësore dhe të blegtorisë. Zona me PDZRK kufizohet nga 4 elementë të rëndësishëm të cilat janë: Deti Adriatik, Laguna e Vilunit, Mali i Rencit dhe monumenti natyror Rana e Hedhun.

Zona e PDZRK-së shtrihet nga laguna e Vilunit deri te monumenti i Ranës së Hedhun. Për një zhvillim të qëndrueshëm në aspektin turistik zona ndahet në dy nënzona. Nënzona 1-Ka prioritet studimi dhe zhvillimi. Kjo nënzonë ka një sipërfaqe prej 367.03 ha . Nënzona 2-Ka prioritet mbrojtjen e natyrës dhe ka karakter tërësisht natyror. Kjo nënzonë ka një sipërfaqe prej 275.39 ha.

Klima

Tiparet klimatike shprehen dhe në shpërndarjen hapësinore dhe regjimin në kohë të treguesve të elementëve klimatike. Zona e velipojës dhe Baks-Rrjollit karakterizohet nga klimë mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë, dimri është i lagësht dhe i butë. Era e murrlanit është karakteristike për Velipojën, e bën dimrin pak me tipar të acartë, ndërsa ne verë, era e Shirokut sjell lagështi.

Velipoja dhe rrethinat si një fushë e madhe dhe pranë ndikimit të detit ka vlerë të temperaturës mesatare vjetore 15.3°C, dhe muajin më të ftohtë Janarin 6.6°C dhe muajin më të nxehtë Korrikun 24°C.

Topografia

Baks-Rrjolli ofron një kombinim unik të habitateve përgjatë bregdetit, peizazhe karstike malore dhe shpatet të pjerrët, duna ranore, pyje aluviale, këneta të përkohshme në ndërthurje me plazhin me rërë të pastër e të bollshëm. Zona në fjalë ka një kombinim harmonik midis zonës rurale dhe

asaj natyrore, duke ruajtur të fortë tiparin natyror. Era ka formuar një peizazh me duna ranore deri në 50m^2 të lartë në shpatet jugor të malit të Rencit.

Zona e Rëndësisë Kombëtare (ZRK) Baks-Rrjoll karakterizohet nga një terren i rrafshët në kuota që fillojnë në nivel të detit dhe shtrihen deri në disa metra në shpatin jugor të malit të Rencit[3]. Sipërfaqa e zonës është rreth 150 ha dhe shtrihet në fushën e fshatit Baks-rrjoll përgjatë vijës bregdetare në jug të Lagunës së Vilunit. Edhe pse një sipërfaqe relativisht e vogël, në këtë zonë takohen një larmi formash dhe peizazhesh, si sipërfaqet ranore (plazhi), dunat ranore me bimësi pionere, ligatinat, godullat në formë lagune të vogël, sipërfaqe të mbuluara me bimë barishtore dhe shkurreta, drurë të larë dhe pjesa e pjerrët e shpatit të Malit të Rencit.

Figura 2. Hartë topografike, ZRK Baks-Rrjoll

Burimi: Geoportal.asig.gov.al, 2020

Gjeologjia

Në zonën në studim dhe rethinat shikohet prania e depozitimeve të formacioneve neogjene dhe kuartenare. Shkëmbinjtë sedimentarë të periudhës neogjene janë të përbërë nga gurë baltorë dhe gurë ranorë. Depozitimet e Kuaternarit kanë përhapje nga Bajza - Kopliku deri në Lezhë. Fragmente vërehen në pjesën më të ulët të zonës, nga fshati Baks-Rrjoll e deri në skajin jugor, duke përfaqësuar disa tipe gjenetike nga ato kënetore, liqenore dhe ndërmjetëse (lagunore, deltore) dhe depozitimet detare. Në mjaft raste takohen dhe tipe gjenetike të përziera[4].

[2]Schneider-Jacoby M., Schëarz U., Sackl P., Dhora D., Saveljic D. and Stumberger B. (2006): Rapid assessment of the Ecological Value of the Bojana-Buna Delta (Albania/Montenegro). Euronatur, Radolfzell.
[3]Harta Topografike e Shqipërisë, Shk-1:10,000
[4]SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Shkodër, Tiranë, 2014

Ndërsa torfa dhe suargjila torfike përhapen kryesisht në fushën e Velipojës nga Viluni deri në brigjet e Bunës. Ndërtohen kryesisht nga material argjilor, suargjilor të ndërthurur me material torfik (organogjen bimor). Këto dhera kanë trashësi të ndryshme nga 10m deri në 30m si aluvialo-proluviale, aluvialo-kënetore, proluvialo-liqenore etj. Fusha e Baks-Rrjolli, Velipojës e më gjerë, janë të sheshta me kuota nga 0m deri në 5m, rrallë deri në 20m. Kjo zonë ka pjerrësi shumë të vogël deri horizontale. Nga ana gjeologjike ndërtohen kryesisht nga argjila të përziera me material ranor[5].

Strukturat e rrudhosura antiklinale përfaqësohen nga kodrat në afërsi të Velipoës (Vazhdimi veriperëndimor i Kurrizoreve të Kakarriqit dhe Rrencit) ndërtohen kryesisht nga gëlqerorët e kretakut të sipërm dhe eocenit të zonës Kruja dhe kodrat e Bushatit dhe Bërdicës, Tepës dhe Oblikës të cilat ndërtohen nga depozitimet flishore të zonës Krasta - Cukali dhe Kruja. Shpatet e këtyre kodrave kanë pjerrësi nga 5 deri në 350 dhe drejtime rënie të ndryshueshme. Kuotat e tyre janë te ulta nga 50m deri në 150m. Shpatet shpesh janë të rrumbullakosur nga modelimi i shkaktuar nga rrjedhjet ujore sipërfaqësore[6].

Rërat kanë përhapje në formë rripash dhe në vetvete nënkuptojnë depozitime aluviale me granulometri të ndryshueshme të depozitimeve detare të quajtura rëra të plazheve në Velipojë dhe Baks-Rrjoll. Mund të jenë rëra nga kokrrizmadh deri kokrriz imët, të cilat arrijnë trashësi nga 2m deri në 20m[7].

[5]SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Shkodër, Tiranë, 2014
[6]SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Shkodër, Tiranë, 2014
[7]SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Shkodër, Tiranë, 2014

Cilësia e tokave

Tokat në zonën në studim konsiderohen të kripura në nivele tepër të larta. Në zonën e Velipojes këto toka arrijnë shifrën e mbi 400ha[8], të cilat konsiderohen me kripshëri tepër të lartë dhe me përshtatshmëri të ulët për kultivimin e kulturave bujqësore në to. Kripëzimi është me origjine detare nëpërmjet infiltrimit, ku dominojnë kripërat e klorit. Për të përcaktuar qëllimin e përdorimit të mëtejshëm të këtyre tokave, shikohet e nevojshme të bëhet një analizë financiare mbi kostot e nevoshme për rehabilitimin e kësaj sipërfaqje toke, ose ndryshimi i qëllimit të përdorimit të tyre. Mungesa e kullimit dhe kultivimit të tyre përkeqëson më tej strukturën, cilësitë dhe produktivitetit e këtyre tokave.

Përdorimi i tokës

Për qëllime planifikimi, bazuar në legjislacion në fuqi territori ndahet në sisteme territoriale. Në territorin e Baks Rrjollit gjënden të 5 sistemet territoriale.

Sistemi urban

Sistemi urban zë një sipërfaqe prej 457208.83 m2 të zonës në studim. Gjeneza e krijimit të zonës urbane në këtë fshat ka qenë në zonën që sot konsiderohet si “qendra e fshatit”. Zhvillimi ka qënë kompakt I orjentuar drejt shtëpive të banimit, shtëpive të dyta si dhe

[8]Bashkia Shkodër, Vlerësimi strategjik Mjedisor për PPV-në, 2017

bujtinave. Edhe pse fshati ka një shtrirje lineare zhvillimi ka qënë deri diku kompakte dhe kjo vjen pasojë e afërsisë me rrugën hyrëse në këtë fshat.

Sistemi natyror

Territori i Baks Rrjollit ka një sipërfaqe prej 4536753.76 m2 që i përket sistemit natyror. Ky sistem zë sipërfaqen më të madhe rreth 71.60 % të sipërfaqes totale të territorit. Sistemi natyror së bashku me sistemin ujor I japin zonës vlera të veçanta peisazhistike.

Sistemi bujqësor

Sistemi bujqësor zë një sipërfaqe prej 688110.81 m2 dhe përbën një sektor mbështetës për zhvillimin eardhshem të turizmit në këtë zonë. Bujqësia është e favorizuar nga klima e butë dhesasia e bollshme ereshjeve. Në këtë zonë ajo përfaqësohet nga kulturat sezonale dhe iniciativaprivate e orjentuar kryesisht mebaçe dhe jo parcela bujqësore.

Sistemi ujor

Sistemi ujor përbën 675586.81 m2 të sipërfaqes së përgjithshme të zonës në studim. Në këtësipërfaqe bejnëpjesë kryesisht tokat kënetore. Zona gjithashtu preket nga ujrat e detit Adriatik në zonën e saj perëndimoresi dhe nga ujrat e Lagunës së Vilunit në pjesën veriore të zonës. Këta elementë e bëjnë këtë zonë të veçantënga zonat e tjera.

Sistemi infrastrukturor

Sistemi infrastrukturor zë një sipërfaqe prej 68563.08 m^2 Një ndër zërat që përfshihet në këtë sistem është rrjeti rrugor i cili është I pazhvilluar. Aksi I vetëm që mund të permendim është rruga hyrëse e fshatit BaksRrjoll Pjesa tjeter e rrjetit rrugor përbëhet nga shtigje. Nga tabelavihet re se dominon sistemi natyror, bujqësor dhe ujor. Kjo tregon që zona ka një karakterpothuajse natyror ku zhvillimet urbane dhe ato infrastrukturore janë të pakta.

Hidrografia

Ujërat sipërfaqsorë

Zona e Rëndësisë Kombëtare Baks-Rrjoll shtrihet në jug të lagunës së Vilunit, e cila është formuar në grykëderdhje të lumit Buna. Laguna e Vilunit dhe disa ligatina të vogla që ndodhen në pjesën jugore furnizohen kryesisht nga ujërat e detit dhe pjesërsisht nga reshjet e shiut dhe disa përrenj të përkohshëm (përrenj të thatë) të vegjël që zbresin nga shpati jugor i malit të Rencit.

Konkretisht ujërat sipërfaqsorë në zonë përfaqësohen nga ujërat bregdetar të detit Adriatik, Laguna e Vilunit, përrenj të vegjël sezonal dhe disa ligatina të vogla e të cekta, shumica prej të cilave janë sezonale, ku në periudhën me reshje të shumta ato shfaqen pothuajse në të gjithë sipërfaqen e zonës. Këto ligatina ushqehen me ujë edhe nga disa përrenj që zbresin nga pjesa jugore e shpatit të malit të Rencit. Në zonë kalojnë rreth 15[9] përrenj të vegjël, që derdhen në det, ndër kryesorët mund të përmendim përroin e Lugut të Madh dhe Përroin e Lugut të Borës. Këto përrenj janë të përkohshëm, aktivizohen vetëm në periudhën e reshjeve, duke krijuar rrjedha të vrudhshme që zbresn nga faqja e malit drejt detit me një gjatësi mesatarisht prej 1km.

[9]Harta Topografike e Shqipërisë, Shk-1:10,000

Figura 7. Ujërat Sipërfaqsorë, ZRK Baks-Rrjoll

Burimi: Geoportal.asig.gov.al, 2019

Cilësia e ujrave sipërfaqësor

Përsa i përket cilësisë së ujërave sipërfaqësorë në zonën në studim vlen të theksohet që janë të një cilësie të mirë, pasi ndodhen në një zonë pothuajse natyrore dhë nuk rezulton ndonjë e dhënë direkte apo indirekte që të vertetojë të kundërtën.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka bërë monitorimin e cilësisë së ujërave bregdetar (ujërat e larjes) në 7 pika në Velipojë dhe 5 pika në plazhet e Shëngjinit[10]. Për stacionet e zonave bregdetare janë monitoruar treguesit si temperatura, pH, alkalinitet, saliniteti, përcjellshmeria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal, PO_4 dhe lënda pezull. Duke analizuar elementët e mësipër AKM-ja ka nxjerrë të dhënat duke i grupuar në 4 nivele cilësie, A-Cilësi e Shkëlqyer, B-Cilësi e Mirë, C-Cilësi e Mjaftueshme dhe D-Cilësi e Keqe.

Në të gjitha pikat e monitoruara nga AKM-ja rezultoj se ujërat bregdetar janë të cilësisë së shkëlqyer, pra niveli i cilësisë A[11]. Duke marrë parasyshë që lumi Buna dhe Drin mbledhin të gjitha ujërat e përdorura të zonës urbane të Shkodrës dhe qytetit Vau i Dejës, bashkë me fshatrat përgjatë rrjedhës së lumit deri në Velipojë, këto monitorime mund të jenë të kontestueshme.

[10]AKM, Raporti i Gjendjes në Mjedis 2017, Tiranë, 2018
[11]AKM, Raporti i Gjendjes në Mjedis 2017, Tiranë, 2018

Ujërat nëntokësorë (Akuiferët)

Zona në studim ndodhet në shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh dhe akuifer me porozitet çarje - karst dhe ujëpërcjellshmëri tepër të ndryshueshme (shumë e lartë - shumë e ulët). Këto tipe shkëmbinjsh takohen në një rrip të hollë në zonën bregdetare (shkëmbinjtë pa porozitet) dhe pjesa krastike në pjesën e malit të Rencit. Këto akuiferë janë pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor, çarjesh e karsti dhe lidhen me depozitimet argjilore, liqenore e këne tore të Kuate rnarit dhe d e pozitim e t flishore të Cr2 c m - argjila, ranorë, mergele. Kështu nga de pozitime te Mastrihtian - Eocenit kemi flishalevrolito – ranorë - merglorë. Burimet që lidhen me këto depozitim e kanë prurje të vogla 0.01 - 0.1 l/sek dhe nuk paraqesin rëndësi praktike për furnizim të përqëndruar me ujë[12].

Zona rrethohet nga akuifer me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare - të ulët (argjila + rërë + suargjila), qe fillon që nga pjesa veriore e Vilunit, fushën e Nënshkodrës e deri në Koplik.

Zona në studim është pjesë e Akuiferit të Nënshkodrës, akuifer i cili ka një përhapje mjaft të gjerë në luginat dhe fushat e formuara nga lumenjtë Drini e Buna. Në jug ky akuifer kufizohet me fushën e Zadrimës, ndërsa në veri me akuiferin e Mbishkodrës. Ai shtrihet në gjithë pjesën e ulët fushore dhe është formuar me aktivitetin akumulativ të materialit të shkrifët aluvional të depozitimeve kuaternare të lumenjve Buna e Drin. Akuiferi përbëhet nga shtresa të fuqishme zhavorresh e zhuresh me veti të larta filtruese, të cilat grumbullojnë sasira të konsiderushme rezervash të ujërave nëntoksore të freskëta[13].

Ujërat nëntoksore të zhavorre të këtyre luginave aluviale kanë lidhje të mira hidraulike,me ujërat sipërfaqsore të lumenjeve Buna e Drin, prandaj jane të pasura dhe përmbajnë rezerva të konsiderushme, gjë e cila është vërtetuar nga shpimet e kryera. Koeficentët e filtrimit luhaten nga 30-50 m/ditë dhe prurjet specifike nga 5-10 lit/sek/m, në zonat e ekstremeve perëndimore, jugperëndimore e jugore të pellgut deri në 400-700 m/ditë dhe 100-150 lit/sek/m respektivisht në pjesën më të madhe të tij e sidomos në sektorët më afër lumenjeve Buna e Drini[14].

[12]SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Shkodër, Tiranë, 2014
[13]SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Shkodër, Tiranë, 2014
[14]SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Shkodër, Tiranë, 2014

Burimi: SHGJSH, 2014

Cilësia e ujrave nëntokësorë

Ujërat nëntokësore të pellgut të Nënshkodrës janë në përgjithësi të freskëta dhe veti të mira fiziko- kimike, temperaturë nga 12 -16°C, mineralizim të përgjithshëm nga 0.2 deri 0.5 gr/l. Në disa sektorë mineralizimi arrin deri 0.7 gr/lit vetëm në një zonë të Barbullushit kemi Mp mbi 1gr/l. Fortësia e përgjithëshme lëviz nga 7 deri 20 gradë gjermane. Me mineralizim dhe fortësi më të vogël janë ujërat në pjesën lindore të pellgut dhe afër lumenjeve Buna e Drin[15].

Në drejtimin perëndimor, duke filluar prej fshatit Pentar e deri në derdhjen e lumit Buna në detin Adriatik dhe në të gjithë zonën e Velipojës dhe Rrjollit, ujërat nëntokësore janë nen ndikimin e intruzionit e detit dhe janë të kripur. Mineralizimi i përgjithshem shkon nga 2 gr/l deri në 16 gr/l ne bregdetin e Adriatikut.

Cilësia e ajri

Verifikimi i kryer në të gjitha burimet e certifikuara të informacionit mbi cilësinë e ajrit, përfshirë këtu Raportet e Gjendjes në Mjedis për vitet 2011-2018 apo raportime të tjera të

[15]SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Shkodër, Tiranë, 2014

Institutit të Shëndetit Publik dhe Institutit të Fizikës Bërthamore, tregon se nuk ka monitorime të kryera nga Institucionet publike në territorin e Velipojës dhe zonën në studim. Po kështu nuk ka as thë dhëna të raporteve të vetëmonitorimit duke qenë se në këtë zonë nuk ka subjekte të licensuara industriale që të kenë detyrimin ligjor të hartimit të raporteve të vetëmonitorimit.

Megjithë mungesën e të dhënave, ka argumente të mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se cilësia e ajrit është brenda normave të vendit për sa i takon niveleve të lejuara të ndotjes nga pluhurat PM10 dhe $PM_{2.5}$, dioksidin e squfurit (SO_2), oksidet e azotit (NO_x), ozonin troposferik (O_3), Monoksidin e karbonit (CO), komponimet organike të avullueshme (Benzeni C_6H_6).

Ndryshimet Klimatike

Aktualisht, Shqipëria po përjeton ndikim të ndryshimeve klimatike, kryeshit në zgjatjen e periudhes se thate, itensifikimin e rasteve ekstreme të motit, përmbytje dhe çrregullime në sektorin e bujqësisë. Shqipëria ka bërë parashikim të gjithë këtyre ndikimeve për të ardhmen për periudhat 2030 - 2100. Efektet që pritet të kenë këto ndryshime përfshijnë rritjen e temperaturave, reduktimin e reshjeve dhe shtimin e thatësirave, çrregullimet e motit dhe ngritjen e nivelit të detit dhe përmbytjet.

Në skenarët e rritjes së temperaturës, deri në vitin 2050, parashikohet rritje mesatare e temperaturës prej 1.7^{o}C dhe rritja maksimale në rastin e skenarit më negativ parashikohet të jetë prej 2.2^{o}C Deri në 2080, temperatura parashikohet të rritet me 2.8^{o}C, ndërkohë që vlera maksimale e parashikuar e rritjes është 3.5^{o} C. Deri në vitin 2100, temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4^{o} C ose 4.1^{o} C në rastin e skenarit më negativ. Gjithashtu pritet që të ketë një rritje të theksuara të zgjatjes së numrit të ditëve me kushte ekstreme të temperaturave mbi 35°C ose më të ulta se 0°C.Sipas parashikimeve, në vitet e ardhshme sasia e reshjeve pritet të ulet deri në 14.37% në vitin 2080, dhe deri në më shumë se 18% në vitin 2100. Periudhat e thatësirës pritet që rriten duke bërë që sezonet e verës do të jenë 50% më të thata. Me mungesën e reshjeve Vendi to të hasë një problem serioz në zhvillimin e sektorëve të energjisë, bujqësisë dhe në aspektet natyrore në përgjithësi. Gjithashtu është parashikuar rritje e nivelit të detit me 5-14 cm deri në vitin 2030 dhe me 49 cm deri në vitin 2100. Deri më tani, Deti Adriatik është ndikuar nga ndryshimet klimatike globale, duke rritur nivelin e ujrave më një centimetër në vit dhe është ngrohur me 0.5^{o}C krahasuar me vitin 1970[16].

Rritja e Nivelit të ujrave të detit, do të shkaktojë probleme të mëdha në zonën bregdetare, kryesisht në përmbytje, kripëzim të tokave bujqësore dhe të ujrave nëntokësor dhe erozion. Këto ndikime priten të nxiten edhe si pasojë e një sërë problematikazh zinxhirë si prishja e sitemeve ligatinore në vijën bregdetare, prishja e dunave ranore, mungesa e sedimentimit në grykëderdhjet

[16]Ministry of Tourism and Environment, Third National Communication of the Republic of Albania under the United. Communication Report, Tiranë 2016

e lumenjëve për shkak të ndërtimeve të HEC-eve në pellgjet ujbledhëse të lumenjëve dhe dëmtimi i brezit mbjojtës me pisha në zonën bregdetare[17].

Zhurmat në mjedis

Verifikimi i kryer në të gjitha burimet e certifikuara të informacionit mbi zhurmat në mjedis, përfshirë këtu Raportet e Gjendjes në Mjedis për vitet 2011-2018 apo raportime të tjera të Institutit të Shëndetit Publik dhe Institutit, tregon se nuk ka monitorime të kryera nga Institucionet publike në territorin e Velipojës dhe zonën në studim. Po kështu nuk ka as thë dhëna të raporteve të vetëmonitorimit duke qenë se në këtë zonë nuk ka subjekte të licensuara industriale që të kenë detyrimin ligjor të hartimit të raporteve të vetëmonitorimit.

Megjithë mungesën e të dhënave, ka argumente të mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se niveli i zhurmave në mjedis është brenda normave të vendit.

Natyra

Habitatet kryesore

Zona në fjalë dhe territori përrreth është një sistem tipik ligatinor, që fillon që nga grykderdha e lumit Buna e deri në afërsi të Ranës së Hedhun, duke përfshirë një kombinim habitatesh të rëndësishme, si laguna e Vilunit, dunat bregdetare më dëllënjë (*Juniperus oxycedrus macrocarpa*), dushkaja me bulger (*Querqus trojana*), pyjet bregdetarë të dunave ranore me pisha (*Pinus halepensis, P. pinea, P. pinaster)* dhe të plepit *(Populus alba*)dhe tokat e lagura me bime barishtore[18].

Laguna e Vilunit është trupa kryesore ujore e këtij ekosistemi bregdetar. Ajo ndodhet 2 km në lindje të plazhit të Velipojës dhe mbulon një sipërfaqe rreth 300 ha. Një kanal natyror bën lidhjen e saj me detin. Kanali ndan njëkohësisht plazhin e Velipojës nga ai i Rrjollit. Komunikimi me detin sigurohet nëpërmjet baticë-zbaticës. Temperatura mesatare e ujit në lagunë luhatet 20-22 ºC. Bazuar në gjithë larminë e saj, zona është mjaft tërheqëse për vizitorët dhe aktivitete sportive si shëtitje, peshkim etj. Kjo zonë mund të vizitohet në çdo periudhë të vitit dhe të shijohen bukuritë e saj.

[17]R. Gjoka, Xh. Hoxha, K. Bashmili "Qeverisja për zgjidhjen e problematikave që lidhen me ndryshimet klimatike", 2018
[18]AKZM, Peizazh i mbrojtur Lumi Buna - Velipojë, ëeb: ëëë.akzm.gov.al, 2019

Laguna e Vilunit në Velipojë rrethohet nga bimësi barishtore halofile e dominuar nga *Arthrocnemum sp*, *Saliconia sp*. etj. Këtu takohen një larmi jo vetëm bimësh barishtore, por edhe drunore.

Pyjet aluvionale dhe **pyjet breglumorë**. Pyjet higrofile ose pranë vijave ujorë janë të pasura veçanërisht me lloje endemike (si *Quercus robur* subsp. *scutariensis*) dhe përfshijnë habitate të veçanta të renditura në rrjetin Evropian Natura 2000 si parësore për ruajtje në gjendje natyrore.

Figura 1. Foto nga zona, ZRK Baks-Rrjoll

Flora dhe fauna

Studim i publikuar në 2015[19] nga Fanelli *et al*. (2015) dhe në 2006 nga EuroNatur kanë sjellë përkatësisht të dhëna të hollësishme për speciet bimore dhe shtazore të pranishme në Zonën e Pejzazhit të Mbrojtur Lumi Buna Velipoje.

Lloje dhe habitate bimore të rëndësishme

U identifikua një numër i përgjithshëm prej 10 llojesh bimore të synuara, me interes ruajtjeje të veçantë Sipas të dhënave të listës së kuqe për Shqipërinë, katër prej këtyre llojeve janë klasifikuar si të Rrezikuara, dhe gjashtë të tjerat si të Cenuara. Kjo e fundit përfshin Salvia officinalis, një shkurre e cila kultivohet për qëllime komerciale dhe që po kërcënohet nga mbishfrytëzimi. Nëntë prej këtyre 10 llojeve janë të përfshira në listën e kuqe të të dhënave për Evropën (tre si Pothuajse të Kërcënuara, gjashtë si Pak Problematike) dhe gjashtë për botën (të gjitha Pak Problematike).

U identifikua një numër i përgjithshëm prej 19 bashkësish të veçanta të bimëve të synuara, me interes ruajtjeje të veçantë. Këto përfshijnë të pesë (5) tipet e pyjeve aluvionale, tetë tipet e

[19] Fanelli, G, De Sanctis, M., Gjeta, E., Mullaj, A. and Atorre, F. 2015. The vegetation of Buna River Protected Landscape (Albania). Hacquetia 15/1. Pp.46.

ligatinave, tre tipet e dunave ranore dhe në kodrat karbonatike, një bashkësi dushku të thatë dhe dy bashkësi shkurrishtesh.

Fauna

Zona e Pejzazhit të Mbrojtur Lumi Buna Velipojë (PMLBV) mbështet një shumëllojshmëri të gjerë të llojeve të kafshëve dhe është veçanërisht i pasur me lloje ujore. Fauna përfshin një numër të madh llojesh me interes ruajtjeje në nivel global, rajonal apo kombëtar.

a. Gjitarët

Llojet më të zakonshme të gjitarëve brenda PMLBV-së përfshijnë: *Lepus capensis* (Lepuri i Egër), *Vulpes vulpes* (Dhelpra e Kuqe), *Canis aureus* (Çakalli), *Meles meles* (Vjedulla Europiane), *Mustela nivalis* (Nuselala) dhe *Sus scrofa* (Derri i Egër) (Beqiraj, 2006). Euronatur (2006) regjistroi praninë e 22 llojeve të gjitarëve, duke përfshirë dhe *Ursus arctos* (Ariu i Murrmë). Ndërkaq po ky studim raporton dhe për praninë e *Tursiops truncates* (delfini hundëçekiç) dhe Lundërzës (*Lutra lutra*) e kërcënuar me statusin Afërsisht e Rrezikuar në nivel global, në lumin Buna dhe deltën e Bunës.

b. **Shpendët**

PMLBV-ja mbështet një bashkësi të pasur të shpendëve, veçanërisht të shpendëve të ujit. Euronatur (2006) regjistroi praninë e 238 llojeve të shpendëve. Këta përfshinin 114 shpendë folezues (statusi: folezim i konfirmuar apo i mundshëm) dhe 16 lloje me mundësi folezimi në zonë. Përveç kësaj, 52 lloje klasifikohen si të rregullta dhe 51 të tjera si shpendë shtegtarë të rastit apo vizitorë dimërorë. Së bashku me disa lloje me interes ruajtjeje, prania e një numri të lartë të shpendëve ujorë për dimërim ishte një nga shkaqet për shpalljen e PMLB-së dhe Liqenit të Shkodrës si një zonë Ramsar.

Të dhënat e mbledhura nga numërimet e dimrit tregojnë fluktuacione të numrit të përgjithshëm të individëve shpend uji dimërues. Mesatarisht zona strehon rreth 4240 individë ndërsa shifra më e lartë e regjistruar i takon vitit 2001 me 8421 individë të shpendëve të ujit.

c. **Zvarranikët**

Euronatur (2006) regjistroi praninë e 19 llojeve të zvarranikëve brenda PMLBV-së, të cilët përfshihen në të dhënat e listës së kuqe të IUCN-së për vitin 2009; katër prej tyre si Pothuajse të Kërcënuar, 10 si Pak Problematike dhe pesë si të Pavlerësuara.

d. Amfibët

Euronatur (2006) regjistroi praninë e 11 llojeve të amfibëve, ku të gjitha ndodhen në të dhënat e listës së kuqe të IUCN-së të vitit 2012, një si e rrezikuar dhe 10 si pak problematike. Mbledhja e bretkosave për furnizimin e restoranteve u raportua si praktikë e përhapur.

e. **Peshqit e ujërave të ëmbla**.

Euronatur (2006) regjistroi praninë e 143 llojeve të peshqve të ujërave të ëmbla (Liqeni i Shkodrës, Lumi i Bunës dhe Laguna e Vilunit). Ky përfshin blinin e Adriatikut (*Acipenser sturio*), i cili pothuajse është zhdukur. Ky diversitet i lartë i llojeve reflekton mozaikun e larmishëm të habitatit të Deltës së Bunës. Gjithashtu, Lumi Buna lidh dhe integron bashkësitë e peshqve të detit Adriatik me ato në brendësi të liqenit të Shkodrës dhe të sistemit të lumit Drin. Kështu, edhe pse bashkësia e peshqve mbizotërohet nga llojet tipike të ujërave të ëmbla të buta, ajo përfshin gjithashtu disa lloje nga ujëra më të ftohta që kanë hyrë në sistem për Liqenet e Ohrit dhe Prespës në rrjedhën e lumit Drin, si dhe disa lloje detare.

Beqiraj (2006) vëren se Buna është thelbësore për shtegtimin e 13 llojeve të peshqve nga ujërat e brendshme për në Detin Adriatik. Midis llojeve shtegtare, gjashtë janë të kërcënuar në nivel global, konkretisht blini evropian i detit (*Acipenser sturio*), blini i Adriatikut (*Acipenser naccarii*), blini (*Acipenser stellatus*) dhe harenga evropiane (*Alosa fallax*), lampetra e lumit (*Lampetra fluviatilis*) dhe lampetra e përroit (*Lampetra planeri*).

f. Jovertebrorët

Ka të dhëna të kufizuara në lidhje me ekzistencën e jovertebrorëve brenda PMLBV-së. Euronatur (2006) regjistroi praninë e 217 llojeve në lagunat e Vilunit dhe ligatinat e Velipojës. Beqiraj (2006) vëren se molusqet janë grupet më të njohura dhe se janë regjistruar tre lloje të molusqeve të kërcënuara në nivel global (*Unio elongates*, *Unio crassus* dhe *Microcondylaea compressa*).

Zonat e mbrojtura

Zona e Baks-Rjollit është pjesë e kompleksit ligatinor Bunë-Velipojë, zonë e mbrojtur kombëtare dhe ndërkombëtare për shkak të vlerave të larta të biodiversitetit. Kjo sipërfaqe gëzon të paktën pesë vlerësime të rëndësishme:

1. Zonë e Peizazhit të Mbrojtur "Lumi Buna - Velipojë", shpalllur me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 682, datë 02.11.2005 "Për shpalljen e Lumit Buna dhe të territorreve ligatinore përreth tij "Pejzazh ujor/tokësor i mbrojtur"".
2. I njëjti territor është gjithashtu zonë Ramsar apo ligatinë e rëndësisë ndërkombëtare si habitat i shpendëve ujore, shpallur me VKM nr. 683, date 2.11.2005 "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të liqenit të Shkodrës e të zonës së lumit Buna, zonë natyrore

veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht, si habitate të shpendëve ujorë".

3. Është Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) e Velipojës, njohur nga BirdLife International që prej vitit 1993 dhe njëkohësisht me Urdhërin e Ministrit të Mjedisit nr. 283, datë 10.04.2013.
4. Njihet si Zonë kandidate Emerald nga konventa e Bernës *dhe*
5. Është propozuar si zonë pilot Natura 2000 (Zonë e Mbrojtur e Vecantë (SPA), Zona me Interes per Komunitetin (SCI), Zonë të Vecanta për Ruajtje (SAC)) ose Zonë me interes të vecantë mbrojtje nga Komuniteti Europian

Zona e Projektit dhe Zona e Pejzazhit te Mbrojtur

Zona ku mendohet të shtrihet projekti korrespondon me Nënzonën Qëndrore të Zonës së Pejzazhit të Mbrojtur.

Figura x. Harta e zonës së mbrojtur Lumi Buna - Velipojë

Harta e zonimit të Peizazhit të Mbrojtur të Lumit Buna-Velipojë

Në përputhje me pikën 3a te nenit 13 te Ligjit 81/2017 "Per zonat e mbrojtura" në nënzonën qëndrore (që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe siguron një zonë natyrore të pashqetësuar) përdoret shkalla e parë e mbrojtjes (strikte).

Neni 48 i ligjit shprehet për aktivitetet e ndaluara ne zonën qëndrore

Neni 48. Nënzona qendrore
1. Në nënzonën qendrore të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes. Nënzona ndahet në dy nivele.
2. Në nivelin A janë të ndaluara:
a) prerja e drurëve dhe e shkurreve;
b) përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike;
c) ndërtime të çdo lloji;
ç) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave;
d) ndezja e zjarreve;
dh) kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre;
e) ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive;
ë) kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës;
f) lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve;
g) vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi;
gj) riprodhimi intensiv i llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.
3. Në nivelin B janë të ndaluara:
a) shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;
b) neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të "Parkut kombëtar";
c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;
ç) riprodhimi intensiv, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;
d) ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, hidrocentraleve, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;
dh) larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;
e) mbjellja e pyjeve monokulturë;
ë) ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;
f) lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara;
g) nxjerrja e mineraleve, gurëve, torfave, me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;
gj) veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara;
h) organizimi i garave me automjete e motoçikleta.

Parimet e Menaxhimit të zonave të mbrojtura

Bazuar në nenin 4 të ligjit 81/2017 "për zonat e mbrojtura", menaxhimi, planifikimin dhe ruajtja e zonave të mbrojtura mjedisore në Shqipëri realizohet nëpërmjet zbatimit të katër parimeve thelbësorë, të cilët garantojnë mbrojtj dhe menaxhim të qëndrueshëm të tyre. Këto parime të rëndësishme konsistojnë në: a) Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, b) Parimi i integrimit, c) Parimi ndotësi paguan dhe ç) Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake. Shkurtimisht në paragrafët vijues spjegohet secili prej këtyre parimeve.

a) *Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm*. Nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të kujdesshëm, burimet e tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën, ruhen për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm nëpërmjet zhvillimit që plotëson nevojat e tanishme pa kërcënuar nevojat e brezave të ardhshëm.

b) *Parimi i integrimit*. Integrimi i politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, pasi zhvillimi i mjedisit është i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të vendit.

c) *Parimi "ndotësi paguan".* Subjektet, që me veprimet apo mosveprimet e tyre ndotin dhe/apo dëmtojnë mjedisin brenda e jashtë zonës së mbrojtur, paguajnë për rehabilitimin e tij.

d) *Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake*. Me anë të politikave dhe bazës ligjore përkatëse shteti merr masa paraprake për parandalimin e ardhjes së pasojave negative në mjedis nga aktiviteti njerëzor dhe faktorët natyrorë.

Sa më lartë duket qartë që planifikimi në zonat e mbrojtura duhet të jetë tepër i kujdesshëm, duke marrë parasysh parimet e mësipërme të cilat rrjedhin nga ligji për zonat e mbrojtura dhe duke patur një ndjeshmëri të lartë mbi aspektet mjedisore, të tilla si mbrojtja e diversitetit biologjik, mbrojtja dhe përmirësimi i habitateve, mbrojtja e cilësisë së ujit, ajrit, tokës, etj.

- ***Veprimtaritë e ndaluara në Peizazh të Mbrojtur, Kat. V***

Veprimtaritë, që ndryshojnë përdorimin e territorit si ndërtimet, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane, si dhe veprimtari të ngjashme me këto, lejohen të ushtrohen vetëm nëse subjekti që kërkon të kryejë veprimtarinë është pajisur me leje nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Peizazhi

Vija bregdetare e Baks-Rrjollit karakterizohet nga tipologji peizazhi dominuese rural të ndërsurur me atë natyror. Në zonë dominojnë katër elementë kryesore peizazh formuese, trupat ujorë, elementi ranore dhe e dunave me bimësi karakteristike pionere dhe shpati krastik të malit të Remsit.

Elementi Ujor: Sipërfaqet ujore në territorin e zonës në studim dominohen nga vija bregdetare dhe ligatinat e vogla që deportojnë në thellësi të zonës, që bëjnë një thyerje harmonike mes mes dunave ranore dhe bimëve barishtore dhe shkurretave të ulta. Me këto elementë të ndërthurur zona merr një karakter plotësisht ligatinor, që ofron qetësinë e një habitati të virgjer dhe plot mundësi për zhvillimin e jetës së egër.

Figura 3. Foto nga ligatina, ZRK Baks-Rrjoll

Elementi i rërës dhe dunave ranore bregdetare: Rëra e plazhit dhe dunat ranore janë një pjesë shumë e rëndësishme e formimit të peizazhit në zonën e plazhit të Baks-Rrjollit. Plazhi i gjerë me rërë të bollshme krijon nje fashë gjatësore, e cila ndërthuret me kreshtat e dunave, të cilat vijnë paralel në të gjithë zonën. Dunat ranore kanë krijuar një atmosferë harmonike në të gjithë zonën, në sajë të veprimtarisë itensive të erës, rëra ka arritur të ngjitet disa metra në shpatin e malit të Rencit, duke formuar një brez rërë në pjesën fundore të shpatit. Gjithashtu dunat kanë krijuar një habitat të rëndësishëm për speciet floristike dhe faunistike të zonës, duke krijuar mjedis të përshtatshëm në sajë të mbrojtjes nga erërat bregdetare dhe duke luajtur rolin e barrjerës ndaj ujit që krijohen ligatinat e vogla në të gjithë gjatësinë e zonës.

Figura 4. Foto nga rëra dhe dunat, ZRK Baks-Rrjoll

Elementi peizazhistik Shpati karstik i Malit të Rencit: Shpati jugor i malit të rencit është elementi më i fortë peizazhistik në zonë, duke arritur lartësinë nga 0mnd deri në 400mnd në një pjerrësi të konsiderueshme. Ky shpat është tipik i peizazhit krastik, ku dallohen qartë format e crregullta, carjet tërthorazi të përrenjëve, dhe celtinat që ofron zakonisht ky lloj peizazhi. Ky element e bën shumë më të larmishëm zonën, duke i dhënë, krahas karakter bregdetar e fushor, edhe karakter paksa malor. Duhet theksuar që mali i Rencit është habitat shumë i rëndësishëm për shpendët grabitqar.

Figura 5 Foto nga shpati i malit të Rencit, ZRK Baks-Rrjoll

Elementi Rural: Zona rurale shtrihet në pjesën jugore të Vilunit, midis shpatit të malit të rencit dhe vijës bregdetare. Kjo tipologji peizazh formuese dominohet nga ndërtime të ulta (shtëmi 1-3 kate) dhe parcelat e kultivuara, jo shumë në sipërfaqe, por në dukje të theksuar, me kardhe rrethues dhe toka të kultivuara. Sistemi rrugor nuk është shumë I zhvilluar, por shfaqet pothuajse në të gjithë zonën e banuar, duke krijuar një rrjet lidhës ndërmjet parcelave, shtëpive dhe vijës bregdetare.

Infrastruktura mjedisore

Menaxhimi i mbetjeve

Situata e menaxhimit të mbetjeve urbane në zonën e projektit nuk paraqitet e mirë. Pothuajse në të gjithë vijën bregdetare shikohet prania e mbetjeve të ngurta urbane të shpërndara. Ndërsa në zonën e fshatit, situata paraqitet relativisht më e mirë, me problematika në menaxhimin e mbetjeve organike (plehrave organikë).

Aktualisht, zona në fjalë, fshati Baks-Rrjoll, gjeneron sasi të vogla të mbetjeve të ngurta urbane, të cilat menaxhohen si pjesë e Njësisë Administrative (NjA) Velipojë, pjesë e Bashkisë së Shkodrës. Problematikë mbetet periudha e sezonit turistik, ku popullësia në zonën dhe rrethina pesë-fishohet. Në po të njëjtin shkallë shumëfishohet edhe sasia e mbetjeve, duke arritur në 20 ton/ditë (Për gjithë NjA-në Velipojë)[20].

Shërbimi i grumbullimit kryhet me kontenier metalik 1.1m^3 ndërsa transporti i mbetjeve ofrohet në të gjitha fshatrat e NjA-së Velipojë përfshrë fshatin Baks-Rrjoll, tre (3) herë në javë gjatë stinës së dimrit, me anë të një mjeti me kapacitt 7 ton. Gjatë stinës së verës shërbimi kryhet dy (2) herë në ditë me dy (2) mjete nga 5 ton secili, të cilat vijnë nga Bashkia Shkodër[21].

Në të ardhmen, pas zhvillimit të projekteve të propozuara në PDZRK, në zonën e Baks rrjollit pritet të ketë një fluks truristësh prej 6,000 turistë/ditë, të cilët arrijnë një normë gjenerimi mbetjesh rreth 1.18 kg/ditë/person[22], ose thënë ndryshe gjenerimi i mbetjeve do të arrijë vlerën maksimale rreth 7 ton/ditë ose 2,550 ton/vit. Duke qënë zonë turistike, kjo sasi mbetjesh duhet menaxhuar me kujdes të veçantë, duke perdorur skema të integruara të menaxhimit të tyre dhe implementimin e parimeve të 3R[23].

Mbetjet e ngurta, të prodhura në zonën e projektit, do të menaxhohen në përputhje me hierarkinë e mbetjeve të përcaktuar në *Direktivën e BE-së 2008/98/EC* dhe *draft-Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, në vitin 2018*. Në këto dokumente përcaktohen qartë parimet dhe hierarkia e menaxhimit të mbetjeve urbane, që i jep rëndësi parandalimit të mbetjeve, ripërdorimit të tyre, riciklimit, djegies me qëllim përfitim energjie dhe depozitimit në landfill. Përdorimi i depozitimit në landfill është gjithësesi opsioni i fundit dhe vetëm kur janë ezauruar katër shkallët e para të hirearkisë së menaxhimit të integruar të mbetjeve. Theksojmë që synimi mbetet që mbetjet e destinuara për depozitim final në landfill duhet të shkojnë drejt "0" zeros.

[20] 30,000 banorë me normë gjenerimi mbetjesh 0.74kg/ditë, Sipas: Bashkia Shkodër, PLMIMNU, 2017
[21] Bashkia Shkodër, PLMIMNU, 2017
[22] Banka Botërore, Norma e gjenerimit të mbetjeve për Europën dhe Azinë Qëndrore, 2018
[23] Reduktim, Ripërdorim dhe Riciklim

Autoriteti kryesor për menaxhimin e mbetjeve në zonën e projektit do të vazhdojë të jetë Bashkia e Shkodrës, e cila do të bëjë të mundur largimin e mbetjeve për në zonën e përcaktuar prej saj. Ndërsa në plotësimin e infrastrukturës së grumbullimit të mbetjeve në zonë do të jetë përgjegjës investitori i caktuar nga bashkia.

Është shumë e rëndësishme që në këtë zonë të ndërtohet një skemë tepër efikase, e cila garanton menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane dhe integrohet gjithashtu mirë në aspektet e dizajnit dhe akitekturës së pëjzazhit.

Në zonën e projektit do të realizohet mbledhja e mbeturinave ne sistem te diferencuar me 4 kosha. Në secilin prej koshave, të paisur me ngjyrë dhe pershkrimet përkatëse do të grumbullohen: 1) Qelq, plastikë dhe metal, 2) Letër, karton dhe dru, 3) Orgganike dhe 4) mbetje të tjera. Në këtë mënyrë, mbetjet janë gati për tu futur në procesin e riciklimit dhe kompostimit.

Figura x. Skema e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane

Për grumbullimin e mbetjeve do të përdoren dy lloje kontenierësh (koshash), në madhësi dhe dizajnë të ndryshëm. Kontenierët do të garantojnë një dizajn të përshtatshëm dhe do të plotësojnë kushtet higjenike të nevojshme. Të dy modelet do të jenë të mbyllur, pasi në sezonin e nxehtë mbetjet mund te krijojnë aroma të pa këndshme dhe të afrojnë insekte që mund të shkaktojnë shqetësim në të turizmit dhe mjedisit.

Kontenierët e mbeturinave në zonën e plazhit dhe në afërsi të pedonaleve do të jenë të kapacitetit relativisht të vogël, rreth 50 - 200 litra, secili prej tyre do te mbulojë një sipërfaqe me rreze 50-100 m. Në zonën e plazhit kontenierët do të jenë të lëvizhshëm, ndërsa përgjat shëtitoreve ato do te jenë të pa lëvizshëm. Disa prej modeleve të rekomanduar paraqiten në figurat ilustruese në vijim, duhet theksuara se këto modele mund të ndryshohen varësisht dizajnit apo mënyrës së vendosjes sipas rastit.

Figura x. Modele të kontenierëve të mbeturinave në zonën e plazhit dhe shëtitore

Burimi: trashcanrevieës.com

Kontenierët e grumbullimit të mbeturinave në zonën e bizneseve dhe resorteve propozohet të jenë nëntokësorë, për të siguruar higjenë dhe kapacitet relativisht të lartë dhe të mbrojtur nga kushtet atmosferike. Gjithashtu këto lloje kontenierësh do të sigurojnë një dizajn të përshtatshëm dhe nuk do të zënë hapësirë, pasi pjesa e sipërme, mbi tokë, është shumë e vogël.

Ky model përbëhet nga pjesa e sipërme, e cila shërben për të hedhur mbeturinat, kontenieri i cili ndodhet nëntokë dhe mekanizmi ngritës, që mund të jetë vetjak për çdo kontenier, ose për të gjithë pikën e grumbullimit bashkë (Për të katër kontenierët).

Figura x. Model kontenieri mbeturinash për zonën e biznesit dhe resortet.

Burimi: correiodominho.pt

Grumbullimi i mbetjeve do të mundësohet nga makineri teknologjike të përshtatshme për vetëngarkimin e kontenierëve. Makina duhet të jetë me kapacitet rreth 7 ton ose të jenë dy automjete me kapacitet 3.5 ton secila. Makina teknologjike duhet të sigurojë mbledhjen e diferencuar të mbetjeve.

Për mbledhjen e kontenierëve do të instalohet një model SMART, i cili do të konsistojë në paisjen e çdo kontenieri me sensor[24] i lidhur me ËiFi që tregon sasinë e mbushjes së tij. Kur kontenieri arrin mbushjen mbi 80% sensori lajmëron qëndrën e grumbullimit, duke përcaktuar edhe lokacionin e kontenierit. Në këtë mënyrë, do të zhvillohet një model i cili ofron efiçensë maksimale në mbledhjen e mbeturinave, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe ul sasinë e ndotësve në atmosferë, kryesisht CO_2. Në skemën vijuese paraqitet në mënyrë të detajuar secila pjesë e këtij sistemi dhe mënyra e mbledhjes së mbetjeve.

Figura x. Skema e modelit SMART të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane

Burimi: ecubelabs.com

Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujrave të përdorur

Furnizimi me ujë

Zona Baks-Rrjoll, furnizohet me ujë nga stacioni i pompave ne fushën e Trushit, nëpërmjet dy depo 2x2000m3 të pozicionuar në qafën e Kolshit. Sipas ndërmarjes rajonale të ujësjellësit, linja kryesore e furnizimit me ujë të fshatit Baks-Rrjoll është e shtrirë nga depoja deri në fund të zonës (ish reparti ushtarak).

Aktualisht fshati merr ujë nga ky ujësjellës, por me probleme te vazhdueshme. Sa më sipër rrjeti aktual nuk mundëson furnizimin normal të popullatës në sasi dhe në cilësi duke shtuar këtu edhe fluksin e turistëve gjatë sezonit të verës. Në zonë ka puse private të banorëve që aplikohen në masë dhe mënyre të pakontrolluar duke shkaktuar presion të vazhdueshem në akuiferin e ujërave nëntokësore dhe nxitur fenomenin e intruzionit të detit (pra futjen e ujit të kripur) si dhe shumë fenomene të dëmshme sa i përket këtyre resurseve. Për të plotësuar nevojat e zonës do të nevojitet sistem i ri që bën lidhjen me depon ekzituese që duhet të ketë rritje të kapacitetit.

[24]https://youtu.be/PpFSrKëTms4

Kanalizimet dhe ujërat e bardha

Në zonë nuk ka kalalizime të ujrave të bardha. Largimi i ujrave të bardha, ose të shiut, bëhet nëpërmjet përdorimit të kanaleve kulluese. Banorët kanë zgjidhur individualisht problemin largimit të ujrave të zeza nëpërmjet ndërtimit të gropave septike individuale të cilat të cilat pastrohen herë pas here, por nuk janë subjekt i një mirëmbajtjeje periodike. Formacioni i tokës ku ato janë ndërtuar në përgjithësi është ranor, gjë e cila ndihmon në filtrimin e lehtë të ujit.

Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur urban me kapacitet 250 litër/ditë/banorë për një popullsi prej 48200 banorëshfunksionon dhe mbulon zonën e Velipojës në përëndim të Zonës në zhvillim. Ky impiant mund të mbulojë dhe nevojat e ardhshme të Baksrrjollit duke plotësuar vetëm rrjetin e kanalizimeve.

Potenciali i ZRK Baks-Rrjoll për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (BRE)

Zona në studim, edhe pse një hapësirë relativisht e vogël, mbart një potencial të lartë për shfrytëzimin e energjive të rinovueshme e sidomos të energjisë së diellit (solare).

Megjithatë përparësi duhet ti jepet shfrytëzimit të energjisë diellore sepse prodhimi i energjisë nga era, nëpërmjet turbinave të erës, nuk është i rekomandueshëm kur investimet prekin korridoret apo zonat e rëndësishme të shtegtimit masiv të shpendëve. Marrë parasysh, se zona e propozuar për zhvillim të PDZRK-ve, ndodhet në zonën bregdetare dhe njëkohësisht në rrugën e shtegtimit të shpendëve që përdorin Adritikun Lindor, prodhimi i rekomdandueshëm energjisë së rinovueshme, sikurse thënë dhe më lartë, mbetet ai i energjisë diellore.

Pozicioni gjeografik dhe kushtet klimatike i japin mundësi për të zhvilluar në përpudhje me parimet mjedisore të prodhimit të energjisë të rinovueshme dhe përdorimin e teknikave për kursimin të energjisë në ndërtesa.

Baks-Rrjolli dhe rrethinat karakterizohet nga klimë tipike mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër relativisht të butë, me vjeshtë e pranverë të paqëndrueshme, si nga pikëpamja e reshjeve ashtu edhe e temperaturave. Temperatura mesatare shumëvjeçare në zonën e Velipojës arrinë rreth 14.8^{o}C, rrezatimi djellor arrin në rreth 1400-1450 kËh/m^2, me rreth 2700 orë/vit/diell. Ndërsa reshjet luhaten ndërmjet 1800 - 1900 m/m/vit dhe era është e vazhdueshme me shpejtësi mesatare vjetore 3.1 - 3.5 m/s.

Karakteristikat klimatike të paraqitura më lart, tregojnë qartë potencialin për shfrytëzimin e energjisë djellore në zonë, si në prodhim të energjisë elektrike, ashtu edhe përdorimin pasiv të kësaj energjie. Gjithashtu, zona mundëson një sasi të konsiderueshme të reshjeve vjetore, e cila mund të mblidhet për të plotësuar nevojat e aktiviteteve të ndryshme në zonë me ujë. Mund të themi që edhe zhvillimi i teknologjive për shfrytëzimin e energjisë së erës është i mundur, por për shkak të synimit të zhvillimit, ky potencial nuk shikohet i arsyeshëm të zhvillohet.

Në këtë pikpamje, vetë PDZRK-ja propozon që ndërhyrjet në zonë të kryhen duke marrë në konsideratë mundësinë e mbledhjes dhe përdorimit të ujrave të shiut, përdorimin e materialeve ndertimore (mure, dyer, dritare, dysheme dhe çati) me performancë të lartë energjitike në ndërtesa dhe integrimin e paneleve diellore në arkitekturën e ndërtesave për të prodhuar energji dhe ngrohje të ujit, apo ambjenteve.

Popullsia dhe kushtet social-ekonomike

Pavarësisht zhvillimit socio-ekonomik të tre dekadave të fundit, Shqipëria përballet me problematika të shumta socio-ekonomike si: migrimi, papunësia, niveli i ulët i të ardhurave, cilësisë e jetës, vështirësi e integrimit në tregun e punës etj. Këto problematika bëhen dhe me domethënës në zonat rurale, ku sektori i bujqësisë nuk arrin të gjenerojë të ardhura dhe punësim të mjaftueshëm për popullsinë lokale.

Në këtë kontekst vendoset dhe Njësia administrative Velipojë, ku nga të dhënat Census 2011, vërehet:

- një rënie prej 28% të popullsisë gjatë periudhës 1989-2011
- një shkallë e lartë papunësie që përafron vlerat e 49% dhe që shënon vlera prej 70.6%. për grupmoshës 18-25vjec.

Nisur nga kjo situatë socio-ekonomike, ndërmarrja e veprimeve në përmirësimin e cilësisë së jetës, tregut të punës, aktivitetit ekonomik të zonës renditen si një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Nëse i referohemi vlerësimeve të UNËTO dhe G20 për turizmit, zhvillimi i industrisë së turizmit përbën një hap konkret drejt zhvillimit socio-ekonomik rajonal, për shkak se gjeneron të ardhura të larta, kontribuon në zgjerimin e tregut të punës, në parandalimin e varfërisë dhe pabarazive etj.

Në këtë kuadër zhvillimit i aktiviteteve turistike shfaqet si një mundësi për zhvillimin socio-ekonomik të zonave në vështirësi dhe me potencial turistik. Për të lehtësuar implementimin e aktiviteteve turistike është e domosdoshme që pushteti qendror dhe lokal të ndërmarrin hapa konkret në formimin dhe kualifikimin e moshave të reja drejtë nevojave të këtij sektori. Paradoksalisht volumi i lartë i forcës së re punëtore të lirë përbën një avantazh territorial për shkak se janë pikërisht moshat e reja ato që shfaqin një fleksibilitet më të lartë drejt tregut të punës dhe specializimit.

Raporti me Hotspotet e Mundshme të Evidentuara

Verifikimi i kryer në të gjitha burimet zyrtare të informacionit mbi vatrat e nxehta mjedisore, përfshirë këtu Raportet e Gjendjes në Mjedis për vitet 2011-2017 apo raportime të tjera të institucioneve të linjës dhe dokumentin e Strategjisë së Mjedisit 2013 - 2020 dhe Draft-Strategjinë e Menaxhimit të integruar të Mbetjeve 2018, tregon se nuk ka "hot-spote" në zonë dhe rrethinat e saj.

Problematikat Mjedisore

Zona e plazhit të Baks-Rrjollit është me karakter rural dhe natyrorë. Krahas problematikave që lidhen me gjuetinë dhe shqetësimin e habitatit, të tjera vijnë si pasojë e efekteve zinxhir, kryesisht të problematikave lidhur me keqmenaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe mos-trajtimin e ujërave të përdorura urbane. Në vijim sqarohen secila prej problematikave të evidentuara në zonë.

Ndotja

Mbetjet e ngurta urbane: Pothuajse i gjithë territori i vendit tonë përballet me sfidën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane. Pothuajse në të gjithë lumenjtë e vendit ushtrohet presion i lartë me depozitimin e mbetjeve të ngurta urbane, ku një pjesë e tyre transportohet drejt pjesës fundore të këtyre lumenjëve deri në det. Rrymat bregdetare bëjnë të mundur shpërndarjen e mbetjeve të ngurta urbane (mbetjet pluskuese) në të gjithë vijën bregdetare në afërsi të grykderdhjeve lumore, në disa raste edhe në sipërfaqe shumë të gjera, duke ndotur sipërfaq të gjera me këto mbeturina, kryesisht plastike dhe tekstile. Në këtë zonë, nuk përjashtohen edhe hedhjet nga turistët, apo vizitorët e zonës, pasi në të gjithë territorin nuk ka vende të përcaktuara për hedhjen e mbeturinave.

Pothuajse i gjithë plazhi i Baks-Rrjollit është nën presionin e mbetjeve të ngurta urbane, të cilat gjenden të shpërndara në 11km gjatësi të vijës bregdetare. Rrymat e mbetjeve që mbizotërojnë në këtë zonë janë ato të plastikës (bidona, qese, plastmas, etj), mbetje tekstil (kryesisht vesh mbathje), metalike (kanace alumini dhe hekuri) dhe shishe qelqi. Këto llojë mbetjesh janë të pranishme në zonë pasi konsiderohen të lehta në peshë dhe mund të plutscojnë lehtësisht në ujë.

Figura 9. Foto e shpërndarjes së MNU, ZRK Baks-Rrjoll

Ujërat e përdorura urbane: Ujërat e përdorura urbane (ujërat e zeza) nga Shkodra dhe Ulqini dhe zonat përreth dëmtojnë më së shumti destinacionet turistike në bregdetin e Velipojës dhe

Baks-Rrjollit[25]. Ujërat e zeza përcaktohen si çdo ujë që është ndikuar negativisht në cilësi nga aktiviteti njerëzor. Ujërat e përdorura urbane përbëhen nga mbetje të lëngshme dhe të ngurta që shkarkohen nga shtëpitë, ambjentet tregtare, industria e lehtë në zonat urbane, dhe ferma ose toka të kultivuara pranë këtyre zonave.

Ujërat e zeza përmbajnë një gamë të gjerë ndotësish në përqendrime të ndryshme, kryesisht ndahen në ndotës me potencial toksik, sic janë metalet e rënda dhe ndotës organik. Ujërat e zeza përmbajnë kimikate të ndryshme në forma të ndryshme si, Kërkesa për oksigjen kimik (COD), Karboni total organik (TOC), Azoti, Fosfor, Klorur (Cl-), Sulfate (SO4-2) dhe metalet e rënda si, Mërkuri (Hg), Arsenik (As), Plumbi (Pb), Zink (Zn), Kadmium (Cd), Bakri (Cu), Nikel (Ni), Kromi (Cr), Argjend (Ag)[26].

Edhe pse zona në fjalë shfaqet me presion të lartë nga pikëpamja e ndotjes së ujërave, AKM-ja për vlerësimin e fundit i cilëson ujërat e bregdetit të cilësisë shumë të mirë, ndërsa nga monitorimi i Lumit Buna ka fare pak rezultate të cilat e klasifikojnë me vlera tepër të ulet të elementëve ndotës. Ndërsa, përmbajtja mesatare e fosforit total në stacionet e monitorimit të Liqenit të Shkodrës është 0.033 mg/l duke i klasifikuar këto ujëra me cilësi mezotrofike, dhe në Zogaj vlera e matur është 0.041 mg/l një vlerë e lartë ku e klasifikon këtë stacion me cilësi eutrofike[27].

Dëmtimi i dunave ranore

Është fenomen i kohëve të fundit i shfaqur në formën e shaktërrimit të qëllimshëm ose jo të kësaj pasurie të rrallë natyrore. Disa prej dunave janë dëmtuar për shkak të hapjes së terreneve për ndërtim apo përdorimit të rërës së dunave ranore për ndërtim.

Ndërkaq, në zonë vërëhet dhe shaktërrimi i paqëllimshëm i dunave nga persona që i përdorin dunat gjatë qarkullimit me mjete motorrike të përdorura per turizëm, sportin e aventurës etj.

Gjatë viteve të fundit tejshfrytëzimi i pyjeve, i bimëve mjekësore, etj., ka sjellë pasoja negative për faunën e egër. Peshkimi i skajshëm dhe me mjete jo të përshtatshme ka çuar në pakësimin e burimeve peshkore. E gjitha kjo ka ndikimin e saj edhe në jetën e komunitetit dhe plotësimin e nevojave të tij të bazuar në shfrytëzimin e burimeve natyrore. Gjendja e biodiversitetit, sidomos në pesë vitet e fundit, paraqitet në përkeqësim. Kjo situatë ka ardhur për shkak të shfrytëzimit pa kriter të burimeve të natyrës, por edhe një numër i madh faktorësh të tjerë kërcënues ndër të cilët veçohen dëmtimi i habitateve si tharje e kënetave, prerja e pjesshme e pemëve, dëmtimi i kallamishteve, peshkimi me dinamit dhe lëndë helmuese. Përndjekja e kafshëve dhe gjuetia pa leje apo me mjete të jashtëligjshme, gjuetia jashtë sezonit si dhe dëmtimi i të vegjëlve apo vezëve të shpendëve janë faktorë kërcënues në këtë drejtim.

[25]Euronatur, Rapid assessment of the Ecological Value of the Bojana-Buna Delta, Albania / Montenegro
[26]KE, "Potentially toxic elements: Sources, pathëays, and fate through urban ëasteëater treatment systems", ëeb: ëëë.ec.europa.eu, 2019.
[27]AKM, Raporti i Gjendjes në Mjedis 2017, Tiranë, 2018

Brakonazhi ose Gjuetia e paligjshme

Brakonazhi është një problem i madh në të gjithë zonën në studim dhe rrethinatpasi degradon habitatet natyrore nëpërmjet ndotjjes nga plumbi (i sacmeve) dhe i varferon ligatinat nga shpendët shtegtarë dhe të përhershëm. Përveç kësaj, vlera e zonës për zhvillimin e turizmit dhe rekreacioni fillon të kufizohet për shkak të largimit të shpendëve dhe rënies së larmisë biologjike.

Momentalisht, nuk ka te dhena te sakta mbi keto veprimtari, por nga vizitat në terren, bisedimi me banorët e zonës dhe specialistët e fushës, tregon që ky fenomen është present në zonë, kryesisht në ato më pak të aksesueshme nga infrastruktura rrugore.

Figura x. Harta e problematikave mjedisore në zonë

Përfundime dhe sygjerime për zhvillimin e mëtejshëm të zonës

Zona e PDZRK-së Baks-Rrjoll ndodhet në skajin jug-perëndimor të zonës së mbrojtur Lumi Buna - Velipojë, peizazh i mbrojtur, kategoria V. Konkretisht zona shtrihet nga pjesa jugore e lagunës së Vilunit, duke mbuluar një sipërfaqe rreth 150ha.

Zona në fjalë përbëhet nga një sërë elementësh të rëndësishëm nga pikpamja mjedisore. Në këtë territor takohen disa ligatina të vogla e të cekëta, duna ranore të madhësive dhe moshave të ndryshme dhe zona të mbuluara me shkurre, kallamishta dhe zhuka, mbetje të pyjeve pranë ujit me Frashër (*Fraxinus excelsior*) duke e bërë një ekosistem të rëndëshishëm për gjithë botën shtazore dhe bimore.

Vetë fshati Baks-Rrjoll shtrihet në Nënzonën Qëndrore të Zonës së Pejzazhit të Mbrojtur Lumi Buna-Velipojë. Sipas Pikës 3a. “Ndarja në nënzona i territorit të zonës së mbrojtur kombëtare” të të Ligjit 91/2017, "Për Zonat e mbrojtura" “a) Në nënzonën qendrore (që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe siguron një zonë natyrore të pashqetësuar) përdoret shkalla e parë e mbrojtjes (strikte).”. Në funksion të Nenit 48 “Nënzona qendrore” duket se shumica e veprimtarive njerëzore në këtë nënzonë janë të ndaluara. Sipas pikës 2c të Nenit 48 “2. Në nivelin A janë të ndaluara: c) ndërtime të çdo lloji;”,

Ndërkaq realiteti është i krejt i ndryshëm nga përcaktimet ligjore. Fshati ka sigurisht ndërtime dhe është zgjeruar edhe më në jug të tij, deri në kufirin me grupimin e Frashërit (*Fraxinus excelsior*) dhe ligatinat e përkohshme bregdetare. Një realitet i tillë e përkon më tepër me përcaktimet e Nënzonës së Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm ku zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes dhe ku janë të ndaluara:

a) ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;

b) depozitimi i kimikateve;

c) lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;

d) mbledhja intensive e bimëve, mineraleve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve;

e) vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;

f) ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave e shtigjeve të caktuara.

Në vijim të këtij arsyetimi sygjerojmë që cfarëdo ndërhyrje e planifikuar në këtë zonë në kuaër të PDZRK-së përkatëse, të jetë tepër e kujdesshme dhe e mirë menduar në mënyrë që impakti të jetë sa më i ulët, si në aspektin peizazhistik ashtu humbjen dhe degradimin e habitatit. Konkretisht kërkojmë që të merren në shqyrtim sygjerimet e mëposhtme:

1. Zona me ndërtime e fshatit Baks-Rrjoll të kalojë në Nënzonën e Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm deri në kufirin e përcakuar nga bashkimi i drejtpërdrejtë i pikave në terren sipas renditjes me poshtë:

   a. Lat. 41.850762°, Long. 19.489536°

   b. Lat. 41.856947°, Long. 19.493614°

2. Pjesa në jug të kësaj linje deri në kufirin jugor të Zonës së Pejzazhit të Mbrojtur Lumi Buna – Velipojë, duhet të vazhdojë të ruhet si zonë natyrore brenda Nënzonës Qendore për shkak të vlerave të jashtëzakonshme të pejzazhit, larmisë së habitateve dhe numrit të lartë të specieve bimore e shtazore me vlerë për mbrojtjen e natyrës. Sipas Nenit 48 të ligjit 91/2017, "Për Zonat e mbrojtura" në këtë nënzonë nuk duhet të unshtrohet presion me ndërtime apo ndërhyrje të tjera infrastrukturore (*Shih ilustrimin vijues).*

Figura x. Lidhja dhe konservimi i natyrës

3. Gjatë planifikimit duhet të merret në konsideratë ndjeshmëria e lartë që ka ekosistemi i lagunës së Vilunit ndaj shqetësimeve të mundëshme. Në këtë kontekst këshillohet të ruhet një brez buferik me bimë vendase, duke krijuar dizajne të këndshme, jo më pak se 200 m përgjatë gjithë perimetrit të lagunës. Kufiri i lagunës përcaktohen në nivelin maksimal të saj në periudhën e dimrit (*Shih ilustrimin më sipër*)

4. Gjatë planifikimit sygjerojmë të merret në konsideratë ruajtja dhe përforcimi i korridoreve ekologjik lidhës midis Lagunës së Vilunit, ligatinave të vogla në pjesën jugore të zonës dhe habitateve pyjorë në shpatet e Malit të Rrencit. Kjo lidhje do të shërbente për

mosndërprerjen e rrugëve të shtegtimit të gjallesave tokësore si dhe për të siguruar shpërhapjen e së specieve faunistike. Koridori do tu shërbejë kryesisht shpendëve të vegjël dhe specieve faunistike tokësore. Koridoret ekologjik, përdoren gjerësisht në funksion të atraksioneve turistike si zona ku mund të zhvillohen aktivitete alternative si hiking, trekking, birdëatching, biking etj (*Shih ilustrimin më sipër*).

5. Me ruajtje kuptojmë paprekshmërinë e ligatinave të përkohshme në fashën litorale, paprekshmërinë e vegjetacionit të lartë me Frashër (*Fraxinus excelsior*), si dhe paprëkshmërinë e dunave ranore pranë shpatit të Malit të Rencit

6. Me përforcim kuptojmë inkurajimin korridoreve ligatinorë me Typha latifolia, Scirpus sp, dhe *Phragmites communis* si dhe shtimin e bimësisë së lartë autktone e sidomos të Frashërit (*Fraxinus excelsior*)

Në zonën ku shtrihet PDZRK-ja Baks-Rjoll duhet treguaj një kujdes i vecantë për ruajtjen e tokave të lagura dhe ligatinave, dunave ranore dhe të garantohen zona të qeta për shpendët dhe kafshët. Zonat e rëndësishme nga pikpamja mjedisore në këtë sipërfaqe mund të shërbejnë si atraksion turistik natyror në afërsi të zonës së planifikuar për turizëm elitar.

Duhet theksuar që zona në fjalë mbart karakteristika të vyera peizazhistike, habitat të përshtatshëm për zhvillimin normal të jetës së egër, kryesisht për shpendët, shumëllojshmëri speciesh dhe është një zonë e rëndësishme për shpendët shtegtarë të Adriatikut Lindor.

Kërkesat mjedisore për efiçencë energjie

Efiçenca e energjisë së një ndërtese është shkalla në të cilën konsumi i energjisë për m^2 të sipërfaqes së dyshemesë së qëndron nën vlerat e përcaktuara të konsumit të energjisë për atë lloj të veçantë ndërtese në kushte të përcaktuara klimatike. Në zonën në studim, duke referuar edhe zonës klimatike në të cilën shtrihet, duht të arrihet një koefiçent i konsumit të energjisë në rreth <100 kËh/m^2 në vit.

Për të arritur rezultatin e kërkuar, për zhvillimin e zonës, do të aplikohen të gjitha materialet, teknologjitë dhe zbatohen praktikat e mundshme për kursimin e energjisë dhe uljen e shkarkimeve të karbonit në atmosferë. Konkretisht në ndërtesat akomoduese dhe të shërbimeve, të cilat parashikohen të ndërtohen në zonën në studim, do të aplikohen këto parime dhe teknologji të mundëshme:

Orientimi i ndërtesave: Fasadat kryesore të ndërtesave, kryesisht me sipërfaqe më të madhe xhami, do të orientohen në pozicionin jugor. Ky pozicion mundëson përthithjen e rrezatimin

djellor gjatë stinës së ftohtë, ndërsa gjatë verës, kur dielli rreh pingul tokën, rrezatimi në fasadat prej xhami do të jetë i reduktuar. Ky element do të shërbejë së tëpërmi për ngrohjen e ambjenteve gjatë periudhës së dimrit, duke kursyer energjinë e destinuar për këtë qëllim.

Në fasada e xhamit gjithashtu do të integrohen mbrojtëse të rrezeve të djellit, të cilat do të pengojnë futjen e tyre në godinë gjatë periudhës së nxehtë. Gjelbërim me bimë gjetherëna do të jetë prezent në të gjithë zonën, dhe do të përdoret me zjuarsi për të krijuar hijëzim gjatë periudhës së nxehtë.

Ventilimi natyral: Në të gjitha ndërtesat e propozuara do të integrohen parimet e ventilimit natyral. Në to do të projektohen çarje horizonatale dhe vertikale, me qëllim ventilimin e tyre. Ndërtesat do të parashikohen me dritare që mund të hapen, ndërsa hollet kryesore do të orientohen drejt ventilimit vertikal, ku do te lejohet një hapsirë për futjen e ajrit në pjesën e poshtme dhe një tjetër për daljen e ajrit në taracë.

Termo-izolimi: Ndërtesat e propozuar për qëllime akomodimi dhe shërbimesh në zonë do të zhvillohen në përputhje me kërkesat dhe parimet ndërkombëtar të kursimit të energjisë. Vëmëndje e vecantë do të tregohet në përzgjedhjen e materialeve të ndërtimit me koeficent sa më të ulët të transmetimit të nxehtësisë për muret, dyshemetë dhe mulesën. Gjithashtu, dyert dhe dritaret do të zbatojnë standartet e kërkuara, duke përdorur teknikën me dy (ose tre) shtresa xhami të mbushur me gaz në mes, si dhe kasë plastike me material termoizolues në brendësi (qeramikë). Urat termike, kryesisht në anët e dritareve dhe të dyerve do të realizohen ne tekniken e mbyllur, p.sh. një pjesë e kasës së dritares do të jetë e futur disa centimetra në murë. Konkretisht do të zbatohen këto masa:

Emërtimi	Shtresat	Ilustrimi
Muri	Fasadë e fentiluar, grafiato+llaç, tullë, polisterol, tullë, llaç	Proces
Çatia / taraca	Llaç, beton, material termo-izolues, membranë, drenazhues, dhe me pleh, vegjetacion	Proces
Dritare + Dyer	Kasë plastike me material termoizolues (qeramikë), dy shtresa xhami, kasa e dritares e futyr në mur	Proces

Sistemet e ngrohjes dhe ftohjes qëndrore: Të gjitha godinat e propozuar në zonë do të funksionojnë me sistëm qëndrorë të ngrohjes dhe ftohjes. Ky sistem do të paiset me sensorë të zgjuar për të ruajtur temperaturen e kërkuar në efiçencë maksioale të përdorimit të energjisë.

Kërkesat mjedisore për prodhim energjie diellore

Ndryshimi i fundit i ligjit për energjinë (ligji nr. 43/2015) në Shqipëri hap rrugën e diversifikimit të prodhimit të energjisë dhe inkurajon prodhimin nga burime të rinovueshme. Në këtë asperk, zona e propozuar për zhvillim, do të kontribuojë në këtë drejtim, duke prodhuar energji nga panelet diellore të instaluara kryesisht në taracat e godinave dhe jo vetëm.

Për maksimizimin e prodhimit të energjisë dhe solare, do të përdoren 3 (tre) mënyrë kryesore, panele diellor për ngrohjen e ujit, panele diellore në taraca për prodhim energjie dhe panele për ndricimi apo procese të veçuara. Në vijim trajtohen në mënyrë të veçuar secili prej tekonologjive të përdorimit të energjisë diellore në zonë.

Panele diellor për ngrohje uji: Në thelb ka tre lloje kolektorësh djellor për ujin e ngrohjes: pllaka e rrafshët, tubi i vakumit dhe kolektor përqëndrues. Të tre llojet ngrohin ujin ose një lëng transferimi të nxehtësisë siç është një antifriz jo - oksidik nga kolektori tek rezervuaret e depozitimit te ujit. Kolektorët e bëjnë këtë në mënyrë pasive ose në mënyrë aktive.

Përdorin sisteme pasive diellore të ngrohjes së ujit, përbëhen kryesisht nga konvekcion natyral, duke krijuar presion për të depozituar ujin në një depozitë. Këta lloje nuk kanë përbërësit elektrikë, janë më të lehtë për tu mirëmbajtur dhe ndoshta më të jetë-gjatë se sistemet aktive.

Një sistem aktiv përdor një pompë elektrike për të qarkulloni ujin ose antifrizin jo-toksik përmes sistemit. Sistemet aktive janë zakonisht më të shtrenjtë se sistemet pasive, por ato janë gjithashtu më të efektshme. Sistemet aktive gjithashtu mund të jenë më të lehta për tu rikualifikuar sesa sistemet pasive sepse ruajtja e rezervuarëve të tyre nuk ka nevojë të instalohen sipër ose afër kolektoreve të rrezeve të djellit.

Në zonën në studim, duke qënë se është destinuar për zhvillimin e turizmit elitar, elementi i dizajnit është tepër i rëndësishëm, ndaj propozohet të përdoret sistemi aktiv i ngrohjes së ujit, pasi bolierët/depozitat mund të fshihen duke ruajtur dizajnin arkitektonik të godinave. Ky sistem, edhe pse me kosto pak më të lartë, mendohet të jetët efektiv dhe të plotësojë nevojën për ujë të ngrohtë deri në masën 60-70%, duke kursyer një sasi të konsiderueshme energjie.

Panele për prodhim energjie elektrike: Energjia diellore ose teknologjia fotovoltaike (PV) konverton rrezet e diellit drejtpërdrejt në energji elektrike. Edhe pse shumë lloje të sistemeve elektrike diellore janë në dispozicion sot, të gjitha ato përbëhen në thelb nga tre instrumenta kryesore: module që shndërroj rrezet e diellit në energji elektrike; Inverters që e shndërrojnë atë në energji elektrike që mund të përdoret nga shumica pajisje shtëpiake; dhe ndonjëherë bateritë që ruajnë energjinë e tepërt të prodhuar nga sistemi. Pjesa tjetër e sistemit përfshin pajisje të tilla si instalime elektrike, ndërprerës dhe strukturat mbështetëse.

Në zonën në studim propozoht të instalohen panele diellore në taracat e ndërtesave dhe në fasadat e tyre. Duke parë zhvillimet teknologjike të paneleve fotovoltaike, është e përshtatshme që këto panele të integrohen si pjesë e dizajnit arkitektonik të ndërtesës. Ndaj, zhvillimet në zonë do ta shfrytëzojnë më së miri këtë risi.

Konkretisht në zonën në studim është menduar të instalohen panele fotovoltaike në masën 40 - 70% të sipërfaqës së taracave. Si dhe të gjenden hapsira gjatë projektimit arkitektonik për përfshirjen e paneleve në fasadat e ndërtesave, kryesisht në orjentimin jugor të tyre. Për maksimizimin e prodhimit të energjisë nga këto panele, rekomandohet të vendosen në kundrejtim jugor, në kënd rreth 180º.

Prodhimi i energjisë nga energjia solarë në zonë, kërkon të arrijë një plotësim rreth >50% të nevojave për energji elektrike të gjithë zonës. Ky është një qëllim ambicioz, i cili falë teknologjisë dhe projektimit të duhur është i prekshëm, duke bërë një shembull pozitiv të prodhimit të energjisë së rinovueshme në vendin tonë.

Skema e propozuar për prodhimin e energjisë në zonë do të jetë pa akumulator, pra do të hidhet direkt në rrjetin e energjisë elektrike. Kjo mënyrë redukton ndjeshëm kostot e investimit fillestar dhe minimizon kostot operative. Ky lloj sistemi, momentalisht është i pranuar nga legjislacioni shqiptar, por duhet dakortësimi paraprak me operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike në vend për të vendosur matës me dy krahë, që ben matjet hyrëse dhe dalës. Ky sistëm është tepër efikas, pasi tepricat hidhen direkt në rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike, ndërsa kur nevojitet energji shtesë e rimerr atë.

Panele për prodhime energjie për përdorim specifik: Në zonën në studim parashikohet, krahas instalimit të paneleve për prodhim energjie elektrike në taraca dhe fasadat e ndërtesave, të instalohen paisje të cilat kanë të integruar panele fotovoltaike. Ky sistem do të përdoret kryesisht në ndricimin e jashtëm, ku gjatë ditës do të furnizohet akumulatorët dhe gjatë natës do të mundësojnë ndricimin e rrugëve dhe zonave të parashikuara. Ky sistem është gjerësisht i përdorshëm, tepër efikas dhe me cilësi të lartë. Për sigurinë e funksionimit të këtij sistemi, shikohet e arsyeshme që të integrohet edhe lidhja me sistemin e energjisë elektrike, ku ndëpërmjet sensorëve të zgjuar, në mungesë të energjisë diellore, të përdoret energji nga rrjeti.

Kërkesat mjedisore për efiçencë të perdorimit te ujërave

Mbledhja e ujërave të shiut është një furnizim alternative me ujë i cili mbledh dhe ruan ujërat e shiut për përdorim të mëvonshëm/kontrolluar. Uji i shiut i mbledhur përdoret kryesisht për përdorim sanitar, ujitje lulishtesh/pemësh, krijimi i peizazhit dhe qëllime të tjera jo të pijshme. Edhe pse uji i shiut është relativisht i pastër dhe cilësia është zakonisht e pranueshme për shumë qëllime, filtrimi dhe dezinfektimi është i nevojshëm të realizohet përpara përdorimit.

Në këtë kontekst në zonën e projektit propozohet të ndërhyhet në integrimin e teknologjive të mbledhjes dhe stokimit të ujërave të shiut. Instalimi i sistemit të grumbullimit të ujërave të shiut do të zhvillohet i ndarë në blloqe ndërtesash, ku secila "nën-njësi" do të mund të përdorë ujin e grumbulluar sipas nevojave.

Sistemi i grumbullimit të ujërave të shiut propozohet të realizohet vetëm për ujërat e çative/taracave të ndërtesave, ku do të dërgohet me vetë rrjedhje në depozitën e cila duhet të ndërtohet nën sipërfaqen e tokës. Kapaciteti mbajtës i këtij sistemi varjojnë nga më të vogla deri në disa qindra m^3. Përcaktimin e madhësisë së sistemit të grumbullimit të ujërave të shiut mbetet detyrë e projektuesit në fazën e zbatimit të PDZRK-së. Instalimi i sistemit të mbledhjes së ujërave të shiut do të synojë ulje rreth 20 - 40% të të nevojës së përgjithshmë për ujë.

Një sistem i mbledhjes së ujërave të shiut përbëhet nga tre elemente themelore: zona grumbullimit, sistemi transportimit te ujit (tubot), depozitë stokimi nëntokësore, pompë dhe sistemi i shpërndarjes. Zona e grumbullimit në shumicën e rasteve është çatia/taraca e një ndërtese. Duhet pasur parasysh që, zona efektive e çatisë dhe materiali i përdorur në ndërtimin e çatisë ndikojnë në efikasitetin e grumbullimit dhe cilësinë e ujit.

Figura x. Sistemi i mbledhjes dhe përdorimit të ujit të shiut Në proces finalizimi

Krahas përfitimit mbi sigurimin e ujit dhe ruajtjen e burimeve ujore, zbatimi i teknikave të mbledhjes së ujërave të shiut siguron përfitime të drejtpërdrejta duke zvogëluar kërkesën për furnizimin me ujë, uljen e rriskut të përmbytjve dhe erozionit dhe uljen e ndotjes së ujërave sipërfaqësor.

Mbrojtja e Peizazhit

Vija bregdetare e Baks-Rrjollit karakterizohet nga tipologji peizazhi dominuese natyrore, pothuajse e pa prekur nga zhvillimet humane. Në zonë dominojnë tre elementë kryesore peizazh formuese, trupat ujorë, elementi ranor dhe i dunave me bimësi karakteristike pionere dhe shpati gëlqeror i Malit të Rrencit.

- ***Elementi Ujor:*** Sipërfaqet ujore në territorin e zonës në studim dominohen nga vija bregdetare dhe ligatinat e vogla që depërtojnë në thellësi të zonës duke sjellë një thyerje harmonike mes dunave ranore dhe bimëve barishtore dhe shkurretave të ulta. Me këto

elementë të ndërthurur zona merr një karakter plotësisht ligatinor, që ofron qetësinë e një habitati të virgjër dhe plot mundësi për zhvillimin e jetës së egër.

- ***Elementi i rërës dhe dunave ranore bregdetare:*** Rëra e plazhit dhe dunat ranore janë një pjesë shumë e rëndësishme e formimit të peizazhit në zonën e plazhit të Baks-Rrjollit. Plazhi i gjerë me rërë të bollshme krijon nje fashë gjatësore, e cila ndërthuret me kreshtat e dunave, të cilat vijnë paralel në të gjithë zonën. Dunat ranore kanë krijuar një atmosferë harmonike në të gjithë zonën dhe në vende të caktuara, në sajë të veprimtarisë itensive të erës, rëra ka arritur të ngjitet disa metra në shpatin e malit të Rrencit, duke formuar duna të larta dhe një brez ranor në pjesën fundore të shpatit. Gjithashtu dunat kanë krijuar një habitat të rëndësishëm për speciet floristike dhe faunistike të zonës, duke krijuar mjedis të përshtatshëm e të mbrojtur nga erërat bregdetare si dhe duke luajtur rolin e barrjerës ujore që shërben për të krijuar ligatina të vogla në të gjithë gjatësinë e zonës.

- ***Elementi peizazhistik - Shpati karstik i Malit të Rrencit:*** Shpati jugor i Malit të Rrencit është elementi më i fortë peizazhistik në zonë, duke arritur në një pjerrësi të konsiderueshme lartësinë nga zero deri në 400metra mbi nivelin e detit. Ky shpat është tipik i peizazhit krastik, ku dallohen qartë format e çrregullta, çarjet tërthorazi të përrenjve, dhe çeltinat që ofron zakonisht ky lloj peizazhi. Ky element e bën shumë më të larmishëm zonën, duke i dhënë, krahas karakter bregdetar e fushordhe paksa malor. Duhet theksuar që mali i Rrencit, sikurse shpjeguar dhe në materialet mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor është habitat shumë i rëndësishëm për shpendët grabitqarë.

Figura x. Pamje të peizazhit nga zona Baks-Rrjoll

Hartimi i PDZRK-së ka synuar planifikimin e zhvillimit të zonës në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen e mjedisit dhe të peizazhit në zonë. Për të siguruar mbrojtjen maksimale është e rëndësishme që:

- ***Mbrojtja e aspekteve të peizazhit*** të zonës nëpërmjet planifikimit në harmoni me natyrën dhe elementët peizazhistikë. Konkretisht do ti kushtohet vëmendje e vecantë:
  - Ruajtjes në gjendjen e tanishme të zonave natyrore të mbuluara me bimësi autoktone, të cilat formojnë breza të gjelbër dhe pyje të vecuar në zonë;
  - Ruajtjes së karakeristikave natyrore dhe të paprekura të lagunës së Vilunit dhe ligatinave të vogla që gjenden në brendësi të zonës në studim;
  - Marrjes në konsideratë të aspektit vizual në rastet e ndërtimit në lartësi, në mënyrë që aspektet peizazhistike të zonës të mund të dallohen lehtësisht pa pasur barrierë vizuale. Në rastet më të përgjithshme, ndërtesat të mbahen në lartësi të ulët;
  - Parandalimit të futjes së bimëve invazive (agresive) jo autoktone në zone dhe në rast nevoje për mbjellje të reja të përdoren bimë autoktone me karakteristika mjedisore dhe pejzazhore të njohura.
  - Përdorimit të brezave të gjelbër, apo mureve të gjelbër për të fshehur ndërtesa apo objekte të cilët nuk janë të këndshëm për tu parë, sikurse kabinat elektrike etj.
- ***Përmirësimi i aspekteve të peizazhit*** të zonës të sigurohet nëpërmjet planifikimit dhe inplementimit të masave restauruese të tyre. Konkretisht do ti kushtohet vëmendje e vecantë që:
  - Mbjedhja e fidaneve të reja në zonat e zhveshura të kryhet kryesisht me lloje autoktone si frashër (*Fraxinus excelsior*), carac, (*Celtis australis L.*), bulger (*Querqus trojana*), dëllinjë (*Juniperus oxycedrus macrocarpa*) etj.
  - Krijimi i koridoreve me bimë dhe pemë autoktone, llojet e sipërpërmendura, që lidhin të gjitha ligatinat e zonës, duke krijuar një habitat të pandërprerë për speciet e egra, kryesisht për shpendët e vegjël (trupvogël) shtegtarë;
  - Trajtimi në aspekt dizajni i fasadave dhe mureve rrethues të godinave ekzistuese, duke krijuar një uniformitet të harmonizuar me aspektin natyror;
  - Gjelbërimi përgjatë infrastrukturës rrugore me pemë dekorative, kryesisht të llojeve autoktone dhe me karakteristika që njihen mirë.
- ***Planifikimi i hapsirave të gjelbra dhe lulishteve*** në përputhje me aspektet natyrore të zonës. Konkretisht do ti kushtohet vëmendje e vecantë që:
  - Zonat e gjelbra të dizenjohen sa më afër natyres, në mënyrë sa më organike, me teknikën *Zen Garden*, që të përshtaten me zonën përreth.
  - Bimët të mbillen në grupe, duke marrë parasysh që të krijojnë të gjithë katet e pyllit, duke filluar nga bimët e ulta, shkurret e pemët e larta.
  - Pjesë e zonave të gjelbëra të jenë të pranishme edhe sipërfaqet ujore, në formë pellgjesh, perrenjsh apo lloje të tjera sipas rastit.

Hapësirat e gjelbra dhe llojet e gjelbërimit

Hapsirat e gjelbra në zonat urbane, sidomos në zonat turistike, janë një elemet jashtëzakonisht i fortë në aspektin peizazhistik dhe të komoditetit. Zona ku shtrihet plani është pothuajse natyrore, me një vegjetacion të zhvilluar dhe me larmi biologjike të konsiderueshme. Kjo karakteristikë e zonës do të ruhet, pasi është elementi më i fortë në territor, i cili i jep edhe karakterin dhe potencialin turistik kësaj hapësire.

Konkretisht në zonën e projektit do të konservohet pjesa më e madhe, për të shërbyer më pas si hapsirë publike natyrore. Zonat e konservuara do të trajtohen duke densifikuar gjelbërimin në to, kryesisht me bimësi autoktone, duke përdorur një teknikë mbjelljeje sa më afër natyrores. Bimësia dhe drurët që do të mbillen në zonë do të jenë në formën e kateve të pyllit, duke filluar nga ana e detit me bimësi barishtore dhe shkurre e duke vijuar deri në pëmët e lartësive të mëdha. Në këtë mënyrë, hapsirat e gjelbra në zonë krijojnë jo vetëm një peizash atraktiv në formën e një amfiteatri të pëlqyeshëm për njerzit por edhe një habitat të mirëfilltë për gjallesat shtazore.

Për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në zonë do të përdoren bimë autoktone, të cilat janë përshtatur me kushtet e tokës dhe klimës dhe janë rezistentë ndaj sëmundjeve. Disa prej bimëve do të jenë: frashër (*Fraxinus excelsior*), plepi i zi (*Populus nigra*), caraca, (*Celtis australis L.*), bulger (*Querqus trojana*), dëllinjë (*Juniperus oxycedrus macrocarpa*) etj. Duhet theksuar që në zonë mund të përdoren edhe bimë të tjera të cilat nuk janë autoktone, por kjo do të bëhet pasi të jenë njohur mirë karakteristikat e tyre dhe të vlerësohen paraprakisht si të përshtatshme.

Gjatë përzgjedhjes së llojeve të bimëve për mbjedhje do të studiohen dhe mbillen ato lloje të cilat nuk shkaktojnë alergji dhe nuk konsiderohen si lloje invazive. Për mbjelljet do të zbatohet me përpikmëri të gjitha rregullat teknike për mbjedhje si dhe për periudhën e përcaktuar për cdo lloj bime apo druri.

Figura x. Mënyra planifikimi të zonave të gjelbra (Foto ilustruese)

Burimi: emagazine.com

Mbrojtja e Mjedisit

Toka

Tokat në zonën në studim konsiderohen të kripura në nivele tepër të larta. Në zonën e Velipojes këto toka arrijnë shifrën e mbi 400ha[28]. Ato konsiderohen me kripshmëri tepër të lartë dhe me përshtatshmëri të ulët për kultivimin e kulturave bujqësore në to. Kripëzimi është me origjinë detare nënujore nëpërmjet infiltrimit dhe dominohet nga kripërat e klorit ndërsa mungesa e kullimit dhe kultivimit të tyre përkeqëson më tej strukturën, cilësitë dhe produktivitetit e këtyre tokave.Për të përcaktuar qëllimin e përdorimit të mëtejshëm të këtyre tokave, shikohet e nevojshme të bëhet një analizë financiare mbi kostot e nevoshme për rehabilitimin e kësaj sipërfaqje në tokë bujqësore produktive ose për rigjenerim natyror në pamundësi të përdorimit bujqesor.

Në pjesën fundore të shpatit të malit të Rrencit vërehet veprimtaria e erozionit sipërfaqësor, nga era dhe rrjedhat e proskave që zbresin poshtë. Në shumë prej këtyre zonave degradimi ka arritur në shkallë të lartë, duke i kthyer në toka jo produktive. Për përmirësimin e cilësisë së tokave në zonën në studim do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Pastrimi i kanaleve kullues në mënyrë që të bëhet terja e tokave dhe parandalimi i avancimit të kripëzimit, me pas do të shikohet mundësia e trajtimit të këtyre tokave.
- Mbjellje fidanësh autoktonë në pjesën fundore të malit të Rencit, aty ku veprimtaria e erozionit të tokës është një një shkallë të konsiderueshme, për të krijuar një barrierë si ndaj erozionit të erës dhe për të krijuar prita atu ku ka transportim të dherave nga proskat që zbresin nga shpati i malit.
- Gjithashtu gjatë planifikimit do të tregohet kujdes i vecantë në respektimin e tokës bujqësore, duke evituar konvertimin e saj në tokë për ndërtim.

Uji

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) ka bërë monitorimin e cilësisë së ujërave bregdetare (ujërat e larjes) në 7 pika në Velipojë dhe 5 pika në plazhet e Shëngjinit[29]. Për stacionet e zonave bregdetare janë monitoruar treguesit si temperatura, pH, alkaliniteti, saliniteti, përcjellshmeria elektrike, oksigjeni i tretur, COD (chemical oxygen demand), BOD (biochemical oxygen demand), nitritet, nitratet, amoniaku, fosfori total, PO_4 dhe lënda pezull. Duke analizuar elementët e mësipërm AKM ka nxjerrë të dhënat duke i grupuar në 4 nivele cilësie, A-Cilësi e Shkëlqyer, B-Cilësi e Mirë, C-Cilësi e Mjaftueshme dhe D-Cilësi e Keqe.
Në të gjitha pikat e monitoruara nga AKM në Velipojë rezultoi se ujërat bregdetare janë të cilësisë së shkëlqyer, pra niveli i cilësisë A[30]. Marrë parasysh që lumi Buna dhe Drin mbledhin të

[28]Bashkia Shkodër, Vlerësimi strategjik Mjedisor për PPV-në, 2017
[29]AKM, Raporti i Gjendjes në Mjedis 2017, Tiranë, 2018
[30]AKM, Raporti i Gjendjes në Mjedis 2017, Tiranë, 2018

gjitha ujërat e përdorura të zonës urbane të Shkodrës dhe qytetit Vau i Dejës, bashkë me fshatrat përgjatë rrjedhës së lumit deri në Velipojë, këto monitorime mund të jenë të kontestueshme. Megjithatëë për parandalimin e prishjes së cilësisë së ujërave bregdetare dhe lagunore që ndodhen në zonë është e rëndësishme marrja e masave të mëposhtme:

- Në shkallë të gjerë, nevojitet trajtimi i ujrave të përdorura të qytetit të Shkodrës, fshatrave përredh dhe të Bashkisë Vau i Dejës. Ndalimi i derdhjes së ujrave të ndotura në lumin Drin dhe Buna do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë e ujërave në zonë.
- Projektimi dhe zbatimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të përdorura për fshatin Baks-Rrjoll dhe lidhja me impiantin e trajtimit të ujërave të përdorura Velipojë.
- Trajtimi në vende të përshtatshme i plehrave organike në zonën e Baks-Rrjollit do të ulte ndjeshëm presionin e ndotjes me lëndë organike të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonë.
- Grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta urbane do të sjellë uljen e presionit të ndotjes së ujërave sipërfaqësore nga mbetjet e plastikës dhe materialeve të tjera pluskuese.

Ajri

Verifikimi i kryer në të gjitha burimet e certifikuara të informacionit mbi cilësinë e ajrit, përfshirë këtu Raportet e Gjendjes në Mjedis për vitet 2011-2017 apo raportime të tjera të Institutit të Shëndetit Publik dhe Institutit të Fizikës Bërthamore, tregon se nuk ka monitorime të kryera nga Institucionet publike në territorin e Velipojës dhe zonën në studim. Po kështu nuk ka as thë dhëna të raporteve të vetëmonitorimit duke qenë se në këtë zonë nuk ka subjekte të licensuara industriale që të kenë detyrimin ligjor të hartimit të raporteve të vetëmonitorimit.

Megjithë mungesën e të dhënave, ka argumente të mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se cilësia e ajrit është brenda normave të vendit për sa i takon niveleve të lejuara të ndotjes nga pluhurat PM10 dhe $PM_{2.5}$, dioksidin e squfurit (SO_2), oksidet e azotit (NO_x), ozonin troposferik (O_3), Monoksidin e karbonit (CO), komponimet organike të avullueshme (Benzeni C_6H_6).

Masat për parandalimin e ndotjes së ajrit janë të shumëllojshme dhe në varësi të burimit të ndotjes. Por në mënyrë përgjithësuese masat do të jenë:

- Përmirësimi i transportit publik,
- Mirëmenaxhimi i rrjetit rrugor dhe trafikut,
- Promovimi i përdorimit të bicikletave,
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta, pastrimi dhe larja e rrugëve,
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për një qarkullim më të mirë,
- Ngritja e kapaciteteve lokale për monitorim të cilësisë së ajri dhe mjedisit në tërësi.

Natyra dhe biodiversiteti

Zona në studim dhe rrethinat zotërojnë një larmi biologjike të konsiderueshme, të përfaqësuar nga rreth 30 lloje bimësh, rreth 20 lloje gjitarësh, 238 lloje të shpendëve, 19 lloje zvaranikësh, 11 lloje amfibësh, 143 lloje të peshqve dhe rreth 217 lloje të jovertebrorëve.

Problematika kryesore në këtë zonë mbetet dëmtimi i vazhdueshëm i habitatit, shqetësimi i specieve të egra dhe gjuetia e paligjshme. Në këtë kontekst është e nevojshme të ndërmerren masa të menjëhershme ku ndër më kryesoret janë:

- Mbrojtja dhe restaurimi i habitatit nëpërmjet përcaktimit të territorit sipas ndjeshmërisë, përmirësimit të tokave pyjore dhe konvertimit të tyre në habitate të përshtatshmë për speciet e egra;
- Krijimi i korridoreve lidhës për habitatet, kryesisht përgjatë vijës bregdetare;
- Përmirësimi i zonave të dëmtuara duke ndërhyrë me mbjellje fidanësh autoktonë, pemë dhe shkurre;
- Ndalimi i brakonazhit ose gjuetisë së paligjshme: Përpjekjet për të ulur gjuetinë e jashtëligjshme mund të intensifikohen duke forcuar vigjilencën ndaj ngjarjeve të tilla dhe përforcimet e mekanizmave ndëshkues;

Përcaktimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe peisazhit

Zona subjekt i këtij studimi karakterizohet nga ndjeshmëri shumë e lartë mjedisore, në aspektin e larmisë biologjike dhe tipologjive të peizazhit natyror. Zona në fjalë gëzon status të mbrojtur ligjor, ku përcaktohen qartë veprimtaritë dhe aktivitetet e ndaluara në të. Gjithashtu zona menaxhohet në përputhje me parimet dhe kufizimet e vendosura në planin e menaxhimit. Si e tillë, zona kërkon një kujdes të veçantë në aspektin e planifikimit duke zbatuar një sërë rregullash për mbrojtjen e aspekteve mjedisore në të. Korniza rregullatore për mbrojtjen e mjedisit në tërësi në zonë paraqitet si më poshtë vijon:

- Planifikimi në zonë realizohet në përputhje me Planin e Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur "Peizazh i mbrojtur Lumi i Bunës - Velipojë".
- Gjatë planifikimit duhet të merren në konsideratë dhe të zobatohen pengesat ligjore që rrjedhin nga ligji 81/2017 "Për zonat e mbrojtura". Konkretisht duhet pasur parasysh parimet e menaxhimit dhe planifikimit të shprehura në nenin 4 dhe aktivitetet e ndaluara të shprehur në nenin 48 pika 1, 2 dhe 3.
- Ndërtimet në zonë të shoqërohen gjithmonë me krijimin e sipërfaqeve të gjelbra, duke i konceptuara të ndërthurura nga gjelbërim i ulet e deri tek pemët e larta, në mënyrë që të plotësohet gjelbërimi publik dhe përmirësimi i peizazhit.
- Brezat mbrojtës me pemë autoktone duhet të rrethojnë të gjithë bregun e trupit ujorë në zonë, lagunës, në një gjerësi prej 20 m nga kuota maksimale.

- Ndalohet rreptësisht aktiviteti ndërtimor dhe bujqësor në pusshpimet e ujit të pishëm, në zonën A ndalohet çdo lloj aktiviteti në distancën 20 m ndërsa në zonën B aktivitetet që mund të shkarkojnë ndotje ndalohen deri në distancën 100 m.
- Përgjatë kanaleve kullues dhe vaditës duhet të ruhet një distance sigurie nga ndërtimet e mundshme, në gategorinë e parë të kanaleve 8 m dhe në kanalet dytësor 4 m.
- Mbjelljet e reja në zonë duhet të bëhen me bimësi autoktone, duke imituar katet e pyllit, që fillon nga shkurret e deri tek drurët e lartë.
- Zonat të cilat vlerësohen si të rëndësishme për larminë biologjiketë lihen të pashqetësuara, duke krijuar zonë buferike (tampon) me bimësi të lartësive të ndryshme në gjerësi 20-100 m.
- Dunat ranore të zonës së Baks-Rrjollit duhet të ruhen të paprekura dhe të mirëmbahen me shtimin e rërës në pjesën e paradunave, gjithashtu të mbillen bimë të përshtatshme për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis

Ndërveprimet e mundshme të PDZRK me mjedisin

Në PDZRK parashikohen tre programe strategjike dhe një sërë masash që do të kenë ndërveprim të fortë më mjedisin, si në aspektin pozitiv por edhe me ndikime negative përgjithësisht mbi mesatar.

Pothuajse të gjithë projektet e propozuara nga PDZRK kanë ndikim në mjedis, në nivele të ndryshme dhe specifik për secilin prej komponentëve të mjedisit. Projektet në PDZRK kryesisht janë në formën e ndërhyrjeve fizike në territor, pasi ndërtimi i infrastrukturës së turizmit janë të tilla.

Në tabelën në vijim listohen projektet e propozuara në PDZRK, ndërhyrjet që parashikohet të ndodhin për cdo projekt si dhe ndërveprimi që ka secili me mjedisin. Ndërsa në seksionet në vijim do të analizohen në mënyrë specifike të gjithë ndikimet e mundëshme që kanë këto projekte në komponentët e mjedisit dhe shëndetin e njerzve.

Projektet e PDZRK BAKS - RRJOLL	**NDËRHYRJA**	**NDËRVEPRIMI ME MJEDISIN**
O.01 Aspektet Mjedisore		
Pr.1: Shtimi i gjelbërimit autokton me bimësi të lartë dhe të ulët	Mbjellje fidanësh	I ulët
Pr.2: Shtimi i gjelbërimit autokton me bimësi të lartë përgjatë rrugës Shëngjin-Velipojë (barrierë vizive dhe akustike)	Mbjellje fidanësh	I ulet
Pr.3: Sistemi i grumbullimit diferencimit dhe largimit të mbetjeve urbane	Vendosje kontenierësh	I ulët
Pr.4: Trajtimi i mbetjeve organike si kompost (baze familjare në fshat)	Kompostim	I ulet
Pr.5: Sistemimi i brezit mbrojtës së lagunës së Vilunit.	Mbjellje fidanësh	I ulët
Pr.6: Masa mbrojtëse për rënien e shkëmbinjve	Prita malore	I ulët
O.02 Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës		
Pr.1: Nyje ne nivel me trafik te rënduar	Infrastrukturë rrugore	Mesatar
Pr.2: Nyje e thjeshte (trafik i reduktuar)	Infrastrukturë rrugore	Mesatar
Pr.3: Sistemimi i kalimeve këmbësore nga rruga Shëngjin-Velipojë	Infrastrukturë rrugore	I ulët
Pr.4: Sistemimi i kalimeve këmbësore nga rruga Shëngjin-Velipojë	Infrastrukturërrugore	I ulët

Pr.5: Ndërtimi i akseve të brendshme të zonës me profil minimal	Infrastrukturë rrugore	I lartë
Pr.6: Ndërtimi shëtitores këmbësore Velipojë- Baks-Rrjoll	Rrugicë	Mesatar
Pr.7: Sistemimi i urave këmbësore në lagunë	Ndërtim ura druri	Mesatar
Pr.8: Organizimi i Vendparkimeve	Vend parkim	Mesatar
Pr.9: Ndërtimi i një stacioni autobuzi linje dhe taksish	Stacion autobuzi	I ulët
Pr.10: Ndërtimi i rrjetit të korsive çiklistike	Korsi biciklete	I Ulët
Pr.11: Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm për kapacitetin turistik të propozuar (bazuar në standardet për turist)	Ndërtim ujësjellsi	Mesatar
Pr.12: Ndërtimi i rrjeti të largimit të ujrave të ndotur (shiu dhe te zeza) dhe dërgimi në impiantin e Velipojës	Ndërtim kanalizimesh	Mesatar
Pr.13: Kosto per UB	-	-
Pr.14: Furnizimi me energji elektrike për kapacitetin turistik të propozuar (bazuar në standardet për turist)	Ndërtim linjash elektrike	Mesatar
Pr.15: Ndërtimi i rrjetit të fibrës optike dhe telekomunikacionit	Ndërtim rrjeti fibre	Mesatar
Pr.16: Ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksion i atyre ekzistuese	Ndërtim godine dhe rikonstruksion	Mesatar
O.03 Zhvillimi i turizmit		
Pr.1: Ndërtimi i tregut të produktit vendas	Ndërtesë	Mesatar
Pr.2: Ndrëtimi i një zone shërbimesh tregtare	Ndërtesa dhe infrastrukture	I lartë
Pr.3: Ndërtimi i shërbimeve publike: ambulancë, postë, bankë, etj	Ndërtim godinash	Mesatar
Pr.4: Ndërtimi i lulishteve dhe parqeve me mobilim urban	Ndërtim parku	mesatar
Pr.5: Ndërtimi i një zone me aktivitete sportive	Ndërtim terrene sportive	Mesatar
Pr.6: Unifikimi i fasadave dhe mureve rrethues ne fshat	Rikonstruksion	Mesatar
Pr.7: Ndërtimi i 3-4 resorteve me 4-5 yje sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare	Ndërtim Resortesh	I lartë

Kufizimet ligjore në çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësisë kombëtare

Zhvillimi i infrastrukturës së turizmit shpesh shtrihen në sipërfaqe të gjera të territorit, në disa raste duke krijuar konflikt me çështje, zona apo objekte të rëndësisë kombëtare, ku shumica prej

tyre kanë kufizime ligjore. Disa prej këtyre zonave të rëndësishme kombëtare janë (krahas të tjerave) zonat e mbrojtura mjedisore, burimet ujore, habitatet më rëndësi për zhvillimin e larmisë biologjike dhe burimet e ujërave për furnizimin më ujë të pishëm popullatën. Kufizimet më të qënësishme, dhe që mendohet të ketë konfliktualitet PDZRK janë paraqitur në tabelën në vijim.

Zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare	Kufizimet ligjore
Zonat e Mbrojtura Mjedisore	Zonat e Mbrojtura sipasllojeve dhe kategorive në Ligjin 81/2017 " Për Zonat e Mbrojtura": ***a) zona të mbrojtura me interes kombëtar;*** *i) "Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I)"; ii) "Park kombëtar (kategoria II)"; iii) "Monument natyror (kategoria III)"; iv) "Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV)"; v) "Peizazh i mbrojtur (kategoria V)"; vi) "Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (kategoria VI)". vi) "Park natyror bashkiak (kategoria IV)"; vii) "Kurorë e gjelbër (kategoria V)* ***b) zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar ku bëjnë pjesë:*** *i) zonat "Ramsar"; ii) zonat me interes për Komunitetin Europian (SACs), ku bëjnë pjesë zonat e veçanta të ruajtjes të habitateve dhe të shpendëve (SCI dhe SPAs); iii) zonat me interes të veçantë ruajtjeje (zonat e rrjetit Emerald); iv) zonat "Rezervë të biosferës"; v) zonat e trashëgimisë natyrore Territori i zonës së mbrojtur mjedisore për zonat e mbrojtura të kategorive "Park kombëtar", "Rezervë natyrore e menaxhuar" dhe "Peizazh i mbrojtur" ndahet në nënzona, sipas rëndësisë së habitateve dhe të ekosistemeve që bëjnë pjesë në to. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërhyrjet në këto zona bëhet komform ligjit për zonat e mbrojtura dhe në përputhje më planet e menaxhimit të këtyre zonave, varësisht llojit dhe zonimit përcaktohen dhe përdorimet e mundshmë në to.* *Ndërsa për zonat e mbrojtura të kategorive "Rezervë strikte e mbrojtur" dhe "Monumentet e natyrës" nuk do të ketë nënzona, por zonë buferike. Zona buferrike nënkupton një zonë e cila nuk lejon tjetërsimin apo ndërhyrje më*

	ndikim negativ të qënësishëm. Zona buferike është përcaktuar jo më pak se 200m.
Burimet ujore	**Ligji 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"** Përcakton kushtet dhe kriteret për mbrojtjen e burimeve ujore, të tilla si: *i) Mbrojtjen e burimeve ujore nga ndaotja dhe keq-menaxhimi;* *ii) mbrojtja e brigjeve nga ndërtimet e ndryshme;* *iii) Mbrojtjen e zonave "dritare hidrologjike" të cilat ushqejnë direkt ujërat nëntokësor* *iv) Ndalimin e devijimit të rrjedhave dhe dëmtimin e shtretërve të lumenjëve.* *v) Ndalimin e ndërtimeve rreth zonave të burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale pa lejen e organeve të menaxhimit të burimeve ujore, etj.*
Uji i pishëm për popullaten	**Ligji 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"**përcakton kriteret e mbrojtjes së ujit të pishëm për popullatën, ndër të tjera përmendim: Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare *i) Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare përcaktohen rrotull burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore të ujit, që furnizojnë popullsinë urbane e rurale me ujë, me qëllim që të ruhet cilësia e ujit pranë burimit.* *ii) Kufijtë e këtyre zonave miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, ministrit përgjegjës për ekonominë, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për punët publike.* Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare përbëhen nga: *i) zona e parë e mbrojtjes rrotull burimit, që kontrollohet nga operatori që nxjerr, prodhon dhe shpërndan ujë të pijshëm. Kjo zonë rrethohet;* *ii) zona e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës ndalohen ndërtimet, zhvillimi i industrisë, kryerja e veprimtarive bujqësore e blegtorale, etj.*

	iii) zona e mbrojtjes së largët, brenda së cilës veprimtaritë e parashikuara në shkronjën "b" të kësaj pike do të jenë objekt i autorizimeve të posaçme administrative.
Biodiversiteti dhe habitatet	**Nr. 9587, datë 20.7.2006 " Për mbrojtjen e biodiversitetit" (i ndryshuar),** *përcakton kriteret për mbrojtjen e biodiversitetit dhe habitateve me rëndësi për të. Ligji gjithashtu thekson se, Ekosistemet, habitatet dhe peizazhet ruhen edhe kur ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, pronë publike apo private.* *Veprimtaritë ose përdorimet e reja në ekosisteme, habitate dhe peizazhe të mbrojtura mund të ushtrohen vetëm pasi t'u jenë nënshtruar procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të jenë pajisur me leje mjedisore.*

Ndikimet e mundshme negative

Ndikimet më të qënësishme në mjedis nga zbatimi i projektetve të propozuara në PDZRK pritet të ndodhin kryesisht në komponentët mjedisor të tokës, ajrit, ujit biodiversitetit dhe peizazhit. Duke qënë që shkarkimet në ajër pritet të rriten, niveli zhurmave gjithashtu, mendohet se do të ketë edhe ndikime negative zinxhir, si çlirimi i gazeve serë, shirat acide dhe ndikimi në shëndetin dhe mirëqënien e popullatës si pasojë e ndotjes së ajrit dhe rritjes së nivelit të zhurmave. Specifikisht ndikimet negative kryesore që mund të përkeqësojnë situatën mjedisore pas zbatimit të projekteve të propozuara në PDZRK janë:

i) zënia e tokës dhe koracimi i saj;
ii) ndotja e ajrit, vibrime dhe rritja e nivelit të zhurmave;
iii) modifikimi i brigjeve të rrjedhave lumore,
iv) ndotja e ujërave dhe shirat acide;
v) Humbja dhe degradimi i habitateve, fragmentimi dhe shqetësimi i specieve;
vi) shtimi i gazeve serë në atmosferë *dhe*
vii) ndikime të mundëshme në shëndetin e njerzve

RECEPTORI	O.01 Aspektet Mjedisore	O.02 Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës	O.03 Zhvillimi i turizmit

Toka	Përzierje dherash	Zënia e tokës Betonizimi i tokës Prishja e strukturës së tokës	Zënia e tokës Betonizimi i tokës Prishja e strukturës së tokës
Ajri dhe Zhurmat	-	Ndotja e Ajrit Vibracione Zhurma	Ndotja e Ajrit Vibracione Zhurma
Uji	-	Modifikim i rrjedhave ujore Ndotja e ujërave me inerte deh hidrokarbure Shirat acide	Modifikim i rrjedhave ujore Ndotja e ujërave me inerte deh hidrokarbure Shirat acide
Biodiversiteti	Rritje të biodiversitetit	Humbja e habitateve Fragmentimi i habitateve Ndotja e ekosistemeve Shqetësimi i Habitateve dhe specieve Shpyllëzim	Humbja e habitateve Fragmentimi i habitateve Ndotja e ekosistemeve Shqetësimi i Habitateve dhe specieve Shpyllëzim
Peizazhi	Përmirësim peizazhi	Ndryshimi i tipologjisë së terrenit Fragmentimi i peizazhit Dëmtime vizuale Shpyllëzim	Ndryshimi i tipologjisë së terrenit Fragmentimi i peizazhit Dëmtime vizuale Shpyllëzim
Ndryshimet Klimatike	-	Çlirimi i gazeve me efekt sere	Çlirimi i gazeve me efekt serë
Kultura	-	-	-
Cilësia e jetës	-	Ndotja e Ajrit	Ndotja e Ajrit Ndotja e Ujërave

		Ndotja e Ujërave Ndotja nga zhurmat Shirat acide bëmtojnë të mbjellat	Ndotja nga zhurmat Shirat acide bëmtojnë të mbjellat

Ndikimet në mjedis të PDZRK

Metodika e Vlerësimit të ndikimit në mjedis të PDZRK

Vlerësimi i ndikimit në mjedis, është përgatitur në përputhje me kerkesat e Ligjit 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor". Ndikimet e rëndësishme të PDZRK në mjedis dhe objektivat mjedisore janë analizuar dhe vlerësuar sipas shkallëve të mëposhtme:

0 = S'ka ndikim/ndikim pozitiv
1= Ndikim i parëndësishëm / ulët
2= Ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse / mesatar
3= Ndikim i rëndësishëm / lartë
x= Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur

Vlerësimi i ndikimit në mjedis të PDZRK sipas shkallëve "0", "1" dhe "2" tregon së ndikimet e projekteve të PDZRK, duke ndërmarrë masa zbutëse të ndikimit në mjedis, janë të pranueshme dhe nuk kanë ndikime të pakthyeshme për objektivat mjedisorë të përmendur në seksionet e mësipërme.

Shkalla e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis "3" tregon se zbatimi i projekteve të PDZRK është i papranueshëm në aspektin mjedisor sepse ndikimi është tepër shkatërrues. Megjithë ndërmarrjen e masave zbutëse, ky ndikim nuk mund të mbahet nën kontroll.

Shkalla "x" e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis tregon parimisht se ndikimi i disa prej projekteve nuk njihet ende për arsye të karakteristikave apo për shkak të njohurive të kufizuara shkencore.

Përshkrimi i kritereve të vlerësimit në mjedis të PDZRK

Vlerësimi i ndikimit në mjedis të projekteve të PDZRK ka marrë në kosideratë 6-të kritere, bazuar edhe në Ligjin 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor".

Kriteret e përdorura për një vlerësim sa më të saktë të ndikimit në mjedis të këtyre projekteve janë:

i) mundësia e shfaqjes së ndikimit;
ii) kohëzgjatja e ndikimit;
iii) natyra e ndikimir;

iv) riaftësimi i ndikimit;
v) natyra komulative e ndikimit *dhe*
vi) shtrirja e ndikimit.

Vlerësimi është bërë në sajë të vlerave numerike, ku ndikimi i papërfillshëm vlerësohet me 0 (zero) dhe ndikimi më shkatërrues është vlerësuar me numrin 3 (tre). Siç është përmendur edhe më lart, me shkronjën "x" janë vlerësuar projektet që nga pamundësia e njohjes së ndikimit nuk merren parasysh në vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Mesatarja e secilit prej kritereve nxjerr vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit të vlerësuar. Në tabelën në vijim janë paraqitur të listuar kriteret e vlerësimit si dhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit për cdo kriter.

Kriteret e vlerësimit	Shpërndarja e pikëve të vlerësimit		
Mundësia e shfaqjes	JO	PO	E pasigurt
Pikët	0	3	1 dhe 2
Kohëzgjatja	E papërfillshme	E menjëhershme	Afatshkurtër ose afatgjatë
Pikët	0	3	1 dhe 2
Natyra e ndikimit	Neutrale	Shkatërruese	Dëmtime të pjesshme
Pikët	0	3	1 dhe 2
Riaftësimi i ndikimit	Nuk ka kthim të ndikimit	Kthim i plotë	E pjesshme
Pikët	0	3	1 dhe 2
Natyra kumulative	JO	PO	E pasigurt
Pikët	0	3	1 dhe 2
Shtrirja	Pikësore dhe pa popullsi	Sipërfaqe e madhe dhe popullsi e lartë	E ndërmjetme
Pikët	0	3	1 dhe 2

Vlerësimi i ndikimeve në mjedis të projekteve të PDZRK

Projektet e propozuara në PDZRKndahen në 3 grupe, të cilat përfaqësojnë edhe 3 objektivat strategjike të sajë, Përmirësimi i aspektit mjedisor, përmirësimi i nfrastrukturor dhe zhvillimi i turizmit.

Për të tre objektivat janë propozuar 29 projektie, ku pjesa më e madhe e tyre kosiston në ndërhyrje fizike në territor, të cilat shoqërohen me ndikime të konsideruedhme në mjedis dhe kërkojnë masa paraprake për zbutjen e ndikimit.

Për efekt të lehtësimit në vlerësimin e ndikimit në mjedis, objektivat e VSM-së (11 objektivat për mbrojtjen e mjedisit), janë grupuar sipas komponentëve mjedisorë, konkretisht Toka, Ajri dhe Zhurmat, Burimet ujore, Natyra dhe Biodiversiteti, Peizazhi, Klima, Kultura dhe Trashëgimia dhe Cilësia e jetës si dhe Shëndeti.

PDZRK BAKS-RRJOLL: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O.01 Aspektet Mjedisore										
Pr.1: Shtimi i gjelbërimit autokton me bimësi të lartë dhe të ulët	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Pr.2: Shtimi i gjelbërimit autokton me bimësi të lartë përgjatë rrugës Shëngjin-Velipojë (barrierë vizive dhe akustike)	0	1	1	0	0	0	0	0	0	
Pr.3: Sistemi i grumbullimit diferencimit dhe largimit të mbetjeve urbane	0	0	1	1	0	1	0	0	0	0
Pr.4:Trajtimi i mbetjeve organike si kompost (baze familjare në fshat)	2	2	1	0	0	2	1	0	0	0
Pr.5: Sistemimi i brezit mbrojtës së lagunës së Vilunit.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr.6: Masa mbrojtëse për rënien e shkëmbinjve	0	1	1	1	1	2	0	0	0	0
O.02 Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës										
Pr.1: Nyje ne nivel me trafik te rënduar	2	2	2	1	1	2	2	1	1	1
Pr.2: Nyje e thjeshte (trafik i reduktuar)	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Pr.3: Sistemimi i kalimeve këmbësore nga rruga Shëngjin-Velipojë	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0

Pr.5: Ndërtimi i akseve të brendshme të zonës me profil minimal	2	2	3	2	2	2	3	2	2	0
Pr.6: Ndërtimi shëtitores këmbësore Velipojë- Baks-Rrjoll	1	2	2	2	1	2	1	0	0	0
Pr.7: Sistemimi i urave këmbësore në lagunë	0	2	0	2	0	2	0	0	0	0
Pr.8: Organizimi i Vendparkimeve	1	2	3	1	1	2	1	0	0	0
Pr.9: Ndërtimi i një stacioni autobuzi linje dhe taksish	2	2	3	1	1	2	1	0	0	0
Pr.10: Ndërtimi i rrjetit të korsive çiklistike	0	0	1	1	1	1	0	0	0	0
Pr.11: Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm për kapacitetin turistik të propozuar (bazuar në standardet për turist)	1	2	2	1	1	2	1	0	0	0
Pr.12: Ndërtimi i rrjeti të largimit të ujrave të ndotur (shiu dhe te zeza) dhe dërgimi në impiantin e Velipojës	1	1	2	1	1	1	1	0	0	0
Pr.13: Kosto per UB	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pr.14: Furnizimi me energji elektrike për kapacitetin turistik të propozuar (bazuar në standardet për turist)	1	1	2	2	1	2	0	0	0	0
Pr.15: Ndërtimi i rrjetit të fibrës optike dhe telekomunikacionit	1	1	1	1	1	1	0	0	0	0
Pr.16: Ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksion i atyre ekzistuese	1	1	1	1	1	1	1	0	0	0
O.03 Zhvillimi i turizmit										
Pr.1: Ndërtimi i tregut të produktit vendas	2	2	3	2	2	2	2	0	0	0
Pr.2: Ndrëtimi i një zone shërbimesh tregtare	2	3	3	2	3	2	2	0	0	0
Pr.3: Ndërtimi i shërbimeve publike: ambulancë, postë, bankë, etj	2	2	3	2	2	2	2	0	0	0
Pr.4: Ndërtimi i lulishteve dhe parqeve me mobilim urban	1	1	2	1	1	1	1	0	0	0
Pr.5: Ndërtimi i një zone me aktivitete sportive	1	1	2	2	2	2	0	0	0	0
Pr.6: Unifikimi i fasadave dhe mureve rrethues ne fshat	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr.7: Ndërtimi i 3-4 resorteve me 4-5 yje sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare	2	2	3	3	3	3	2	0	0	0

Përputhshmeria e PDZRK me objektivat mjedisorë

Metodika e përputhshmërisë së projekteve të PDZRK me Objektivat Mjediore

Përputhshmëria e objektivave të PDZRK me objektivat mjedisorë është kryer në mbështetje të plotë më ligjin nr. 91/2013, "Për vlerësimin Strategjik Mjedisor", konkretisht bazuar në shtojcën 1 të tij. Përputhshmëria e objektivave të PDZRK me OM-të është kryer me vlera numerike, duke e ndarë përputhshmërinë në 5 nivele. Konkretisht nivelet e vlerësimit numerik të përputhshmërisë së objektivave të PDZRK-së me OM-të, paraqiten në tabelën në vijim.

Vlerësimi numeri I përputhshmërisë së PDZRK me OM		
Nuk Përputhet	-1.00	-
Nuk lidhet	0.00	0.00
Përputhje e zbehtë	1.00	0.01-1.49
Përputhje e pjesshme	2.00	1.5-2.49
Përputhet plotësisht	3.00	2.51-3

Përputhshmëria e PDZRK me OM-të

Përputhshmëria e projekteve, programeve dhe objektivave strategjike të PDZRK me OM-të është realizuar në bazë të të shtojcës Nr. 1 të ligjit 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor".

Në tabelën në vijim paraqitet në mënyrë të detajuar vlerësimi numerik i përputhshmërisë së projekteve, dhe objektivave strategjike të PDZRK me OM-të. Gjithashtu në tabelë paraqiten dhe mesataret e përgjithshme të përputhshmërisë së objektivave të PDZRK me OM-të.

PDZRK BAKS-RRJOLL: PËRPUTHSHMËRIA										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O.01 Aspektet Mjedisore										
Pr.1: Shtimi i gjelbërimit autokton me bimësi të lartë dhe të ulët	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3

Pr.2: Shtimi i gjelbërimit autokton me bimësi të lartë përgjatë rrugës Shëngjin-Velipojë (barrierë vizive dhe akustike)	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Pr.3: Sistemi i grumbullimit diferencimit dhe largimit të mbetjeve urbane	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Pr.4:Trajtimi i mbetjeve organike si kompost (baze familjare në fshat)	2	1	3	2	2	1	1	3	3	3
Pr.5: Sistemimi i brezit mbrojtës së lagunës së Vilunit.	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Pr.6: Masa mbrojtëse për rënien e shkëmbinjve	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0
O.02 Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës										
Pr.1: Nyje ne nivel me trafik te rënduar	1	1	1	1	2	2	2	3	3	3
Pr.2: Nyje e thjeshte (trafik i reduktuar)	1	1	1	1	2	2	2	3	3	3
Pr.3: Sistemimi i kalimeve këmbësore nga rruga Shëngjin-Velipojë	0	0	0	-1	0	2	0	3	3	3
Pr.5: Ndërtimi i akseve të brendshme të zonës me profil minimal	1	1	-1	-1	2	1	1	3	3	3
Pr.6: Ndërtimi shëtitores këmbësore Velipojë- Baks-Rrjoll	2	2	1	1	1	1	1	3	3	3
Pr.7: Sistemimi i urave këmbësore në lagunë	0	1	0	-1	0	1	0	0	0	0
Pr.8: Organizimi i Vendparkimeve	1	1	-1	1	2	1	1	3	3	3
Pr.9: Ndërtimi i një stacioni autobuzi linje dhe taksish	2	1	1	1	1	1	2	3	3	3
Pr.10: Ndërtimi i rrjetit të korsive çiklistike	3	2	1	1	2	1	3	3	3	3
Pr.11: Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm për kapacitetin turistik të propozuar (bazuar në standardet për turist)	2	2	2	2	2	2	2	3	3	3
Pr.12: Ndërtimi i rrjeti të largimit të ujrave të ndotur (shiu dhe te zeza) dhe dërgimi në impiantin e Velipojës	2	3	2	2	2	2	2	3	3	3
Pr.13: Kosto per UB	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Pr.14: Furnizimi me energji elektrike për kapacitetin turistik të propozuar (bazuar në standardet për turist)	2	2	2	2	2	2	2	3	3	3
Pr.15: Ndërtimi i rrjetit të fibrës optike dhe telekomunikacionit	2	2	2	2	2	2	2	3	3	3
Pr.16: Ndërtimi i kabinave të reja dhe rikonstruksion i atyre ekzistuese	1	1	1	2	2	1	1	3	3	3
O.03 Zhvillimi i turizmit										
Pr.1: Ndërtimi i tregut të produktit vendas	1	1	-1	1	1	1	1	3	3	3
Pr.2: Ndrëtimi i një zone shërbimesh tregtare	1	1	-1	1	1	1	1	3	3	3
Pr.3: Ndërtimi i shërbimeve publike: ambulancë, postë, bankë, etj	2	2	2	2	2	1	2	3	3	3
Pr.4: Ndërtimi i lulishteve dhe parqeve me mobilim urban	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Pr.5: Ndërtimi i një zone me aktivitete sportive	2	2	2	2	2	2	2	3	3	3
Pr.6: Unifikimi i fasadave dhe mureve rrethues ne fshat	2	2	2	0	0	3	2	3	3	3
Pr.7: Ndërtimi i 3-4 resorteve me 4-5 yje sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare	1	1	-1	-1	-1	-1	1	3	3	3

Vlerësimi i pasojave të zbatimit të PDZRK në realizimin e objektivave mjedisorë

Ndërtimet infrastrukturore të turizmit shoqërohen me ndryshime të qënësishme në territor. Ndryshimet ndodhin në shkallë të lokalizuar dhe kanë ndikime të ndryshme në komponentët mjedisorë si tokë, ajër, ujë, biodiversitet, ndryshimet klimatike dhe peizazh. Në tabelën në vijim paraqiten në mënyrë specifike për çdo komponent mjedisor, shoqëruar nga objektivi mjedisor, të gjitha ndikimet e mundëshme nga zhvillimi i projekteve të propozuara në PDZRK.

Komponenti mjedisor	Objektiva Mjedisore	Ndikimi i PDZRK në OM-të
Toka	OM 1: Sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së tokës.	Ndikimet mendohet të shfaqen në formën e: i) trazimit të dherave, ku ekziston mundësia e dherave të ndotura, ii) ngjeshjes së tokës në përgjithësi dhe e tokës bujqësore/natyrore në afërsi të kantierëve të ndërtimit, iii) ndotjes së tokave, kryesisht nga trazimi i dherave dhe nga shkarkimet e hidrokarbureve, vajrave dhe lëndëve të tjera që përdoren nga makineritë dhe proceset e ndërtimit *dhe* iv) derdhjet aksidentale të lëndëve ndotëse nga makineritë që përdoren gjatë proceseve të ndërtimit.
	OM 2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të ricikluara në ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës së turizmit.	Në fazën e ndërtimit kërkohen sasi të mëdha të materialeve inerte që përkthehet në trysni të lartë mbi burimet natyrore. Gjithashtu gjatë kësaj fazë pritet të ketë një sasi të lartë të gjenerimit të mbetjeve, kryesisht të mbetjeve inerte. Gjatë kësaj faze duhet patur parasysh që të ripërdoren mbetjet inerte që krijohen, gjithashtu të shikohet mundësia për ripërdorimin edhe të stokut të mbetjeve inerte që ndodhen në vendin tonë. Në ripërdorimin e mbetjeve inerte duhet pasur parasysh përmbajtja e tyre, ato duhet të jenë të pastra dhe pa elementë ndotës, të cilët mund të kthehen në kërcënim serioz për ndotjen e tokës dhe ujërave në zonën e përdorur.

Ajri	OM 3: Ruajtja e cilësisë së ajrit në qendrat e banuara dhe sigurimi i arritjes së objektivave afatgjata kombëtare për sasitë vjetore të emetimeve të ndotësve atmosferikë.	Elementët ndotës të ajrit që rëndom ë clirohen mendohet të jenë: PM, SO_x, NO_x, CO, VOC, GES, etj. Ndikimet kryesore të ndotjes së ajrit nga operimi i infrastrukturës së turizmit janë: i) Shkarkimi i ndotë ii) sve në ajër (përmendur më sipër) në sasi të konsiderueshme. iii) rritjen e presionit të ndotjes së ajrit në zona të cilat më parë nuk kanë pasur problematika të tilla *dhe* iv) shtimin e gazeve me efekt serë në atmosferë,
Faktorët klimatikë	OM 4: Përshtatja ndaj efkteve të ndryshimit të klimës globale dhe reduktimi i sasive të emetimeve të gazeve serë.	Vlerësimi i saktë sasive të GES-ve që do të shkarkohen në atmosferë është i pa mundur të bëhet në këtë fazë, por duhet monitoruar gjatë fazës së operimit. Mbajtja nën kontroll e shkarkimeve të GES kërkon masa të integruara dhe bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve të ndryshme në vend. Ky bashkëpunim duhet të mbajë parasysh se SKZHI-II synon të arrijë reduktimin me 8% të GES dhe 40% të HCFC-të krahasuar me skenarët bazë.
Burimet ujore	OM 5: Kufizimi i ndikimeve të presionit të infrastrukturës së turizmit mbi ujërat e sipërfaqes dhe nën-tokës, ujërat e lumenjëve, ujërat bregdetarë, lagunorë dhe burimet e ujit të pijshëm.	Ndikimet kryesore gjatë fazës së ndërtimit konsistojnë në: i) ndotjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë si pasojë e përzierjes së dherave gjatë ndërtimit. ii) ndotjen e ujërave bregdetare me lëndë të ngurtë pezull gjatë punimeve për ndërtimin e në afërsi të zonës së bregdetit. iii) moskoracimin e sipërfaqeve poroze me asfalt gjë që do të ndikojë në infiltrimin në ujërat nëntokësor *dhe* iv) ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në raste të ngjarjeve të

		jashtëzakongjme gjatë punimeve si p.sh. derdhjet aksidentale të hidrokarbureve nga makineritë teknologjike që përdoren në proceset e ndërtimit të infrastrukturës së Zonës. v) Konsumi i ujit për përdorim turizmi vi) Ujrat e ndotura urbane
Natyra	OM 6: Sigurimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit në territor.	Ndikimet kryesore konsistojnë në: i) Shqetësim të specieve të faunës së egër, nga zhurmat teknologjike dhe industriale; ii) Shqetësim nga prania e shtuar e njerëzve dhe makinerive në zona të caktuara; iii) Humbje fizike e habitateve natyrorë. iv) Fragmentim/shkatërrim të përkohshmëm, apo i përhershëm i habitateve; v) Humbje, degradim ose shqetësim i korridoreve lidhës të popullatave shtazore; vi) Ndotje të habitateve dhe ekosistemeve të ndryshëm; vii) Zhvendosje speciesh gjatë zhvendosjes së dherave; viii) Humbje e specieve të faunës dhe florës. Këto ndikime janë vecanërisht të larta në zonat e njohura për vlerat e larta të biodiversitetit e sidomos ne entitetet e njohura e të mbrojtura ligjërisht si: • Zonat e Mbrojtura • Zonat Ramsar • Zonat Emerald • Zonat e Rëndësisshme për Shpendët dhe Biodiversitetin (IBAs) • Zonat pilot Natura 2000

	OM 7: Ruajtja e larmisë biologjike të zonave me status natyror të mbrojtur përkundrejt aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.	Duhet theksuar se, zhvillimi infrastrukturor dhe turistik në mjedisin natyror përfaqëson një humbje të përhershme të habitatit, gjë e cila ndikon negativisht përgjithnjë në shpërndarjen natyrore të llojeve të habitateve, bimëve dhe shpendëve, si dhe në cilësinë dhe integrimin e popullatave të habitateve. Këto ndikime janë vecanërisht të larta në zonat e njohura për vlerat e larta të biodiversitetit e sidomos ne entitetet e njohura e të mbrojtura ligjërisht si: • Zonat e Mbrojtura • Zonat Ramsar • Zonat Emerald • Zonat e Rëndësisshme për Shpendët dhe Biodiversitetin (IBAs) • Zonat pilot Natura 2000
Zurmat në mjedis	OM 8: Parandalimi/Reduktimi i ndotjes së mjedisit nga zhurma dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE	Rritja e nivelit të zhurmave pritet të rritet ndjeshëm në zonën e zbatimit të PDZR-së, si rrjedhojë e ndërtimit të godinave dhe infrastrukturës në fazën fillestara, por edhe si pasojë e operimit, ku dihet që aktivitetet e turizmit clirojnë zhurma të konsiderueshme në mjedis,kryesisht nga Clubet dhe aktivitetet në natyre.
Popullsia dhe asetet materiale	OM 9: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve në afërsi të zonës së PDZRK	-
Trashëgimia kulturore	OM 10: Ruajtja e fushëveprimit dhe karakteristikave të objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore.	Nuk ka ndikim

Peizazhi	OM 11: Sigurimi i ruajtjes së peizazheve të jashtëzakonshme dhe zonave me peizazhe me karakteristika të veçanta në nivel lokal dhe kombëtar dhe një imazh peizazhi me cilësi.	*Faza e Ndërtimit:* Përcaktimi i ndikimit mbi cilësinë e peizazhit rrjedh kryesisht nga karakteristikat e dukshme të hapësirës dhe elementët karakteristikë të peizazhit të pranishëm në hapësirë. Gjatë fazës së ndërtimi dhe operimit pritet të ndodhë një fragmentim i peisazhit. gjithashtu do të ketë një prani të shtuar të mjeteve teknologjike, të cilët kanë një ndikim jo të vogel në pikpamjen peizazhistike. Shihet më se e rëndësishme zbatimi i masave përmirësuese peizazhistike që në fazat e hershme, duke minimizuar impaktin vizual.

Masat zbutëse

Në vijim do të listohen në mënyrë specifike udhëzimet dhe masat zbutëse për çdo komponent mjedisor. Masta zbutëse dhe udhëzimet e përgjithshme për minimizimin e ndikimeve të mundëshme në mjedis të shkaktuara nga implementimi i projekteve të propozuara në PDZRK janë:

Toka

- Planifikimi i infrastrukturës së turizmit duhet të integrojë atë me mjedisin, vecanërisht me aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës.
- Aktivitetet në tokën bujqësore dhe pyjore duhet të reduktohen në nivelin më të ulët të mundshëm dhe i duhet dhënë përparësi e lartë planifikimit të aktiviteteve në tokat me potencial më të varfër prodhimi.
- Integrimi i zonave për ndërtim të resorteve apo infrastrukturës në brendësi të zonave ekzistuese.
- Ndërtimet dhe infrastruktura duhet të ndërtohet komform kushteve teknike, në mënyrë që të reduktojë mundësinë e rrëshkitjeve të tokës.
- Materialet që do të gërmohen gjatë ndërtimit duhet të ripërdoren plotësisht, kryesisht për të realizuar proceset e mbushjeve mekanike, aty ku është e mundur.

Ajri

- Monitorimi periodik dhe konform standarteve të shkarkimeve të elementëve ndotës në atmosferë.
- Gjatë fazës së ndërtimit të zbatohen rregullat për parandalimin e ndotjes së ajrit, kryesisht nga Puhurat.

Faktorët klimatikë

- Duhet të bëhet një analizë e ndjeshmërisë së infrastrukturës së turizmit ndaj ndryshimeve klimatike dhe fenomenteve që vijnë si rrjedhojë.
- Në bazë të rezultateve nga analiza e sipërpërmendur, të zbatohen masa teknike për përmirësimin e fleksibilitetit të infrastrukturës së turizmit ndaj kushteve të reja që sjellin ndryshimet klimatike.

Burimet ujore

- Gjatë planifikimit duhet të zhmanget konfliktualiteti më trupat ujorë mbi dhe nëntokësor, të cilët konsiderohen të rëndësishëm për ekosistemet dhe njerëzit.
- Gjithashtu, ndërtimit të objekteve në funksion të turizsmit, të shmangen zonat të cilat kanë rrisk të lartë nga përmbytjet, ose këto ndërhyrje të marrin masa paraprake për të parandaluar dëmet në to.
- Kur planifikohet të ndërtohet në zona me sipërfaqe ujore të rëndësishme, është e nevojshme të studiohen dhe planifikohen zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative të ndërtimit dhe operimit, si dhe rastet e ngjarjeve të jashtëzakonshme, p.sh. rrjedhjet e substancave të rrezikshme.

Natyra

- Gjatë planifikimit duhet ti jepet përparësi rindërtimit të infrastrukturave ekzistuese para ndërtimeve të reja.
- Zonat natyrore të cilat nuk kanë qënë të shqetësuara më parë, duhet të mbeten të tilla, ndërtimi duhet ti shmangë këto zona.
- Gjatë Planifikimit dhe nërtimit duhet ti jepet përparsi varianteve të cilat ndikojnë më pak në rrugët e shtegëtimit të kafshëve dhe shpendëve, duhet të marrin përparësi projektet të cilat ndërpresin më pak këto koridore shtegëtimi.

Shëndeti i njerzve

- Duke marrë në konsideratë shëndetin e popullatës duhet të hartohen planet lokale të veprimit për ndotjen e ajrit në përgjithësi, apo për elementë të vecantë të substancave ndotëse.

Zhurmat në mjedis

- Masa për të zvogëluar nivelin e zhurmës në mjedis, nëpërmjet zëvendësimit të flotës së automjeteve, përmirësimit të rrjetit rrugor, ndalimi i përkoshëm ose i përhershëm në qëndrat e banimit ku nivelet janë ekstremisht të larta, masa logjistike të qarkullimit, etj.
- Në zonat ku nivelet e zhurmës janë mbi normat e lejuara duhet të merren masa në vendosjen e barrjerave akustike përgjat rrugëve dhe krijimin e brezave të gjelbër me drurë të ndryshëm.

- Në zonat urbane të konsideruara të qeta të shmanget ndërhyrjet të cilat shkaktojnë rritjen e nivelit të zhurmave.
- Duhet shmangur integrimi i ndërhyrjeve të infrastrukturës në zonat e mbrojtura natyrore, pasi shtimi i zhurmave në këto zona prish ciklin e jetës së specjeve të egra.

Popullsia dhe asetet materiale

- Të sigurohet rritja e aksesit të banorëve në tregjet dhe infrastrukturën ndihmëse që do të ndërtohet në zonë.
- Përshtatja e infrastrukturës me nevojat e personave me aftësi të kufizuar. zbatimi i kësaj mase të të sillte ndikim pozitiv në lëvizshmërinë e personave me aftësi të kufizuar dhe do të mundësonte integrimin e tyre në shoqëri dhe aktivitete të ndryshme.
- Zbatimi i masave për parandalimin dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedis, të përmendura për çdo objektive mjedisore në nënseksionet e mëipërme janë jetike për zhvillimin e qëndrueshmë të bujqësisë, turizmit dhe resurseve natyrore, çka përkthehet në mirëqënien e popullatës.

Peizazhi

- Duhet të synohet shmangia e ndërhyrjeve në zonat me peizazh të rëndësishëm. Në rastet ku shmangja e zonave me rëndësi peizazhistike nuk është e mundur, duhet të ndërmerren masa të forta ën përmirësimin dhe përshtatjen e ndërhyrjeve ndaj tipareve peizazhistike të zonës.

Plani i monitorimit

Monitorimi i ndikimeve të mundshme në mjedis nga zbatimi i PDZRK është një mjet efikas dhe tepër i thjeshtë për t`u zbatuar, nëqoftëse aktorët përgjegjës punojnë në koordinim ndërmjet tyre.

Monitorimi i ndikimeve është mjet tepër i rëndësishëm për mbrojtjen dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë zbatimit dhe opërimit të projekteve të propozuara në PDZRK. Plani i monitorimit është hartuar në përputhje të plotë me Ligjin 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"- zbatimi i një programi duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershëm ndaj këtyre efekteve dhe të bëhen adaptimet e mundshme.

Aspekti mjedisor	Treguesi mjedisor	Autoriteti monitorues	Parametrat mjedisore	Frekuenca e monitorimit	Komente
Toka	▪ Përqindja e tokës së degraduar ▪ Sasi e tokës bujqësore dhe pyjore ndryshuar përdorimin nga plani ▪ Ndryshimi I përdorimit të tokës nga cdo projekt planifikuar e zbatuar ▪ Sasia e mbetjeve të hedhura në landfille ▪ Zhvillimi për kokë dhe prodhimi total i mbetjeve ▪ % e riciklimit (letër, qelq, MBB, alumin)	Autoritetet kompetente të rajoneve DRM MTM Organet e menaxhimit të landfilleve	▪ Përqindja e tokës së degraduar ▪ Sasia e mbetjeve të hedhura në landfille ▪ Zhvillimi për kokë dhe prodhimi total i mbetjeve ▪ % e riciklimit (letër, qelq, mbetje të biodegradueshme të bashkisë, alumin)	Çdo vit Rastet kuur evidentohen ndikime të mundshmë	
Ajri	▪ Ditët kur kufiri i cilësisë së ajrit tejkalohet ▪ Emetimet sipas burimit	Ministria e Mjedisit AKM DRM ISHP	SOx, NOx, PM10, gazrat serë, Pb, CO	Çdo vit	Rrjetet e Monitorimit të Cilësisë së ndotjes së ajrit
Faktorët klimaterikë	▪ Emetimet nga gazrat serë	Ministria e Turizmit dhe	SOx, NOx, PM10, gazrat serrë, Pb,	Çdo vit	Rrjet e ndotjes së ajrit

Aspekti mjedisor	Treguesi mjedisor	Autoriteti monitorues	Parametrat mjedisore	Frekuenca e monitorimit	Komente
	✓ emetimet sipas burimit (%) ▪ Evoluimi i numrit të automjeteve të pasagjerëve ▪ Cilësia e lëndës djegëse	Mjedisit Drejtoria Rajonale e Mjedisit	CO Numri i automjeteve të pasagjerëve		Monitorimi i cilësisë
Ujërat	▪ Cilësia e ujërave sipërfaqësore ▪ Cilësia e ujërave nëntokësore ▪ Përdorimi i ujërave sipas sektorit ▪ Përqindja e riciklimit të ujit ▪ Përqindja e popullatës së lidhur te trajtimi i ujërave të zeza ▪ Uji i detit: Cilësia e ujit për larje	Drejtoria Rajonale e mjedisit Drejtoritë e Menaxhimit të Baseneve Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Instituti i Shëndetit Publik	▪ Totali N, totali P, BODs, COD, SS, TDS, pH, përçueshmëria, etj. ▪ pH, përçueshmëria, fortësia, kloridet, sulfatet, COD, BOD, nitrati, nitriti, totali P, metalet, detergjentet, toksiket, mikrobiologjike, etj. ▪ Parametrat mikrobiologjike për ujërat e larjes	Çdo vit Në rastet kur vërehen ndikime negative aksidentale	Sipas Ligjit nr. 111/2012 "Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore". Sipas Ligjit nr. 9915, datë 12.05.2008 "Kuadri rregullator i sektorëve të furnizimit me ujë dhe kanalizimit e trajtimit të ujërave të zeza". Ujërat për larje: Direktiva 76/160/EEC
Natyra	▪ Sa habitate të rëndësishme janë në kushte të kënaqshme ▪ Numri dhe/ose zonat e vendeve të mbrojtura ▪ Madhësia e biodiversitetit, krahasuar me BE-në (numri i llojeve endemike dhe të rralla	Organet e menaxhimit të zonave të mbrojtura Drejtoritë përgjegjëse në qarqe	▪ Habitatet ▪ Numri dhe/ose zonat e vendeve të mbrojtura ▪ Numri i llojeve endemike dhe të rralla ▪ Zona e mbuluar nga pyje ▪ Numri dhe zona e zënë nga vendet natyrore	Sipas Planit të Menaxhimit Çdo vit	

Aspekti mjedisor	Treguesi mjedisor	Autoriteti monitorues	Parametrat mjedisore	Frekuenca e monitorimit	Komente
	▪ Zona e mbuluar nga pyje ▪ Numri dhe zona e zënë nga vendet natyrore				
Popullata - shëndeti i njeriut	▪ Vitet e jetëgjatësisë së shëndetshme ▪ Aksidentet profesionale ▪ Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik	Drejtoritë përgjegjëse në qarqe	▪ Vitet e jetëgjatësisë së shëndetshme ▪ Aksidentet në punë ▪ Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik	Çdo vit	
Trashëgimi kulturore	▪ Numri i godinave të ruajtura që restaurohen ▪ Numri i vizitorëve ▪ Gjelbërim urban për frymë	Drejtoritë përgjegjëse në qarqe	▪ Numri i godinave të ruajtura që restaurohen ▪ Numri i vizitorëve ▪ Gjelbërim urban për frymë	Çdo vit	

Shtojca 01: Procesi i konsultimit të planit baks-rrjoll

TEMA E TAKIMIT: Organzimi i dëgjesës publike, për të diskutuar mbi Planin dhe VSM-në e Planit të Detajuar të Zonës me Rëndësi Kombëtare Baks-Rrjoll

DATA DHE ORA: 03.09.2020; 11:00

PJESËMARRËSIT:

Në ambientet e Sallës së Këshillit Bashkikak Shkodër, u organizua Dëgjesa e parë me banorët e zonës së Baks-Rrjollit, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbi draft Planin dhe VSM-në e Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare për zonën e Baks Rrjoll. Ky takim kishte qëllim t'i prezantonte të pranishmëve orientimet e para të planit të detajuar të zonës për zhvillimin e turizmit. Pjesëmarrës në këtë takim ishin, Përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, Znj. Voltana Ademi, si dhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, përfaqësues të Bashkisë Shkodër, Biznesmenë të zonës si dhe përfaqësues të tjerë të organeve përgjegjëse për të diskutuar mbi problematikat gjatë procesit të hartimit të planit. Gjithashtu në takim ishin prezentë dhe konsulentë të Atelier 4: Znj. Ariela

Kushi, koordinatore projekti Abdulla Diku, Ekspert Mjedisi si dhe ekspertë të tjerë të Mjedisit dhe Ekonomisë.

SHËNIMET E TAKIMIT:

Dëgjesa u hap nga Znj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër, e cili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të përfaqësuesve të organeve të fushave përkatëse dhe ekspertëve të bashkive përfaqësuese, me studionv konsulente, për të arrirë një produkt përfundimtar sa më të suksesshëm. Më pas fjalën e mori Z. Athanas Karaj, Drejtor i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, i cili foli për qëllimin e organizimit të dëgjesës, dhe rolin e bashkisë dhe ministrisë në këtë projekt. Më pas e mori fjalën Znj. Ariela Kushi ku paraqiti prezantimin e planit paraprak të zhvillimit të territorit. Prezantimi nisi me dinamikat që këto zona ofrojnë dhe kanë në rajon, më pas me analizimin e potencialeve të tyre dhe ndërhyrjet e domosdoshme. Pas analizimit të zonës, u prezantua vizioni strategjik i tyre, duke u drejtuar në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonës. U theksua rëndësia e mbrojtjes së mjedisit meqënëse kjo zonë njihet si pjesë e Lagunës së Vilunit si dhe zonë që shërben si habitate për shpendët migratore. U prezantua plani paraprak i zhvillimit, ku paraqet shpërndarjen e funksioneve të ardhshme të territorit, me focus zhvillimin e turizmit. Qëllimi i projektit është, zgjerimi i ofertës turistike, kohëzgjatjes së sezonit dhe frekuentimit të tij, si dhe rritja e cilësisë së shërbimit për të arritur konkurencën në tregun e turizmit me vendet fqinje.

Më pas fjalën e mori Z. Abdulla Diku, Ekspert i Mjedisit, i cili prezantoi Vlersimin Strategjik Mjedisor për zonën e studimit. Synimi i procesit të VSM është: Vlerësimi i pasojave në mjedis, adresimi i pasojave në fazë të hershme dhe vendossja e balancës Mjedis- Zhvillime të tjera. Gjatë takimit kishte debate dhe diskutime të gjata të lidhura me problematika që banorët dhe pronarët e tokave kanë hasur dhe që në këto vite nuk kanë marrë zgjidhje: mbivendosje pronash, pamundësi zhvillimi, akses jo i përshtatshëm etj.

Nga auditori, u hodhën disa mendime dhe ide:

- Rruga Shëngjin-Velipojë është një nga rrugët më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit por duhet riparë mundësia për devijim që mos të kalojë mbi Lagunën e Vilunit.
- Infrastruktura mbështetëse është kryesore, impiantet e pastrimit të ujrave duhet ti jepet rëndësi të veçantë, furnizimi me energji elektrike dhe impjantet e furnizimit me ujë janë thelbësore për nismën e zhvillimit të zonës.
- Ka interes të vazhduar nga bizneset dhe kompanitë e ndërtimit si dhe nga pronarët për zhvillimin e zonës drejt turizmit
- Në zonën e Baks Rrjollit, është e rëndësishme mbrojtja e mjedisit për zogjtë migratorë
- Problem kryesorë është dhe pronësia, konkretisht se si do të menaxhohen pronat.
- Fasha 300 m nga deti, që përkon me zonën 1a pjesë e Zonës së Peizazhit të Mbrojtur "Lumi Buna - Velipojë", shpalllur me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 682, datë 02.11.2005 "Për shpalljen e Lumit Buna dhe të territorreve ligatinorë përreth tij

"Pejzazh ujor/tokësor i mbrojtur"" , duhet riparë dhe rishqyrtuar, u shprehën banorët e zonës.

- Zhvillimi propozuar i një kampingu nuk u quajt i përshtatshëm nga banorët pasi bie ndesh me hotelet që ata duan të ndërtojnë. Nga banorët u shpreh interesi për zhvillim pranë Lagunës së Vilunit, por u shpjegua që kjo është zonën me vlera të veçanta mjedisore dhe zonë Ramsar ndaj ligjërisht ka kufizime të larta në aktivitetet e lejuara.

- Banorët kërkuan informacion si do të trajtohet prona pasi shpronësimi ka vlera shumë të ulta dhe u sqarua se në zoën do të aplikohen intrumentat zhvilimi si për shëmbull:

    - Intensitet me kusht
    - Zhvillim I detyrueshëm
    - Transferim

Hapat e mëtejshëm do të jenë:

- Ndërtimi i një plani zhvillimi dhe rregullores së planit
- Propozimet e kapacitetit turistik dhe raporti I tyre me hapësirat akomoduese me shifra konkrete
- Krijimi i një masterplani për zonën dhe Hartimi I VSM-së

REKOMANDIMET NGA PLANI I
PËRGJITHSHËM KOMBËTAR

Lista e pjesëmarrësve

"Konsultim me grupet e interesit i Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare, "Baks - Rrjoll"

"Konsultim me grupet e interesit, për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së, për PDZRK "Baks - Rrjoll"

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni/Shoqata/Agjencia	Nr. Telefoni	Email	Nënshkrimi
1	Muhamet Shogani	Pronar	0692423991		
2	Muhamet Shkreli	Pronar	0692216730		
3	Fatmir Nuka	Pronar	0683107544		
4	Redia Andoçaj	Pronar	0673657673		
5	Stela Marduria	B. Shkodër		s.marduria@yahoo.it	
6	Deana Alibali	B. Shkodër	0672567646	dealibali@live.com	
7	Emingena Dervishaj	B Shkodër	0692243485	emingenapreci@gmail.com	
8	Nexhmije Hoti	PRONARE	0692044671	ardihoti1@yahoo.it	
9	Ejerin Gorgjonaj	PRONAR	0673572778		
10	SANDER VIRUNIU	KRYETAR FSHATIT B-RR	0676158081		
11	Mark Zhuri	PRONAR Fshatit	0692747549		
12	Sokol MAPOFORAJ	PRONAR FSHATIT	0697992612		
13	Ahmet Puka	PRONARE	0682084372		
14	Gjon Zhuri				
15	Arkitekt Adilon	ATELIER 4	0684023424	adilon@hotmail.com	
16	Kriti Bashmili	Atelier 4	0696437823	kritibashmili@gmail.com	
17	GLEJDI FLOKO	AKBT	0692482305	glejdi.floko@planifikimi.gov.al	
18	Peta Madaj	OSSH	0673897399		
19	Bardl Zhuri				
20	Ndoki Kolaj	Banor i Fshatit	Baks - Rrjoll		
21	FRANCESK [illegible]				
22	Ladonik Presaqi	Specialist Mjedisi	0682047444	ladonik.presaqi@yahoo.com	
23	Julian Vecaj	Arkitekt		julianvecaj@gmail.com	

	EMËR MBIEMËR	INSTITUCIONI	Nr. Telefoni	E-MAIL	NËNSHKRIMI
24	Govalin Feka	Pronar	0675417380		
25	MARK GJEKA	MEDIA	0673002074		
26	Adon Kodheli	Banka SHKODËR	0692045009		
27	RASEL TELI	Banka Shkodra	0696633587		
28	Nektar Duma	Banka " -	0692264605		
29	Azad [illegible]	[illegible]			

KËSHILLIMI I I-rë PUBLIK: VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
PDZRK BAKS - RRJOLL
Dr. Abdulla DIKU - Ekspert Mjedisi I Licensuar
MSc. Kristi BASHMILI - Ekspert Mjedisi
AKPT

PDZRK DHE VSM BAKS - RRJOLL
AKPT

PDZRK BAKS – RRJOLL – VIZIONI STRATEGJIK RAJONAL

PDZRK BAKS – RRJOLL – OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

KËRKESA LIGJORE PËR VSM
VSM për PDZRK parashikohet në përputhje me legjislacionin kombëtar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor
Pika 1 e nenit 2 të Ligjit 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" kërkon që PDZRK-të të kryhet nëpërmjet realizimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor
(Referuar edhe në VKM 507/2015)

PROCESI I HARTIMIT TË VSM-së

ÇËSHTJET KRYESORE QË TRAJTOHEN NË VSM

- Klima
- Toka
- Uji
- Ajri
- Zhurmat në mjedis
- Natyra / ZM
- Shëndeti i njerëzve
- Popullsia dhe asetet materiale
- Infrastruktura mjedisore
- Trashëgimia kulturore
- Peizazhi

SYNIMI I PROCESIT TË VSM-së

VLERËSIMI I PASOJAVE NË MJEDIS | ADRESIMI I PASOJAVE NË NJË TË KËRSHME | ALTERNATIVA ZHVILLIMI | VENDOSJA E BALANCËS MJEDIS VS ZHVILLIMI TË TIERA

OBJEKTIVAT MJEDISOR (OM) NË VSM

Toka

OM1: Sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së tokës.

OM2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të ricikluara në ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës së turizmit.

Ajri

OM3: Ruajtja e cilësisë së ajrit në qendrat e banuara dhe sigurimi i arritjes së objektivave afatgjata kombëtare për sasitë vjetore të emetimeve të ndotësve atmosferikë.

Faktorët klimatikë

OM4: Përshtatja ndaj efekteve të ndryshimit të klimës globale dhe reduktimi i sasive të emetimeve të gazeve serë.

OBJEKTIVAT MJEDISOR (OM) NË VSM

Uji

OM5: Kufizimi i ndikimeve të presionit të infrastrukturës së turizmit mbi ujërat e sipërfaqes dhe nën-tokës, ujërat e lumenjëve, ujërat bregdetarë, lagunorë dhe burimet e ujit të pijshëm.

Zonat e mbrojtura

OM6: Sigurimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit në territor.

OM7: Ruajtja e lëmisë biologjike të zonave me status natyror të mbrojtur përkundrejt aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

OBJEKTIVAT MJEDISOR (OM) NË VSM

Zhurmat në mjedis

OM8: Parandalimi/Reduktimi i ndotjes së mjedisit nga zhurma dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE

Popullsia dhe asetet materiale

OM9: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve në brendësi/afërsi të zonës së PDZRK

Trashegimia Kulturore

OM10: Ruajtja e fushëveprimit dhe karakteristikave të objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore.

Peizazhi

OM11: Sigurimi i ruajtjes së zonave me karakteristika të veçanta peizazhistike në nivel lokal dhe përmirësimi i aspekteve peizazhistike në zonë.

POZITA GJEOGRAFIKE

Sip.	323 ha
Fshati:	Baks Rrjoll
NjA:	Velipojë
Bashkia:	Shkodër
D. Muriqan:	39 Km
A. Rinas:	98 Km
B. P. Durrësit:	124 Km

TOPOGRAFIA / KLIMA
Klima
Mes. temp.
Max. Temp.
Min. temp.
Mesdhetare
15.3`C
24`C Kor.
6.6` C Jan.
Lartësia mnd
Terreni
0-50m
Rrafshtë

TOKA
Crz
Pgp
Baks-Rrjoll
Qa-n
Tokat janë të kripura në nivele të larta

PERDORIMI I TOKËS
Legend
7%
1%
11%
10%
71%

HIDROGRAFIA
UJËRAT SIPËRFAQSOR
Laguna e Vilunit
Vija bregdetare
Pëmrenj të thatë
Crz
Pgp
Baks-Rrjoll
Qa-n
Ujërat nëntokësorë janë të kripura në nivele të larta

AJRI DHE ZHURMAT NË MJEDIS
Verifikimi i kryer në të gjitha burimet e certifikuara të informacionit mbi cilësinë e ajrit dhe zhurmave në mjedis tregon se nuk ka monitorime të kryera nga institucionet publike në territorin e zonës në studim

NATYRA – HABITATET KRYESORE
LAGUNA E VILUNIT
UGATINA DHE DELTA LUMORE
DUNAT BREGDETARE

NATYRA – BIODIVERSITETI

Flora	
Llloje bimësh të mezikuara	10
Fauna	
Gjitarë	22
Shpendë	238
Folezues	114
Zvarranikë	19
Amfibë	11
Peshqit e u. të emblà	143
Jovertebrorë	217

NATYRA – ZONAT E MBROJTURA

NATYRA – PEIZAZHI

FASHA NATYRORE FASHA UJORE FASHA RURALE

MENAXHIMI I MBETJEVE

Velipoja 5 – 20 t/mbetje/ditë

Në dimer mbetjet tërhiqen çdo 3 ditë
Në verë mbetjet tërhiqen 2 herë / ditë

UJESJELLS - KANALIZIME

Zona Baks-Rrjoll, furnizohet me ujë nga stacioni i pompave ne fushën e Trushit, nëpërmjet dy depo 2x2000m³ të pozicionuar në qafën e Kolshit.

Banorët kanë zgjidhur individualisht problemin lëgjimit të ujrave të zeza nëpërmjet ndërtimit të gropave septike.

PERFUNDIME

Zona në studim ka pasuri të mëdha natyrore (burime ujore, florë, faunë, peisazh të mbrojtur) e kulturore

Gjithashtu, kjo zonë ka potencial të shkëlqyer për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm

PERFUNDIME
Sfidat kryesore për të ardhmen në zonë janë:
Pastrimi i zonës bregdetare nga MNU
Menaxhimi i integruar i MNU (3R)
Zgjidhja e trajtimit të ujrave të përdorura urbane
Mbrojtja e dunave ranore
Mbrojtja e biodiversitetit, ndalimi i brakonazhit

DISKUTIMI
Cilët komponente të mjedisit duhen trajtuar më me përparësi?
Cfarë informacioni duhet shtuar?
Tjetër?

Figura x. Komentet shkresore nga Ministria e Mbrojtjes

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3760 prot. Tiranë, më 28.08.2020

Lënda: Kthim përgjigje Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Z. ADRIAN KAMENICA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Tiranë

I nderuar Koleg,

Me anë të shkresës Tuaj, nr. 4978 prot., datë 13.07.2020, të dërguar në rrugë shkresore në Ministrinë e Mbrojtjes, nëpërmjet së cilës keni njoftuar mbi konsultimin me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së, vlerësojmë se hartimi i planeve të detajuara dhe zhvillimi i mëtejshëm i 5 zonave të rëndësisë kombëtare në bregdet, do të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin e turizmit, si një nga industritë më potenciale të mëdha në zhvillimin e vendit. Për më tepër, në hartimin e planeve të detajuara të zonave të rëndësisë kombëtare në bregdet, sugjerojmë që duhet të merren në konsideratë çështjet e mëposhtme:

- Vendosja e instalimeve ushtarake në këto rajone, si Vendbazimi i Shëngjinit;
- Rrugëkalimet detare për hyrje-daljet në port, si dhe vendqëndrimet në spirancë;
- Sinjalistikën detare të vendosur në këto zona, si fenerë, bova etj.;
- Zonat e mbrojtura dhe sigurimin e ruajtjes së florës, faunës, si dhe arkeologjisë nënujore në këto zona;
- Zonat me rrezikshmëri nga pikëpamja lundrimore;
- Sigurimin e kushteve për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe mundësimin e zhvillimit të operacioneve të dhënies së ndihmës në këto zona;
- Nisur nga situata të cilat kanë ndodhur në të kaluarën, ku disa nga këto zona bregdetare janë përmbytur, duhet të sigurohet që në masterplan të parashikohen masa që ndikojnë në parandalimin e këtij fenomeni, si mirëmbatja dhe funksionimi i hidrovorëve, ndërhyrjet për themelimin e grykëderdhjes së lumenjve, si dhe kanaleve kulluese;
- Rrespektimin e rregullave të parashikuara në Kodin Detar për aktivitete detare dhe lundrimi (neni 8), ndërtimet detare (neni 25), si dhe të respektojë të gjitha detyrimet e tjera në Kod, si ligji kryesor në harmonizimin e aktiviteteve në det.

Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës, Tiranë
http://www.mbrojtja.gov.al
Tel: + 355 4 222 66 01
Faks: + 355 4 2228325

Mbetemi të gatshëm për shkëmbimin e mendimeve për hartimin e VSM-së për zonat e mbrojtura, si dhe do japim kontributin tonë sa herë të kërkohet, me qëllim zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës sa më të mirë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLITIKAVE TË MBROJTJES

Florian Kali

Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës, Tiranë
http://www.mbrojtja.gov.al
Tel: + 355 4 222 66 01
Faks: + 355 4 2228325

Figura x. Komentet shkresore nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
Nr. 5478 Prot.
Data 18.08.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E TURIZMIT
DREJTORIA E MARKETINGUT DHE PROMOCIONIT

Nr. 306/1 prot. Tiranë,më 17.08.2020

Lënda: Kthim përgjigje.

MINISTRISËSË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr. 4978 , datë 13.07.2020, "Njoftim mbi konsultimin me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së", kërkohet mendimi i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, në lidhje me çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së, për 5-së Planet e Detajuara të Zonave të Rëndësisë Kombëtare (PDZRK), konkretisht: Baks-Rrjoll, Rana e Hedhun-Port Shëngjin, Grykëderdhja e Ishmit, Tale dhe Spille", ju bëjmë me dije se:

Agjencia Kombëtare e Turizmit, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me VKM nr. 298, datë 20.4.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit", ligjin nr.93/2015 për turizmin, me qëllim promovimin dhe krijimin e identitetit të turizmit shqiptar nëpërmjet shfrytëzimit të të gjithë potencialit ekzistues turistik të vendit.

Në këtë kontekst, por edhe duke iu referuar përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi ligji nr.91/2013 *"Për vlerësimin Strategjik Mjedisor"*, UDHËZIM 5- 2016 mbi tarifat e VSM si dhe VKM 219,507, 620 2015, sugjerojmë që disa nga çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VSM-së, për PDZRK-të e secilës zonë, të jenë si më poshtë:

- Përshtatja e zonave me vlerë natyrore me zhvillimet dhe aktivitetet e reja turistike, në mënyrë që zhvillimi i ardhshëm turistik të tërheqë sa më shumë turistë, por njëkohësisht të jetë miqësor me mjedisin dhe habitatet natyrore. *(Zhvillim i qëndueshëm)*
- Ruajtja e karakteristikave të objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore.
- Ruajtja e peisazheve dhe zonave me peisazhe me karakteristika të veçanta në nivel lokal dhe kombëtar.
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta në hapësirat rekreative, me bimësi autoktone.
- Vendosja e sinjalistikës turistike dhe asaj mbrojtëse për mjedisin.
- Ndërtimi i rrugëve/korsive të dedikuara për biçikleta dhe shtigjeve natyrore.

Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallatet Shallvare. Nr.12/A, Tiranë, Albania info@akt.gov.al

Duke qënë të vetëdijshëm se këto zona, mbartin vlera të shumta mjedisore, me një potencial për zhvillimin e turizmit bregdetar, rural dhe natyror, si dhe hartimi i PDZRK-ve lidhet me promovimin e zhvillimit të turizmit, përthithjen e investimeve të huaja dhe krijimin e "destinacioneve konkuruese" në rajon në çdo drejtim, garantojmë se kontributi ynë institucional për promovimin e tyre, do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimim,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

KORNELIA FERIZAJ

Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallatet Shallvare. Nr.12/A, Tiranë, Albania info@akt.gov.al

ATELIER 4
ARCHITECTS

Rr. "E Kosovarëve",
Nd.35, H. 6, Ap.4/1,
Njësia Administrative
Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri
Tel. +3554 2222804 / 2430195
e-mail: info@atelier4.al